

Tregtia me njerëz në Evropën Juglindore

Situata në vitin 2003 dhe reagimet ndaj tregtisë me njerëz në Republikën e Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Bullgarisë, Kroacisë, Serbisë dhe Malit të Zi, duke përfshirë këtu edhe Krahinën e Kosovës e cila është nën administratën e Kombeve të Bashkuara, IRJ të Maqedonisë, Moldavisë dhe Rumanisë.

Raporti i Barbara Limanovskës.

- Fondi i Fëmijëve të Kombëve të Bashkuara.
- Zyra e Komesariatit për të Drejtat e Njeriut në Kombet e Bashkuara
- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë - Zyra e Institucioneve Demokratike dhe e të Drejtave të Njeriut.

Ky botim është realizuar me mbështetje të Fondit të Fëmijëve të Kombëve të Bashkuara (UNICEF), Zyrës së Komesariatit për të Drejtat e Njeriut në Kombet e Bashkuara, Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Zyrës së Institucioneve Demokratike dhe të të Drejtave të Njeriut (ODIHR), në kuadër të grupit punuese për luftë kundër tregtisë me njerëzve në Paktin e Stabilitetit. Mendimet e shprehura në këtë raport janë vetëm autorit dhe nuk është e thënë se ato e shprehin edhe politikën dhe qëndrimin e UNICEF-it, UNOHCHR-së dhe OSCE-ODIHR-së.

Botuar nga UNDP

Shtypur në nëntor, 2003

Sasia: 2500

©2003 Copyright UNICEF/UNOHCHR/ OSCE- ODIHR.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret lirish dhe të kopjohet për qëllime edukative dhe qëllime jopërfituese, me kusht që çdo shumim të jetë i shoqëruar edhe me pëlqimin e burimit, pra të UNICEF-it, UNOHCHR-së dhe OSCE-ODIHR-së.

<p>UNICEF Zyra për Bosnjën dhe Hercegovinën. Kolodvorska 6 Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë Tel. + 387 33 660 118 Faks:+ 387 33 642 970 E-mail: sarajevo@unicef.org Ëbsite: www.unicef.org</p> 	<p>UNOHCHR Kolodvorska 6 Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë Tel. + 387 33 660 107 Faks:+ 387 33 660 109 E-mail: adedic@ohchr.org Ëbsite: www.unhchr.ch</p> 	<p>OSCE- ODIHR Al. Ujazdoëskie 19 00-557 Varshavë Poloni Tel: +48 22 520 06 00 Faks: +48 22 520 06 05 E-mail: office@odih.org.pl Ëbsite: www.osce.org/odih.org</p> 
---	--	---

Falënderime

Ky raport është përgatitur me kontributin dhe ndihmën e një numri më të madh të njerëzve dhe organizatave. Raporti nuk mund të përgatitej pa përpjekjet shumë të çmuara të institucioneve qeveritare, organizatave joqeveritare, agjencive të Kombeve të Bashkuara, organizatave ndërkombëtare dhe ekspertëve të tjerë nga gjithë Evropa Juglindore. Mjetet, me ndihmë administrative të UNDP-së në Bosnjë dhe Hercegovinë, janë të siguruara nga UNICEF-i, UNOHCHR-ja dhe OSCE/ODIHR-ja.

Raporti paraqet hulumtim dhe punim të Barbara Limanovskës, këshilltare në UNICEF, UNOHCHR, OSCE/ODIHR, e cila është ndihmuar nga Elizabeta Hopik, asistente e Projektit, është recensuar nga Julia Kriger - UNICEF, nëpunëse e Programit dhe Anne Hand, këshilltare redaktuese.

Raporti jep një pasqyrë të gjendjes momentale dhe flet për reagimet ndaj tregtisë me njerëz në Evropën Juglindore prej vitit 2002 deri në prill të vitit 2003. Autori është i vetëdijshëm se nuk mund t'i dokumentojë plotësisht të gjitha aktivitetet dhe reagimet që ndodhin në këtë moment në rajon.

Për këshillat, komentet dhe rekomandimet, autori dëshiron t'i falënderojë personat e poshtëpërmendur: Gabriele Reiter - OSCE/ODIHR Varshavë; Helga Konrad - Grupi punues për tregtinë me njerëz i Paktit të Stabilitetit, Vjenë; Julia Kriger – UNICEF, Bosnjë dhe Hercegovinë, Deborah Ehinney - UNICEF Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Madeleine Rees - UNOHCHR Sarajevë.

Gjithashtu falënderim të posaçëm u shpreh edhe personave në vijim të cilët mundësuan të dhëna dhe komente për skicat e kapitujve:

PËR PASQYRËN RAJONALE:

Nensi Koan, IREX; Ana Marija Faraxi, CoE;
Sabine Fojrer, UNHCR; Klaus Guenter, ILO; Marija Holcberg, UNFPA;
Lorens Hunzinger, RCP; Lisa Lintuluoto, EUROPOL; Osnat Lubrani, UNIFEM;
Robert F. Oberloher, UNICRI; Joana Spiridonika, SECI; Sara Stivens, ICMC;
Suter Teodora, IOM; Gerda Tojerman, ICMPD; Mihai Touder, UNDP Rumani;
Stiven Varnat, SPTF dhe Galit Volfenson - Lidhja "Save the Children";

PËR SHQIPËRI: Ledia Beci, OSCE; Pier Feri, UNICEF; Eglantina Gjermeni, Tirana. Women's Centre; Hera Shanaj, IOM; Vinsent Turnekile, Terre des Hommes dhe Galit Volfenson, Lidhja "Save the Children".

PËR BOSNJË DHE HERCEGOVINË: Jasminka Xhumhur, UNOHCHR; Astrid Ganterer, OBSE; Marko Grameča, IOM; Fadila Haxhiq, La Strada; Emir Nurkiç, IFS; Zoltan Pap, EUPM dhe Mara Radovanoviç, Lara.

PËR BULLGARI: Antonia Balkanska, Ministria e Drejtësisë, Elena Kabakçieva, Fondacioni për Shëndetësi dhe Zhvillim Social; Mila Maneva, IOM; Nënkoloneli Plamen Petrov, Ministria e Punëve të Brendshme; Milena Stateva, Asociacioni Animus /La Strada; Genoveva Tisheva, Bulgarian Gender Research Foundation dhe Rosanka Venelinova, Nadia Centar.

PËR KROACI: Emi Antoniadis, ICMC; Darko Gotlicher, Koordinator Nacional; Meri Katunariç-Kudriç, OIP Split; Lovorka Marinovic, IOM; Nela Pamukovic, Centre for Women War Victims (ROSA) dhe Aleksandra Selak-Zivkoviç, CISP.

PËR REPUBLIKËN E MOLDAVISË: Giovana Barberis, UNICEF; Jana Costachi, CPTË; Kirsten Di Martino, UNICEF; Ana Palancean, La Strada; Marijana Petersen, Save the Children Moldova; Liliana Sorentino, OSCE DHE Quba Revenko, IOM.

PËR IRJ TË MAQEDONISË: Alvaro Balesteros, OSBE; Xheraldin Bjelersted, OSBE; Jasmina Dimishkovska-Rajkovska, La Strada; Gregori Grimisch, UNICEF; Karolina Lindhold, UNHCR; Biljana Lubarovska, OSBE; Limaj Mishel, IOM; Goran Mishevski, OSBE; Natasha Nankovska, OSCE; Monika Portiqo, OSBE; Elena Rodriguez, OSBE dhe Natasha Tërpenoska Trençevska, TEMIS.

PËR SERBI DHE MAL TË ZI:

Republika e Serbisë: Mona Dia, OSBE; Kristofer Gasconj, IOM; Maja Laziq, UNOHCHR; Sandra Ljubinković, ASTRA dhe Dusan Zlokas, Ministria e Punëve të Brendshme.

Republika e Malit të Zi: Jamie Faktor, OSCE/ODIHR; Aleksandar Mostrokol, MFA; Zana Pavičević, IOM; Ljiljana Raičević, Women's Safety House; Sanja Saranovic, UNICEF dhe Ana Zec, Këshilli i Evropës.

Krahina e Kosovës - nën administratë të OKB-së: Sevdie Ahmeti, CPWC; Green Ansoorge, UMCOR; Jenifer Gejs, OSBE; Monika Gutierrez, UNICEF dhe Tatjana Sulini, IOM.

RUMANI: Gabriela Aleksandresku, Save the Children; Kristina George, IOM; Madalina Marcoci, Centre for Legal Resources; Jana Matei, Reaching Out; Eduard Petresku, UNAIDS dhe Smaranda Popa, UNICEF.

Prodhim i organizatave:

UNICEF - Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë

UNOHCHR - Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë

OSCE/ODIHR - Varshavë, Poloni

SHKURTESA DHE AKRONIME

ABA CEELI	Asociacioni i Avokatëve Amerikanë Iniciativa Juridike për Evropën Qendrore dhe Lindore
BiH	Bosnja dhe Hercegovina
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave
CIDA	Agjencia Kanadeze për Zhvillim Ndërkombëtar
CoE	Këshilli i Evropës
CRC	Konventa e të Drejtave të Fëmijëve
EU/EC	Unioni Evropian / Komisioni Evropian
FRY	Republika Federale e Jugosllavisë
FYR Macedonia	Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë
HIV/AIDS	Human Immun Virus/Sindromi i Fituar Immunodeficit
ICCO	Organizata e Kishave-Interne për Bashkëpunim Zhvillimor
ICITAP	Programi Ndërkombëtar për Ndihmë të Stërvitjes për Hetim Penal
ICMC	Komisioni Ndërkombëtar Katolik për Emigranim
ICMPD	Qendra Ndërkombëtare për Zhvillim të Politikës së Emigranimit
IHRLG	Grupi Juridik Ndërkombëtar i të Drejtave të Njeriut.
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
ILO-IPEC	ILO Programi Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijëve.
IMP	Programi Ndërkombëtar për Politikën e Emigrimit.
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Emigrim.
IREX	Këshilli Ndërkombëtar për Hulumtim dhe Këmbim
ISS	Shërbimet Sociale Ndërkombëtare
MOU	Memorandumi për Mirëkuptim
NGO	Organizata Joqeveritare
NPA	Plani Nacional për Aksion
ODIHR	OSBE - Zyra e Institucioneve Demokratike dhe e të Drejtave të Njeriut (shiko më poshtë)
OPDAT	Zyra për Ndihmë të Huaj Zhvillimore dhe Stërvitje për Prokurorinë
OBSE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OBSE/ODIHR	Zyra e Institucioneve Demokratike dhe e të Drejtave të Njeriut.
SCF	Fondi „Save the Children“
SDC	Agjencia Zvicrane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SECI	Iniciativa për Bashkëpunim në Evropën Juglindore
JIE	Evropa Juglindore
SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar
SP	Pakti i Stabilitetit
SPOC	Iniciativa për Luftë Kundër Kriminalitetit të Organizuar në Paktin e Stabilitetit
SPTF	Grupi Punues në Paktin e Stabilitetit për Luftë Kundër Tregtisë me njerëz.
STI	Infektimet Seksuale Ngjithëse
UMCOR	Komiteti për Ndihmë të Metodistëve të Bashkuar
UNAIDS	Programi i Përgjithshëm për HIV/SIDA i Kombeve të Bashkuara
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNFPA	Fondi i Popullatës në Kombet e Bashkuara
UNOHCHR	Zyra e Komisarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut në Kombet e Bashkuara
UNHCR	Komesariati i Lartë për Refugjatë i Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi i Fëmijëve të Kombeve të Bashkuara
UNICRI	Instituti Interajonal për Gjurmim të Kriminalitetit Ndërkombëtar
UNIFEM	Fondi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara për Gratë
UNODC/CICP	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogë dhe Kriminalitet / Qendra për Preventivë ndaj Kriminalitetit Ndërkombëtar
USAID	Agjencia e SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar

PËRMBAJTJA

Falënderime	III
Lista e shkurtesave dhe akronimeve	V
Përmbajtja	VII
Lista e tabelave	X
Parathënie	XI
Përmbledhja	XIII
Hyrje	1
1. Qëllimi dhe struktura e raportit	1
2. Qasjet politike të reagimeve kundër tregtisë me njerëz.....	2
3. Ndryshimet dhe trendet e reja të tregtisë me njerëz në rajon	4
Iniciativat Rajonale	9
1. Qeveritë.....	9
2. Organizatat Ndërkombëtare	14
3. Organizatat Joqeveritare (OJQ)	25
4. Rast studimi: Operacioni Mirazh, Mossukesi i aksionit rajonal për siguri publike.....	29
5. Tabela: Rezultatet nga Operacioni Mirazh (shtator 2002)	32
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	177
1. Emigrimi, prostitucioni dhe tregtia me njerëz.....	177
2. Reagimet aktuale	178
2.1.Plani Nacional për Aksion.....	178
2.2.Legjislacioni kundër tregtisë me njerëz	180
2.3. Ndihmë viktimave	181
2.4. Tregtia me fëmijë	184
2.5. Përndjekja	184
3. Përmbledhja.....	185
4. Praktika gjyqësore e Maqedonisë: Strehimorja qeveritare për viktimat e tregtisë me njerëz..	187
Ndikimi i aktiviteteve për luftë kundër tregtisë me njerëz në Evropën Juglindore:	
Mungesa e efikasitetit në pjesëmarrjen e opinionit publik dhe emigrimit	189
1. Kriteri ekzistues për vlerësimin e reagimeve ndaj tregtisë me njerëz.....	189
2. Identifikimi i viktimave nga mbrojtja publike: viktimat ose kriminelit ?	192
3. Qasje deri në ndihmën e viktimave: mundësia e vetme për kthim në shtëpi	196
4. Rezultate joadekuate nga mbrojtja e viktimave/dëshmitarëve dhe mungesa e përndjekjes gjyqësore.....	198
Përfundim dhe rekomandime	201
1. Koordinimi i aktiviteteve kundër tregtisë me njerëz në kuadër të NPA-së.	201
2. Reformat Juridike dhe Përndjekja	207
3 Ndihmë për viktimat	209
4. Tregtia me fëmijë	215
5. Rritja e vetëdijes dhe parandalimi	216
6. Trajnimi	218

Lista e tabelave

TABELA 11: LISTA E PROJEKTEVE DHE AKTIVITETEVE NË IRJ TË MAQEDONISË	291
--	-----

Parathënie

Tregtia me njerëz tashmë nuk është e re në Evropën Juglindore. Kanë kaluar mëse tre vjet që nga themelimi i Protokollit të Palermos të Kombeve të Bashkuara i cili hyri në fuqi në dhjetor të vitit 2003. Ministrinë e qeverive të rajonit në fjalë të gjithë e nënshkruan Deklaratën e Palermos të Paktit të Stabilitetit me të cilën shtetet obligohen të implementojnë programe efektive për ndalim, ndihmë dhe mbrojtje për viktimat, reformat ligjdhënëse, përforsim të ligjit dhe përndjekjen e tregtarëve me njerëz. Prej atëherë e këndej donatorët bamirës financuan miliona dollarë në të gjitha shtetet e rajonit që ato të merren me këtë çështje. Në këtë temë në këtë rajon çdo vit janë mbajtur disa konferenca dhe takime, ndërsa delegacionet e nivelit më të lartë çdoherë pohojnë se lufta kundër tregtisë me njerëz është njëra ndër përparësitë më të mëdha. Tani është koha që të shohim se cila është pozita jonë, a përparojmë në pikëpamje të treguesve më të rëndësishëm dhe a jemi të orientuar në drejtim të duhur. Ky raport është një kontribut modets për t'i ndryshuar këto çështje.

Është arritur një përparim i dukshëm në shumë aspekte. Shtetet tani themelojnë fondacione të mekanizma institucionale: në secilin shtet janë caktuar koordinatorë nacional, grupe punuese multidisiplinare nacionale, janë adaptuar plane pune nacionale e kështu me radhë. Shtetet në rajon janë marrë vesh edhe për kornizën rajonale për harmonizim përmes fokusimit të bashkëpunimit rajonal. Përveç kësaj, po bëhet edhe një përparim i madh në reformat e ligjit, me qëllim që tregtia me njerëz dhe krimet tjera në lidhje me këtë të kriminalizohen. Kohëve të fundit vëmendje e veçantë u kushtohet çështjeve më të rëndësishme, siç është tregtia me fëmijë dhe mbrojtja e viktimave/dëshmitarëve. Kështu po përforcohet edhe bashkëpunimi me fushat e tjera të veprimit, siç është sigurimi publik.

Megjithatë, siç dëshmon edhe ky raport i hollësishëm, edhe më mbeten zbrazëtira fundamentale serioze në reagimet rajonale dhe nacionale ndaj këtij fenomeni. Implementimi efektiv në shumë fusha ka ngecur. Nuk është arritur të sigurohet ndihmë afatgjate për viktimat e tregtisë me njerëz. Marrë në përgjithësi, nuk ekzistojnë mekanizma që viktimat e tregtisë me njerëz, të cilët janë zbuluar nga agjencitë e sigurimit publik, në mënyrë adekuate t'u dorëzohen atyre që e ofrojnë një ndihmë të tillë. Shefat e kriminalitetit të rrjeteve të tregtisë me njerëz në shumë shtete edhe më vazhdojnë të funksionojnë. Korrupsioni dhe/ose bashkëpjesëmarrja e autoriteteve shtetërore në të gjithashtu kontribuon në efektivitetin e këtyre tregtarëve. Në anën tjetër, duhet të rriten edhe investimet dhe përgjegjësisë për zhvillimin e pjesëmarrjes vendore, nacionale dhe qeveritare.

Lufta kundër tregtisë me njerëz domosdo duhet të përparojë në shumë fronte, ngase karakteri i tregtisë me njerëz është një problem kompleks. Një qasje më gjithpërfshirëse dhe integruese në luftën kundër tregtisë me njerëz bën me dije se tregtia me njerëz ka të bëjë me të drejtat e njeriut dhe shkeljen e tyre, me emigrimin legal, jolegal dhe transnacional, me krimin e organizuar, larjen e parave dhe shfrytëzimin e tyre, me çështje të shëndetit publik etj. Kjo ndërlidhet me gjendjen ekonomike dhe sociale në shumë shtete amë që janë të njohura për dhunën dhe diskriminin e rregullt dhe, sigurisht, edhe me kërkesën për një gjë të tillë.

Nëse përmbajtja e këtij raporti lexohet seriozisht, çështje kjo që kërkon dhe meriton të shihet ashtu, ajo do të ndihmojë që të gjithë pjesëmarrësit relevantë t'i drejtojnë në drejtim të vërtetë dhe konkret, drejt implementimit të qëndrueshëm dhe efektiv.

Ky raport tregon se ne mund të mburremi me sukseset që janë arritur për një kohë relativisht të shkurtër. Megjithatë ne duhet të jemi të vetëdijshëm edhe për pasojat serioze të këtij kriminaliteti dhe për shkeljet e të drejtave të njeriut. Çdoherë duhet ta kemi parasysh se në kohën kur ne e lexojmë këtë parathënie, shumë njerëz në tërë botën - sidomos gratë dhe vajzat, në ato momente dhunohen dhe mbahen peng nga këta tregtarë, të cilët mbi ta ushtrojnë dhunë, e cila ndonjëherë është edhe vdekjeprurëse.

Për kontibutin e tyre të çmuar në kuptimin e tregtisë me njerëz në Evropën Juglindore, dëshiroj që falënderim të thellë t'i shpreh UNICEF-it, ndërsa falënderim të veçantë meriton z. Barbara Limanovska, autorja e palodhshme e këtij raporti. Po ashtu, u falënderohem edhe të gjithë atyre që dhanë mbështetje financiare dhe përkrahje teknike - veçanërisht OSBE-së/Zyrës së Institucioneve Demokratike dhe të të Drejtave të Njeriut dhe Zyrës së Komisaritit të Lartë të Kombeve të Bashkuara, të cilët ndihmuan në përfundimin e këtij raporti. Ky kontribut i vlefshëm i Paktit të Stabilitetit për

Tregtia me njerëz në Evropën Juglindore

punën e Grupit Punues për tregtinë me njerëz në Evropën Juglindore ofron njohuri të thella për problemin kompleks të tregtisë me njerëz.

Helga Konrad

Kryesuese e Grupit Punues për tregtinë me njerëz në Evropën Juglindore

PAKTI I STABILITETIT

PËR EVROPËN JUGLINDORE

GRUPI I PUNËS PËR TREGTINË ME NJERËZ

Vështrim ekzekutiv

Ky raport e vlerëson situatën dhe reagimet aktuale ndaj tregtisë me njerëz në vendet e Evropës Juglindore (EJL): Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Bullgarië, Kroacië, Krahina e Kosovës nën administrimin e KB-së, IRJ të Maqedonisë, Moldavi, Rumania dhe Serbi e Mali i Zi. Raporti fokusohet në statusin e implementimit të Planeve Nacionale për Aksion, reformat në ligjdhënie, në ndihmën për viktimat, në tregtinë me fëmijë dhe ndjekjen, si dhe shërben për përtëritjen e pasqyrës së situatës së mëparshme dhe për reagimet ndaj tregtisë me njerëz në EJL të cilat janë të publikuara nga UNICEF-i, UNOHCHR dhe OSBE/ODIHR në qershor 2002.¹ Të dhënat e këtij raporti janë mbledhur mes muajit nëntor 2002 dhe muajit prill 2003 dhe janë paraqitur si rezultat i veprimeve konkrete të ndërmarra nga agjencitë pjesëmarrëse qeveritare, joqeveritare dhe ndërkombëtare.

Situata e përgjithshme e tregtisë me njerëz në EJL është e njëjtë me atë që është shënuar në raportin e vitit 2002: 90% nga gratë e huaja të cilat merren me prostitucion janë kryesisht viktima të tregtisë me njerëz; 10-15% nga këto gra janë vajza të mitura; madje edhe fëmijët më të rinj, si dhe meshkujt dhe femrat shiten për punë të detyrueshme.

Megjithatë dalin në pah disa trende të reja. Kështu nga 35% sa ishte numri i tyre në vitin 2002, dukshëm u zvogëlua përçindja e grave të cilat ishin identifikuar si viktima dhe të cilat mirrin ndihmë. Tregtarët e modifikuan *modus operandin* e tyre, sepse qeveritë e EJL-së filluan me ndryshimet në ligjdhënien e tyre kundër tregtisë me njerëz, kështu që tregtia me njerëz filloi të bëhet më pak e dukshme. Në kuadër të rajonit të Ballkanit ekziston një rritje e tregtisë me njerëz, ashtu që vendet e Ballkanit u bënë vendet e caktuar, të prejardhjes dhe vende tranzitore.

Qeveritë filluan të luajnë një rol ta madh shtetëror në luftë kundër tregtisë me njerëz, gjë që rezultoi me përmirësim të jashtëzakonshëm në struktura qeveritare dhe në ligjdhënien kundër tregtisë me njerëz në gjithë rajonin. U caktuan koordinatorë nacional, të cilët e mbikëqyrin implementimin e Planeve nacionale për aksion kundër tregtisë me njerëz, ndërsa aksionet kundër tregtisë janë të koordinuara shumë më mirë nga njerëz, në të gjitha nivelet, ndërmjet agjencive në marrëdhëniet bilaterale dhe rajonale. Pjesa më e madhe e ligjdhënies së re përputhet me definicionet e Protokollit të Palermos për tregtinë me njerëz. Janë përfshirë çështjet e tregtisë me njerëz të fëmijëve dhe tregtia me njerëz e brendshme në kuadër të përparësive të Grupit punues për tregtinë me njerëzve në Paktin për Stabilitet për vitin 2003: Tregtia e fëmijëve; sepse nuk mund të tubohen fakte të mjaftueshme kundër tyre. Zakonisht të vetmet fakte janë dëshmitë e viktimave, por ata rrallë mund të përdoren në mënyrë efektive, për shkak të mungesës së mbrojtjes adekuate të dëshmitarëve të rajonit. Misioni i policisë së UE-së në B e H nga viktimat e tregtarisë me njerëz e vë theksin në sigurimin publik të tregtisë me njerëz, me çka në rajon imponojnë siguri publike të mbështetur në fakte. Gratë viktima të tregtisë me njerëz shpeshherë japin dëshmi vetëm për aq sa besojnë se i obligon statusi i tyre jolegal. Gratë patjetër duhet të informohen për të drejtat e tyre, përfshirë edhe mbrojtjen dhe mbështetjen juridike, ndërkaq atyre duhet t'u jepet edhe kohë të mjaftueshme që të vendosin për atë se a do të dëshmojnë.

Perspektiva e të drejtave të njeriut patjetër duhet të vazhdojë të theksojë luftën kundër tregtisë me njerëz. Policia akoma i trajton si kriminele e jo si viktima gratë e kapura nëpër bare dhe nëpër kalime kufitare. Agjencitë e ndihmës patjetër duhet t'u kushtojnë rëndësi të veçantë procedurave operative standarde me të cilat, perspektivave të të drejtave të njeriut në aktivitetet e tyre dhe në strategjitë zhvillimore me të cilat programet e tyre do t'u japin agjencive vendore. Njëri ndër qëllimet kryesore të programit për tregtinë me njerëz në Paktin e stabilitetit është që t'i inkurajojë dhe mbështetë vendet e EJL-së në marrjen e kontrollit mbi iniciativat e tyre dhe ato rajonale për luftë kundër tregtisë me njerëz.

¹ Barbara Limanovska, Tregtia me njerëz në Evropën Juglindore. Situa momentale dhe reagimet e tregtisë me njerëz në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Krahina e Kosovës nën administrimin e KB-së, IRJ e Maqedonisë, Moldavia, Rumania dhe Serbi e Mali i Zi. UNICEF, UNOHCHR dhe OSBE/ODIHR, Beograd 2002. Raporti mund të gjendet në: www.seerights.org

Në gjithë EJL-në është vërejtur një përparim në luftën kundër tregtisë me njerëz, edhe pse secili nga vendet e rajonit të veçantë u jep aspekteve të ndryshme të tregtisë me njerëz. Megjithatë qëllimi i tyre në gjithë rajonin patjetër duhet të jetë afrimi i këtyre aspekteve të përparimit për të dhënë një qasje më të përgjithshme dhe më konzistente në luftën kundër tregtisë me njerëz të mbështetur në të drejtat e njeriut.

TREGTIA ME NJERËZ NË EVROPËN JUGLINDORE

Situata e tanishme dhe reagimet për tregtinë me njerëz e njerëzve në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, IRJM, Moldavi, Rumani, Serbi e Mal të Zi, përfshirë edhe Krahinën e Kosovës nën administrimin e KB.

Hyrje dhe revizion

1. Qëllimi dhe struktura e raportit

Qëllimi i këtij raporti është të japë një përsyrtje për situatën dhe të japë përgjigje për tregtinë me njerëz në EJL, si dhe të ripërtrihen të dhënat që i përmban raporti i përbashkët i UNICEF-it, OSBE/ODIHR-së dhe UNOHCHR-së, i botuar në qershor të vitit 2002¹. Vendet e përfshira në këtë raport janë: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, IRJ e Maqedonisë, Moldavia, Rumania, Serbia e Mali i Zi (SMZ), përfshirë këtu edhe Krahinën e Kosovës nën administrimin e KB-së. Vlerësimi bazohet në të dhënat e mbledhura në periudhën nëntor 2002 - prill/maj 2003², që janë marrë nga institucionet që veprojnë drejtpërdrejtë në terren në çështjen e tregtisë jolegale me njerëz: agjencitë qeveritare, organizatat ndërkombëtare dhe organizatat joqeveritare (OJQ).

Raporti bën vështrim të situatën në rajon dhe për secilin vend, veçmas, jep vlerësim për situatën dhe reagimet aktuale ndaj tregtisë me njerëz duke e theksuar implementimin e Planeve nacionale për aksion, reformat në ligjdhënie, ndihmën për viktimat, tregtinë me fëmijë dhe ndjekjen gjyqësore. Raporti nuk ka për qëllim vetëm t'i analizojë të gjitha iniciativat kundër tregtisë jolegale me njerëz në rajon, por edhe t'i vë në dukje hapat konkretë që janë ndërmarrë nga agjencitë e përfshira në këto çështje. Edhe pse në të gjitha vendet zbatohen standarde të njëjta ndërkombëtare, në aspektin e reformave dhe ligjdhënies, si dhe në mbrojtjen e viktimave të tregtisë me njerëz, strategjitë dhe veprimet, në fund shpeshherë rezultatet ndryshojnë nga vendi në vend. Derisa në një vend, cak kryesor mund të jetë mbrojtja e fëmijëve-viktima të tregtisë jolegale me njerëz, në ndonjë vend tjetër cak mund të jenë strategjitë e reja për riintegrim, ndërsa në vendet e treta, mbrojtja e viktimave dhe ndjekja gjyqësore e tregtarëve. Analizat e secilit kapitull kanë për qëllim publikimin e përvojës së mirë dhe mungesën e implementimit në terren.

Pjesa e dytë e këtij raporti përbëhet nga informatat e hollësishe për projektet që janë në vijim dhe nga aktivitetet e qeverive, organizatave ndërkombëtare dhe OJQ-ve në rajon dhe në veçanti për secilin vend, përfshirë edhe listën e projekteve dhe kontakteve. Të dhëna të gatshme për projektet në vijim si dhe për kontakte mund të gjenden në veb faqen SEE RIGHTS: www.see-rights.org³.

2. Qasje në politikën e reagimeve ndaj tregtisë jolegale me njerëz

Derisa institucionet të cilat punojnë në çështjen e tregtisë jolegale me njerëz e mbështetin veprimin e tyre në ligjin e njëjtë ndërkombëtar, ndërsa në teori e shfrytëzojnë definicionin e njëjtë për tregtinë me njerëz, qasja e tyre në praktikë dallon varësisht nga konteksti më i gjerë i punës së tyre dhe mandati i organizatës/institucionit. Këto dallime mund të ndahen në tre kategori: emigrim, siguri publike dhe të

¹ Barbara Limanovska, Tregtia me njerëz në Evropën Juglindore. Situa momentale dhe reaksionet e tregtisë me njerëz në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Krahina e Kosovës nën administrimin e KB, IRJ e Maqedonisë, Moldavia, Rumania dhe Serbia e Mali i Zi. UNICEF, UNOHCHR dhe OSBE/ODIHR Beograd 2002. Raporti mund të gjendet në: www.seerights.org

² Informacionet e marra pas muajt maj 2003 janë të shënuara vetëm në fusnota.

³ Ekzistojnë edhe burime të tjera të dobishmepër të dhëna dhe aspekte të ndryshme të aksioneve kundër tregtisë me njerëz në EJL, duke e përfshirë edhe Këshillin e Europës për ligjdhënie kundër tregtisë jolegale dhe reforma në ligjdhënie, IOM për programet për ndihmë dhe reintegrim të viktimave, ILO për eksploatimin e mundit të dhe tregtinë fëmijëve. Qendra e takimit rajonal e IOM-it / ICMC i mbledhë dhe i analizon të dhënat për viktimat e tregtisë me njerëz dhe programeve të përgatitura për t'i ndihmuar dhe mbrojtur viktimat në rajon. Zyrat lokale të OSBE-së dhe UNICEF-it kanë kontroll të përditshëm e të detajuar të aktiviteteve kundër tregtisë jolegale dhe tregtisë me fëmijë në çdo vend. Në Bullbari, dhe Moldavi pjesëmarrja në prostitucion nuk është ilegale, ndërsa në vendt tje

drejta njerëzore. Ndërhyrja në çështjen e tregtisë me njerëz në një rën nga këto perspektiva dhe veprimet e ndryshme të cilat ndërmerren nga ana e pjesëmarrësve, shpeshherë rezultojnë në mjete të ndryshme administrative dhe juridike, të cilat shfrytëzohen për zgjidhjen e problemit.

Qasja e emigrimit zakonisht zbatohet nga Organizata Ndërkombëtare për Emigrim (IOM). Programet e IOM-it kundër tregtisë me njerëz i kanë tejkaluar programet për ndihmë të emigrantëve të robëruar, emigrantëve ekonomikë, statusi jolegal i të cilëve/ose pamundësia e tyre për të mbijetuar në vendin e ri, i sjell deri te nevoja për ndihmë humanitare. Nga këndvështrimi i IOM-it, statusi “viktimitë e tregtisë me njerëz” është shumë i ngjashëm me atë të “viktimitës-emigrant”, person i cili është njaft i dëshpëruar dhe as nuk mund të ëndërojë për t’u kthyer në shtëpi. Me fillimin e identifikimit të viktimitëve të tregtisë me njerëz, kah fundi i viteve të 90-ta, misionet e IOM-it në vendet e Ballkanit zhvilluan programe speciale për ndihmë gjatë kthimit vullnetar, në aspektin humanitar, duke përfshirë edhe strehimore të përkohshme. Derisa të punësuarit në IOM e kanë kuptuar qartë statusin e vetëm të viktimitëve të tregtisë me njerëz si persona të shfrytëzuar dhe me lëndim të veçantë, forma e ndihmës për këto viktime varet nga kuptimi i tregtisë me njerëz e cila në esencë është emigrimi jo i rregullt ekonomik.

Qasja ndaj tregtisë me njerëz në aspektin e sigurisë publike është dhënë nga Ministria e Punëve të Brendshme, nga qeverit e ndryshme, policia, policia kufitare dhe nismat rajonale/organizata për luftë kundër kriminalitetit të organizuar, përfshirë këtu edhe nismën për bashkëpunim me vendet e EJL-së (SECI). Tregtia jolegale me njerëz është parë si akt kundërvajtës, e cila është shumë e ngjashme me tregtinë me armë dhe drogë, që shpeshherë kryhet nga grupacionet e njëjta të kriminalitetit të organizuar. Derisa qëllimi kryesor i agjencive për siguri publike është ta pengojë/të luftojë me krimin dhe t’i mbrojë viktimat e pafajshme, në rastin e tregtisë me njerëz me qenie njerëzore, ekzistojnë shtype të dukshme dhe mungesa në të kuptuarit e shkeljes së të drejtave të njeriut dhe paaftësi që t’i identifikojnë viktimat e veprave penale. Nga ana tjetër, policia e trajton prostitucionin si shkelje të rendit dhe qetësisë publike⁴ dhe pikërisht për këtë prostituteve u kushtojnë kujdes të veçantë. Për shkak të kësaj viktimat e tregtisë me njerëz nga pikëvështrimi i sigurisë publike konsiderohen të njëjtë/identike me gratë që punojnë në mënyrë jolegale, por krijohet përshtypje se punojnë si prostitute vullnetare.

Nga ana tjetër, shtypja e policisë për ta luftuar emigrimin jolegal dhe që ajo të jetë e sukseshme në masat kundër emigrimit jolegal rezultojnë me atë që të gjitha gratë që janë pa dokumente të trajtohen si emigrante jolegale. Si rezultat i kësaj, ata gjatë identifikimit të viktimitëve shpeshherë përdorin strategjinë “secili ose asnjëri”. Në situatat e përditshme, gratë dhe fëmijët trajtohen si kriminelë (emigrantë jolegalë apo prostitute), por gjatë kohës së aksioneve speciale kundër tregtisë me njerëz, policia kur ka udhëzime të qarta apo stërvitje adekuata, të gjitha femrat i trajton si viktime të tregtisë me njerëz. Kjo qasje gjithashtu tregon se gratë e reja, shtetase të vendeve të caktuara, kanë probleme për kalimin e kufijve ose atyre u refuzohet hyrja, kështu që shrohet çështja e pasojave negative për masat kundër tregtisë me njerëz dhe çështja e statusit të grave të cilat udhëtojnë apo emigrojnë.

Policia mund të ballafaqohet me probleme edhe gjatë njohjes së tregtarëve, kur ata nuk janë anëtarë të grupeve të organizuara kriminale, por janë vetëm ndërmjetësues të viktimitëve të mëparshme të tregtisë me njerëz. Mandati i policisë që t’i arrestojë kriminelët në kontekstin në të cilin prostitucioni është jolegal dhe t’i kontrollojë kufijtë nga emigrimi jolegal, rezultojnë me përpjekjen e policisë që luftën kundër tregtisë jolegale me njerëz ta trajtojë si sinonim të luftës kundër prostitucionit dhe/ose punë e policisë për luftë kundër emigrimit jolegal.

Qasja e të drejtave të njeriut, e cila e thekson nevojën dhe obligimet e shtetit që t’i sigurojnë të drejtat e njeriut për personat me të cilët bëhet tregti, teoretikisht duhet t’i përfshijë të gjitha qasjet kundër tregtisë me njerëz, sepse kornizat e të drejtave të njeriut dalin nga standardet dhe principet e të drejtave të njeriut që janë pjesë e marrëveshjeve ndërkombëtare, konventave dhe protokolleve. Me fjalë të tjera, shtetet janë të obliguara nga ligjet ndërkombëtare që ta miratojnë qasjen për të drejtat e njeriut. Me rëndësi është që Sekretari i Përgjithshëm i KB-së dhe komisar i lartë për të drejtat e njeriut në KB e identifikojnë tregtinë me njerëz si kundërvajtje të neveritshme dhe si provokim për të drejtat e njeriut.⁵

⁴ Në Bullbari dhe Moldavi pjesëmarrja në prostitucion nuk është vepër jolegale, ndërsa në vendet tjera të EJL-së ajo është vepër jolegale. Sidoqoftë qëndrimi i policisë dhe trajtimi i prostituteve në këto tri shtete nuk ndryshon nga ai i shteteve të EJL-së ku prostitucioni është jolegal.

⁵ EJL: Tregtia me gra dhe vajza. Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së, A/55/Kuvendi i Përgjithshëm/ 22 gusht, 2000, shih faqen: <http://www.un.org/womenwatch/daw/fofollowup/trafficking.html> gjithashtu, Deklarata e Sekretarit të Përgjithshëm në

Principet dhe udhëzimet e rekomanduara të UNOHCHR⁶ për të drejtat e njeriut dhe për tregtinë me njerëz e nënvizojnë thelbin e të drejtave të njeriut duke i vënë në spikamë:

1. Të drejtat e njeriut për njerëzit me të cilët tregtohet do të jenë në qendër të të gjitha përpjekjeve për pengimin dhe luftës kundër tregtisë me njerëz, mbrojtjes, ndihmës dhe krijimit të mundësive për rehabilitimin të viktimave;
2. Sipas ligjeve ndërkombëtare, shtetet janë përgjegjëse që të veprojnë në mënyrë adekuate ndaj tregtisë me njerëz, zbulimit dhe ndjekjes së tregtarëve, si dhe për ndihmën dhe mbrojtjen e personave të tregtuar;
3. Masat kundër tregtisë me njerëz nuk do të ndikojnë negativisht në të drejtat e njeriut dhe në dinjitetin e personaliteteve, në veçanti në të drejtat e atyre me të cilët është tregtuar, emigrantëve, personat të zhvendosur brenda vendit, refugjatëve dhe azilantëve.⁷

Qasja ndaj veprimit kundër tregtisë me njerëz nga aspekti i të drejtave të njeriut është miratuar nga organizatat ndërkombëtare, ndërqeveritare dhe vendore për të drejtat e njeriut, si dhe nga disa struktura të tjera qeveritare. Roli i organizatave ndërkombëtare është që t'i mbështetin qeveritë në përmbushjen e obligimeve të tyre në drejtim të të drejtave të njeriut. Sipas grupit punues për tregtinë jolegale me njerëz të PZC-së, përgjegjësia e plotë (për luftën kundër tregtisë me njerëz) qendron te shtetet individualisht, të cilat patjetër duhet të sigurojnë përmbushjen e obligimeve të tyre ndërkombëtare sipas normave për të drejtat e njeriut, për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të individëve, përmes të drejtave administrative e kështu me radhë.⁸

Mjetet të cilat i shfrytëzojnë organizatat ndërkombëtare janë zbatimi i normave për të drejtat e njeriut përmes pjesëmarrjes aktive në trupat interagjencive dhe qeveritare të formuara për luftë kundër tregtisë me njerëz, si dhe përmes monitorimit të iniciativave ekzistuese kundër tregtisë me njerëz.

Mungesa e informacioneve për përfshirjen e aktiviteteve në terren - identifikimi dhe ndihma për personat e tregtuar - e problematizon ndikimin e organizatave ndërkombëtare. Standardet për trajtimin e viktimave të tregtisë me njerëz dhe të punës për ndihmën e agjencive (për shembull udhëzimet dhe rekomandimet e UNOHCHR-së për të drejtat e njeriut dhe tregtisë jolegale me njerëz, si dhe udhëzimet e UNICEF-it për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktimat të tregtisë me njerëz në EJL) janë zhvilluar mjaft, ndonëse organizatat ndërkombëtare janë të interesuara që ato të përdoren, edhe pse në fakt nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në implementimin e normave për të drejtat e njeriut, sepse ajo është përgjegjësi e qeverisë.

Ndikimi i këtyre tre qasjeve, sigurisë publike, emigrimit dhe të drejtave të njeriut, kah reagimet dhe aktiviteteve kundër tregtisë jolegale me njerëz në EJL, si dhe pasojat praktike të tyre për funksionimin dhe rezultatet e strukturave dhe nismave kundër tregtisë me njerëz janë esenca kryesore e raportit vjetor.

3. Ndryshimet dhe trendet e reja të tregtisë jolegale në rajon

Situata e përgjithshme e tregtisë me njerëz në EJL është e njëjtë me atë që është dhënë edhe në raportin e vitit 2002:

- Sipas definicionit për mbrojtje që përmban pakti i KB; pengimin dhe dënimin e tregtisë me njerëz, në veçanti fëmijëve dhe grave (Protokolli i Palermos për tregtinë me njerëz) i cili është plotësim i konventës të KB për kriminalitetet të organizuar

Konferencën e nivelit të lartë në Palermo, Itali, me rastin e shënimit të hapjes së nënshkrimit të Konventës së KB kundër kriminalitetit transnacional, 12 dhjetor të vitit 2000. Shih faqen: <http://www.odccp.org/palermo.convmain.html>. Gjithashtu: Tregtia me gra dhe vajza. Raport i Sekretarit të Përgjithshëm, E/CN.4/2003/74. Shih faqen: <http://www.unhcr.ch/huridocda/huridoca.nsf>

⁶ Principet e propozuar dhe orientimet për të drejtat e njeriut dhe tregtinë me njerëz. Plotësim i Raportit të Komisarit të lartë për të drejtat e njeriut në KB para Këshillit Ekonomiko-Social, shih faqen: [http://www.unhcr.ch/huridocda/huridoca.nsf/\(symbol\)/E.2002.68.add.1.En?Opendocument](http://www.unhcr.ch/huridocda/huridoca.nsf/(symbol)/E.2002.68.add.1.En?Opendocument)

⁷ Shih faq.2

⁸ Plani aksionar disavjeçar kundër tregtisë jolegale me njerëz për EJL. Grupi punues për tregtinë me njerëz në EJL për PZC, Vjenë 16 mars 2001, f.11. Shih faqen: <http://www.stabilitipact.org/trafficking/atap-2001.doc>

transnacional, shumica e grave të huaja, të cilat punojnë në prostitucion në vendet e Ballkanit, janë viktime të tregtisë me njerëz.⁹

- Vlerësohet se 10-15% nga personat e tregtuar për qëllime të prostitucioni janë vajza adoleshente nën moshën 18-vjeçare;
- Me fëmijë femra dhe meshkuj të moshës nën 13-vjeç, tregtohet për punë të detyrueshme, në veçanti nga Shqipëria në Greqi dhe Itali, por gjithashtu edhe nga Moldavia dhe Rumania në Evropën Perëndimore dhe në Rusi.

Edhe pse situata e përgjithshme nuk ka ndryshuar nga ajo e vitit të kaluar, prapëseprapë, ekzistojnë trende të reja që parë nuk janë vënë re në rajon.

Zvogëlimi i numrit të viktimave të identifikuar të tregtisë me njerëz, të cilat kanë marrë ndihmë

Në pjesën e dytë të vitit 2002 dhe në fillimin e 2003-sit numri i viktimave të tregtuara dhe të cilat marrin ndihmë është më i ulët se numri i tyre në periudhën e njëjtë të vitit të mëparshëm. Në raportin e vitit 2002 vlerësohet se 35% e femrave me të cilat është tregtuar janë identifikuar dhe kanë marrë ndihmë para se të kthehen në vendet e tyre të prejardhjes.¹⁰ Sipas informatave të mbledhura gjatë kohës së përgatitjes së këtij raporti, kjo përqindje dukshëm bie. Për shembull, gjatë kohës së Operacionit Mirazh, në shtator 2002, vetëm 14% e grave të marra në pyetje, janë identifikuar si viktime të tregtisë me njerëz, nga të cilat shumica janë vajza nën moshën 18-vjeçare.¹¹ Sipas policisë, OJQ-ve dhe IOM-it, kjo rënie është kryesisht rezultat i refuzimit që gratë e bëjnë ofrimit të ndihmës nga ana e policisë gjatë kohës së bastisjeve të bareve, për çka ishte refuzuar edhe ndihma e IOM-it për kthimin vullnetar në shtëpi. Kjo e vë në pikëpyetje edhe efikasitetin e mundësive ekzistuese të identifikimit dhe mekanizmat për ndihmë viktimave, të cilët kryesisht varen nga bastisjet policore të bareve me qëllim të identifikimit të viktimave dhe nga programet e IOM-it për t'u ndihmuar viktimave që vullnetarisht të kthehen në vendet e prejardhjes.

Rritja e tregtisë me njerëz në kuadër të rajonit të EJL-së

Numri i raporteve për tregtinë me njerëz në mesin e shteteve është rritur, gjë që tregon se shtetet e Ballkanit bëhen jo vetëm vende të caktuar, por edhe vendet të prejardhjes. Dallimet mes vendeve të prejardhjes, vendeve tranzitore dhe vendeve të caktuar në EJL zbehen. Për shembull, gratë nga Kosova mund të gjenden në Mal të Zi, ndërsa gratë nga Serbia janë identifikuar si viktime të tregtisë me njerëz në B e H.

Emigrimi dhe tregtia jolegale

Njëkohësisht janë vënë re edhe ndryshime në trendet globale të emigrimit

- Rritje e ritmit të emigrimit;
- Rritje e numrit të femrave emigrante
- Rritje e numrit të fëmijëve pa shoqërues;
- Rritje e shpenzimeve të ndërmjetësimeve gjatë emigrimit;
- Kërkesa për punë më të lirë dhe fuqi pune të pambrojtur në vendet e caktuar dhe

⁹ Protokollin i KB për mbrojtjen, pengimin dhe dënimin e tregtisë me njerëz, në veçanti të grave dhe të fëmijëve, i cili është plotësuar në Konventën e KB-së për kriminalitetin e organizuar transnacional, që është miratuar nga Kuvendi i Përgjithshëm i KB-së në nëntor të vitit 2000. Tregtia me njerëz në nenin 3 të Protokollit është definuar kështu:

a. Tregtia me njerëz do të thotë rekrutim, transport, transfer, fshehje apo pranim të personave, përmes kërcënimit apo përdorimit të forcës ose formave të tjera të detyrimit, si: kidnapim, mashtrim, gënjim, keqprdorim të forcës apo pozitës së ndjeshmërisë ose dhënie apo pranim të të hollave apo shpërblimeve që të arrihet pajtueshmëri e personit i cili ka kontroll ndaj një personi tjetër, gjithë kjo me qëllim të eksploatimit. Eksploatimi, në masë më të vogël, përfshin eksploatimin e të tjerëve apo format e tjera të eksploatimit seksual, punën të detyrueshme apo shërbimet, skllavërimin apo praktikatat tjera të ngjashme me skllavërimin, shërbimin apo heqjen e organeve;

b. Dakordimi i viktimave të tregtisë me njerëz me qëllim të eksploatimit të përmendur në nënpikën (a) të këtij neni do të jetë joqenësore nëse është përdorur ndonjë mjet i përmendur në nënpikën (a);

Në rastet ku janë përzier edhe fëmijët, ky nen vazhdon me:

v. Rekrutim, transport, transfer, fshehje ose dakordim të fëmijës me qëllim të eksploatimit, do të llogaritet si tregti me njerëz, edhe nëse aty nuk janë përfshirë mjetet e përmendura në nënpikën (a) të këtij neni

g. Fëmijë do të llogaritet çdo person nën moshën 18-vjeçare.

¹⁰ Barbara Limanovska, Tregtia me njerëz në Evropën Juglindore. Situata momentale dhe reagimet endaj tregtisë me njerëz në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Krahinë e Kosovës nën administrimin e KB-së, IRJ e Maqedonisë, Moldavi, Rumania dhe Serbi e Mali të Zi. UNICEF, UNOHCHR dhe OBSE/ODIHR Beograd 2002. fq. 142.

¹¹ Për përshkrim më të hollësishëm të operacionit Mirazh, shih Studime rajonale (kapitulli Nismat rajonale)

- Kushte të pavolitshme për forcën punëtore në vendet e caktuar.

Këto trende tregojnë se kërkesa për fuqi punë më të lirë që është e kombinuar me gatishmërinë e njerëzve për të emigruar dhe për vështirësitë gjithnjë e më të mëdha të organizimit të emigrimit dhe punësimit legal në vendet e caktuar, mund të shpiejë deri te eskalimi i tregtisë jolegale.

Skemat e emigrimit janë shumë të ngjashme edhe nëpër vendet tjera të të EJL, përfshirë këtu edhe rrjetin e organizuar të emigrimit dhe llojin e njerëzve të cilët e ndihmojnë emigrimin. Sipas burimeve vendore, në të gjitha vendet ekzistojnë kanale dhe mundësi për emigrim, që janë mirë të njohura, mirë të zhvilluara dhe të siguruara, por natyrisht jolegale. Megjithatë, në shumë raste gratë janë të përjashtuara nga këto rrjete. Për ta është më e vështirë të gjejnë informacione të sigurta dhe lidhje për emigrim të sigurt, pra pa marrë parasysh se është ai legal. Përkundër kësaj ato shpesh varen nga informacionet e përcejlaa gojarisht, të cilat mund të shpiejnë deri në tregtinë me njerëz. Faktor kryesor nuk është vetëm kërkesa specifike për shërbime seksuale, por edhe fakti që gratë, si edhe fëmijët, janë më të ndjeshëm dhe cak i lehtë për ata të cilët dëshirojnë të fitojnë nga procesi i emigrimit jolegal. Në vendet e caktuar, prostitucioni paraqet kërcënim të madh për gratë me të cilat tregtohet me qëllim që të punojnë në tregtinë seksuale, sepse ato nuk janë vetëm emigrantë jolegalë të përfshirë në rrjetin e detyruar, por edhe pesona të njollosur të cilët kryejnë veprime jolegale dhe janë të lidhur me rrjetin e kriminalitetit.

Tregtia me fëmijët

Akoma nuk ekziston informatë e sigurt për tregtinë e fëmijëve në kuadër të EJL-së apo që është me prejardhje nga EJL-a. Raportet vërtetojnë se zakonisht tregtohen dy grupe të fëmijëve: vajza nën moshën 18-vjeçare për shfrytëzim seksual dhe fëmijë nën moshën 13-vjeçare, meshkuj dhe femra, me të cilët tregtohet për punë të detyrueshme, kryesisht si lypës dhe shitës rrugësh.

Sipas disa organizatave, duket se tregtarët janë gjithnjë e më të interesuar për tregtinë me fëmijë, ndërsa numri më i madh i vajzave nën moshën 18-vjeçare janë pre e shfrytëzimit seksual. Megjithatë, nuk kemi të dhëna që do ta dëshmojnë këtë parashikim, ashtu që kuptohet se edhe rritja e tregtisë me fëmijë mund të konstatohet si rezultat i ngritjes së vetëdijes për çështjen e tregtisë me njerëz të fëmijëve në rajon, në vend që kjo të bëhet në bazë të ndryshimeve reale në skemat e tregtisë me njerëz. Përveç kësaj, duket se ekziston ngatërresë për atë se çka në të vërtetë paraqet tregtia e fëmijëve. Situatat e ndryshme të eksploatimit të fëmijëve dhe të atyre që janë nënshtruar para rrezikut, përfshirë edhe punën e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve, fëmijët e ndarë apo ata pa shoqërim, llogaritet si tregti e fëmijëve. Deri tani nuk është bërë ndonjë analizë për situatat dalluese dhe nevojat e këtyre fëmijëve dhe, si rezultat i kësaj, edhe reagimet mund të mos jenë të qëlluara dhe efikase.

Gjithashtu, ka edhe informacione të reja për vendet e prejardhjes dhe të caktuar. Me fëmijë për qëllim të prostituimit dhe lypjes, nuk tregtohet vetëm në Shqipëri, por edhe në Moldavi dhe Rumania. Ata tregtohen në Itali dhe Greqi, por edhe në Rusi, Ish-Republikat Ruse, Poloni, Republikën Çeke dhe Unionin Evropian. Zakonisht, shumica e fëmijëve me të cilët tregtohet vijnë nga vendet më të varfëra dhe shpeshherë nga familje pa harmoni familjare. Shumica e tyre duket se rrjedhin nga komunitetet rome.

Akoma nuk ekziston kujdes i mjaftueshëm për çështjen e të drejtave të fëmijëve viktimat të tregtisë me njerëz dhe nuk njihen të gjitha problemet e fëmijëve dhe grave me të cilët tregtohet.

Tregtia me njerëz dhe prostitucioni i brendshëm

Ka edhe të dhëna tjera, veçanërisht nga Moldavia, Rumania dhe Bullgaria, se me gratë dhe vajzat, shpeshherë së pari tregtohet brenda vendit për shfrytëzim seksual. Për shumë vende ka të dhëna për funksionimin e tregut të brendshëm të prostitucionit, nga të cilat vijmë në përfundim se zinxhiri i tregtisë me njerëz të punëtorëve të seksit, shumë shpesh fillon në tregun lokal. Ndërmjetësit të cilët posedojnë femra e që e kontrollojnë tregun e prostitucionit të brendshëm lokal shpesh viktimat e tyre i transferojnë nga një vend në tjetrin. Pas një kohe, këto gra shiten jashtë. Megjithatë mënyra për të ardhur deri te këto informacione, për gratë të cilat punojnë në industrinë e seksit, është shumë e kufizuar, veçanërisht në vendet ku prostitucioni nuk është legal. Vëllimi real i problemit vetëm mund të parashikohet. Me disa përjashtime, thuajse nuk ekzistojnë organizata apo institucione të cilat

punëtorëve të seksit u mundësojnë informacione potenciale për rrezikun nga tregtia me njerëz dhe u ofrojnë zgjidhje për problemet e tyre.

Dallimet mes prostitucionit dhe tregtisë me njerëz janë më të zbehta

Ekzistojnë mangësi edhe në të kuptuarit e problemit nga ana e policisë. Sipas OJQ-ve, tash policia gratë e huaja i shikon si viktime potenciale të tregtisë me njerëz, por ka probleme edhe në zbatimin e standardeve të njëjta në tregjet vendore të prostitucionit. Ekzistojnë të dhëna se policia shpeshherë e shfrytëzon pozicionin e saj që të bashkëpunojë me ndërmjetësit dhe të përfitojë nga tregtia e prostitucionit lokal. Nga ky shkak ata pa dashje merren me çështjen dhunës me prostitutet dhe tregtinë e brendshme me njerëz.

Gjithashtu, ekzistojnë mangësi edhe në të kuptuarit e problemit nga ana e agjencive për sigurim publik për ekzistimin e varshmërisë së luftës kundër dhunës ndaj grave, përfshirë këtu edhe dhunën ndaj punëtorëve të seksit dhe luftën kundër tregtisë së grave për shfrytëzim seksual. Thënë shkurt, tregtia e grave nuk pengohet në nivel të brendshëm, para se ato të shiten jashtë vendit.

Nga ana tjetër ekzistojnë shembuj kur policia nën pretekstin e luftës kundër tregtisë me njerëz, realizon bastisje masive, por paraprakisht pa mbledhur fakte të domosdoshme për ndjekje ligjore të tregtarëve. Rëndom kjo përfundon me maltretimin e grave të cilat punojnë ose janë të detyruara të punojnë në industrinë e seksit dhe me deportimin e tyre, ndërsa pronarët e bareve, ndërmjetësuesit dhe tregtarët mbeten të lirë.

Rrugët e tregtisë jolegale

Viktimat e tregtisë me njerëz gjithnjë e më shpesh udhëtojnë me dokumente valide dhe gjithnjë e më shpesh drejtpërdrejt kalojnë në Evropën Perëndimore përmes rrugëve ajrore. Ky ndryshim është si pasojë e regjimit të lehtë të vizave në disa vende të EJL-së¹² që shkon në kombinim me kontrollin më të rreptë kufitar dhe masat e ndërmarra kundër tregtisë me njerëz në rajonin e EJL-së viteve të fundit.

Gjithashtu, ka të dhëna se skemat e tregtisë me njerëz në Shqipëri ndryshojnë, sepse kontrabanda me emigrantë dhe tregtia me grave me motoskafe nga Vlora për në Itali ishte penguar vetëm pas veprimeve këmbëngulëse të policisë. Vendi më i përmendur për tregti jolegale në Shqipëri tash më nuk është aktiv. Megjithatë burimet vendore janë skeptike për kohëzgjatjen efektive të këtyre aksioneve, me ç'rast i përmendin vendkalimet e tjera kufitare, të cilat i shfrytëzojnë tregtarët, siç është limani i Durrësit dhe rrugët tokësore drejt Greqisë dhe IRJ të Maqedonisë.

Tregtarët

Tregtarët nuk janë grupacion homogjen, ashtu që ata mund të identifikohen disa tipe prej tyre:

- Anëtar të grupeve të organizuara kriminele, shpesh ndërkombëtare. Janë të inkuadruar në disa tipe të aktiviteteve kriminele, ata e organizojnë tregtinë me njerëz njëlloj si kontrabandimin e mallit dhe përfitojnë nga shfrytëzimi seksual i grave me të cilat tregtohet nëpër bare/bordelet, nga pronësia e tyre apo e ndonjë të njohuri të tyre.
- Përkrahës / kriminelë të vegjël/dhe/ose persona lokal nga vendet ku rekrutohen viktimat. Ky grup shpeshherë përmban gra të cilat kanë qenë viktime, por që kanë filluar të bashkëpunojnë me kriminelët dhe të punojnë për ta si ndërmjetësues.
- Biznismenët, policët dhe politikanët, të cilët bashkëpunojnë me kriminalitetin e organizuar dhe përfitojnë nga fitimi i tregtisë me njerëz. Ata shpesh janë pronarë të bareve ose e ndihmojnë punën e tyre.

Përderisa policia e cila lufton kundër tregtisë me njerëz koncentrohet në rastin e profileve të larta dhe në luftën kundër kriminalitetit të organizuar, të a.q. grup kriminele ndërkombëtar, ajo shumë pak tregon kujdes ndaj ndërmjetësuesve dhe organizatorëve lokal. Kjo situatë zakonisht krijon implikime në procesin e integritimeve sociale të viktimave pas kthimit dhe gatishmërisë së tyre që të dëshmojnë kundër tregtarëve. Gratë të cilat kthehen prapa në shtëpi, shpesh më pak frikësohen nga kriminelët e vendeve tjera sesa nga personat lokalë të cilët kanë kontribuar për shitjen e tyre dhe i njohin ata dhe

¹² Qytetarët bullgarë (nga 2001) dhe qytetarët rumunë (nga janari i 2002) mund të marrin viza shengen, të cilat u mundësojnë të udhëtojnë pa kufizime në më shumë vende të UE-së. Ky rregull gjithashtu vlen edhe për një numër të madh të qytetarëve të Moldavisë të cilët kanë pasaportë rumune.

historitë e tyre. Meqë ata kanë lidhje me ta dhe bëjnë shantazh ndaj familjeve të tyre, kjo kuptohet se i bën të kenë frikë nga arrestimi apo burgosja e tyre.

Diskutimet, të cilat filluan në vitin 2002, për nevojën e programeve për mbrojtjen e dëshmitarëve, gjegjësisht të igrave në rajon, si dhe kërkimet për zbulim, edhe më tej vazhdojnë, ndërsa mungesat në ndjekjet gjyqësore për tregtarët dhe mangësitë në mbrojtjen e viktimave të tregtisë me njerëz u bënë njëra ndër përpërsitë e luftës kundër tregtisë me njerëz.

Nismat rajonale¹³

Edhe pse tregtia me njerëz nuk është problem i ri në rajonin e EJT-së, zhvillimi i politikës gjithpërfshirëse, nismat dhe reagimet rajonale janë relativisht jo të hershme. Para vitit 2000 disa OJQ dhe organizata ndërkombëtare reagues për situatën në terren. Megjithatë nuk ekzistonte qasje e kordinuar apo institucionale për problemin. Nga miratimi i konventës së KB kundër kriminalitetit të organizuar transnacional dhe protokollet e saj dhe krijimin e grupit punues për tregtinë me njerëz në EJT në Paktin e stabilitetit (SPTF), në shtator 2002, doli korniza institucionale për luftë kundër tregtisë me njerëz, ndërkaq në vitin 2002 u ndërmorrën një numër i madh i iniciativave nacionale, të cilat ndikuan në zhvillimin e politikës dhe reagimeve ndaj tregtisë me njerëz në vendet e EJT-së.

1. Qeveritë

1.1. Konventat ndërkombëtare

Të 11 vendet e EJT-së e ratifikuan Konventën për Eliminimin e të Tjithra Formave të Diskriminimit të Femrës (CEDAW). Shtetet antare në CEDAW janë të obliguara që t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme, përfshirë edhe ligjdhënien, që t'i përjashtojnë të gjitha format e tregtisë me njerëz të grave.¹⁴ Konventa për të drejtat e fëmijëve (CRC) e ratifikuar nga të gjitha vendet e Paktit të stabilitetit (PS) i detyron shtetet e nënshkruese të luftojnë kundër tregtisë me fëmijë.¹⁵ Protokollin plotësues i CRC-së i miratuar më herët, i detyron shtetet nënshkruese të luftojnë kundër tregtisë me fëmijë.¹⁶ Konventa nr. 182 e Organizatës Ndërkombëtare për Punë (ILO) për format më të keqja të mundimit të fëmijëve, rekomandon eliminimin e të gjitha formave të skllavërimit dhe punës së ngjashme të skllavërimit, siç është shitja dhe tregtia me njerëz e fëmijëve, shërbimi fillestar dhe puna e detyrueshme, përfshirë edhe shfrytëzimin e fëmijëve në konfliktet e armatosura.¹⁷ Të gjitha shtetet e EJT-së, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, SMZ, IJRM, Greqia, Hungaria, Moldavia, Rumania, Sllovenia Turqia dhe Ukraina më 13 dhjetor 2000e nënshkruajtën Konventën e KB-së kundër kriminalitetit të organizuar transnacional (Konventa e Palermos) dhe dy protokollet plotësuese të saj (Protokollin e Palermos për tregtinë me njerëz dhe Protokollin e Palermos për kontrabandë)¹⁸. Në margjinat e ceremonisë për nënshkrimin e Protokollit të Palermos, qeveritë e vendeve të EJT-së u takuan në mbledhjen e parë të Ministrave të SPTF-së dhe e nënshkruan Protokollin e Palermos, sipas të cilit qeveritë e të gjitha vendeve u pajtuan të përgaditin plan nacional për ndalimin, zvogëlimin dhe ndëshkimin të tregtisë me njerëz. Ata po ashtu u përcaktuan të emërojnë koordinator nacional dhe të përgatitin plane nacionale për aksion për luftë kundër tregtisë me njerëz.¹⁹

Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, SMZ-ja dhe Rumania e ratifikuan Konventën dhe protokollet e saj, ndërsa Kroacia, IJRM-ja dhe Moldavia e nënshkruan atë. Nënshkrimi i hershëm i Konventës së Palermos dhe protokollet e saja nga ana e të gjitha vendeve të rajonit, flet për përcaktimin e tyre për luftë kundër tregtisë me njerëz. Megjithatë, është vështirë të vlerësohet efikasiteti i masave të reja apo format me të cilat do të implementohen ato, sepse procesi i krijimit të strukturave nacionale dhe rajonale sapo ka filluar.

¹³ Për pasqyrë më të zgjeruar dhe kontakt, shih tabelën 1: Pasqyra e nismave rajonale, Shtesa 1 e këtij raporti.

¹⁴ CEDAW, UN GA Rez. 34/180, 18 dhjetor 1979 (neni 6). Protokollin Opcional i CEDAW-s është ratifikuar nga Kroacia, kurse është nënshkruar nga BH-ja, Bullgaria, IRJM-ja dhe Rumania.

¹⁵ CEDAW, UN GA Rez. 44/25, 20 nëntor 1989 (neni 34 dhe 35).

¹⁶ Protokollin plotësues i CRC-së i vitit 2000 për shitjen e fëmijëve, prostitucionit të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve, UN GA Rez. 54/263, 25 maj 2000 (akoma nuk ka hyrë në fuqi).

¹⁷ Konventa ILO nr.182 (Neni 3a), e ratifikuar nga Bullgaria, Kroacia dhe Rumania. Konventa ILO nr.29 në lidhje me punën e detyrueshme (neni 1 dhe 4). Është ratifikuar nga të gjitha nënshkrueset e PZC-së. Konventa ILO nr. 105 lidhur me ndalimin e punës së detyrueshme (neni 1 dhe 2), E ratifikuar nga tërë gjith PZC-ja, përveç IRJ të Maqedonisë dhe SMZ-së.

¹⁸ Shih: <http://www.uncjin.org/documents/conventions/conventions.html>. Protokollin i KB për pengimin, zvogëlimin dhe dënimin e tregtisë me njerëz dhe Protokollin I KB kundër kontrabandës së emigrantëve që kanë kaluar rrugën në këmbë, përmes ajrit apo detit, ishin paraqitur në Palermo. Protokollin i tretë kundër prodhimeve të ndaluara dhe tregtisë me armë u ofrua për t'u nënshkruar në qershor të vitit 2001.

¹⁹ Shih: http://www.osce.org/odihr/attf/attf_pd.pdf

1.2. Marrëveshjet rajonale në EJJ

Në kuadër të nismaave të tryezës së punës nr: 3 të PZC-së, qeveritë e vendeve të EJJ-së nënshkruan disa marrëveshje për bashkëpunim. Në maj të vitit 1999, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Greqia, Hungaria, IRJM-ja, Moldavia, Rumania dhe Turqia arritën marrëveshje për bashkëpunim për luftë kundër kriminalitetit në kufij (marrëveshje, nisma kooperative e EJJ-së dhe SECI-t).²⁰ Kroacia e nënshkroi dokumentin me 13 nëntor të vitit 1999, kurse Sllovenia me 29 gusht të vitit 2000. Marrëveshja SECI hyri në fuqi në shkurt të vitit 2000.

SPTF-ja e thërret Forumin Rajonal të Ministrave një herë në vit, në të cilin marrin pjesë ministrat e qeverive të vendeve të EJJ-së, të cilët bartin përgjegjësi kryesore për luftën kundër tregtisë me njerëz. Secili forum rezulton me marrëveshje të vendeve të EJJ-së në lidhje me elementin kritik të bashkëpunimit rajonal dhe përparimit në luftën kundër tregtisë me njerëz. Në mbledhjen e parë rajonale të ministrave të SPTF-së në Palermo, në dhjetor të vitit 2000, të gjitha vendet e EJJ-së e nënshkruan Deklaratën e Palermos kundër tregtisë jolegale në EJJ.²¹ Me nënshkrimin e Deklaratës kundër tregtisë jolegale, ministrat i detyrojnë vendet e tyre për implementimin efikas të programeve për pengimin, ndihmën dhe mbrojtjen e viktimave, sigurinë publike, reformat në ligjdhënie dhe ndjekje gjyqësore për tregtarët. Ata, gjithashtu, u njohën me nevojën e projekteve për ngritjen e vetëdijes për stërvitje, si dhe për bashkëpunim dhe koordinim mes shërbimeve kufitare, policisë, gjykatësve, paditësve dhe personelit konsullar. Ata u dakorduan që të takohen një herë në vit, për t'i këmbyer të dhënat për tregtinë me njerëz dhe për përparimet e arritura.

Në mbledhjen e dytë të ministrave të SPTF-së në Zagreb me 27.11.2001, ministrat e Punëve të Brendshme të EJJ-së u pajtuan të krijojnë mekanizëm rajonal për këmbim të të dhënave, diçka si metodologjia e EUROPOL-it për vendet anëtare të UE-së, dhe atë përmes shfrytëzimit të kontakteve të qendrës rajonale të SECI-t në Bukuresht dhe në koordinim me Interpolin.

Në mbledhjen e tretë të Ministrave në Tiranë me 11.12.2002, ministrat dhe përfaqësuesit e qeverive u pajtuan të nënshkruajnë legalizimin e statusit të personave me të cilët është tregtuar, duke u pajtuar që personave me të cilët është tregtuar t'u mundësohet status për qëndrim të përkohshëm, që në esencë është rehabilitim për viktimat e tregtisë me njerëz, si dhe ndjekje për tregtarët.

1.3. Grupi punues për tregtinë me njerëz i Paktit të stabilitetit të Evropës juglindore (SPTF)

SPTF-ja u formua për inkurajimin dhe përforcimin e bashkëpunimit midis vendeve të EJJ-së, me qëllim që të bëhet vlerësim dhe të shpejtohen përpjekjet ekzistuese për luftë kundër tregtisë me njerëz në rajon. Duke punuar nën mbrojtjen e OSBE-së, SPTF-ja i është përkushtuar bashkëpunimit dhe aktiviteteve integruese kundër tregtisë jolegale në EJJ për përmirësimin e efikasitetit të tyre për një kohë më të gjatë dhe shmangies nga përpjekjet e dyfishta. Aktivitetet e tyre bazohen në përparësitë dhe nevojat e vendeve të rajonit me qëllim të mbështetjes së të ariturve në rajon që janë rezultat i këtyre përpjekjeve. Për SPTF-në kjo do të thotë inkurajim dhe mbështetje për mekanizmat dhe strukturat e qëndrueshme institucionale, ku, entitetet përgjegjëse në terren, në secilin vend të rajonit, siç janë qeveritë dhe shoqëria qytetare, ndërmarrin pronësi dhe përgjegjësi të qartë, lokale, dhe, ashtu siç është paraparë, edhe pronësi dhe përgjegjësi rajonale dhe njëherit i bartin pasojat nga implementimi i masave kundër tregtisë jolegale.

SPTF-ja siguron dimensionin rajonal, çështjen e të gjitha aspekteve të tregtisë jolegale, që plotësisht të merren parasysh dhe të kyçen në aktivitetet e bashkësisë ndërkombëtare kundër tregtisë jolegale në EJJ. Strategjia e SPTF-së është që të këshillohet për interesin ndërsjellë të vendeve donatore dhe pranuese, për arritjen e rezultateve maksimale, duke gjetur nisma kundër tregtisë me njerëz që janë lehtë të ndryshueshme.²²

SPTF-ja për një kohë të shkurtër ndikoi edhe në ngritjen e vetëdijes për çështjen akute dhe komplekse të problemit, duke e vënë problemin e tregtisë me njerëz në kulmin e agjendës politike të vendeve të rajonit dhe më gjerë. Ajo zhvilloi strategji gjithpërfshirëse e cila u jep përparësi fushave të mëposhtme të veprimt: pengimit, ngritjes së vetëdijes, ndihmës dhe mbrojtjes së viktimave, kthimit dhe riintegrim

²⁰ Shih: <http://www.unecce.ogr/seci/crime/agreement.htm>

²¹ Shih: <http://www.legislationline.ogr/instandard.php?standardID=63>

²² Shih: <http://www.stabilitypact.org/trafficking/default.asp>

të viktimave, reformave në ligjdhënie, bashkëpunimit me sigurimin publik, stërvitjes, këmbimit të të dhënave dhe ngritjes së kapaciteteve.

Ekipi i ekspertëve për koordinim i SPTF-së në bashkëpunim të ngushtë me ekspertët në terren, zhvillon strategji rajonale kundër tregtisë me njerëz në EJL. Çdo organizatë në kuadër të ekipoit të SPTF-së kontribuon me ekspertë të cilët sjellin përvoja nga fusha dhe filozofinë e tyre. Anëtarë të ekipoit janë: OSBE/CPC, OSBE/ODIHR, COE, UNOHCHR, IOM, ICMPD, IMP, ILO, UNICEF, ICMC, SCF, CEDI, SPOC, UNODC/CICP, EC, UNIFEM dhe UNHCR.²³ Në këtë mënyrë CPTF-ja qeverive mund t'u sigurojë pasqyrë gjithëpërfshirëse për rreziqet komplekse të tregtisë me njerëz, të cilat janë të lidhura mes vete dhe t'u ofrojë udhëheqje dhe përvojë më të mirë në udhëheqje kundër tregtisë jolegale.

Duke i qëndruar besnike misionit të saj, SPTF-ja si instrument për koordinim e përcjell dhe e plotëson përshtatjen e Planit për aksion disavjeçar për EJL-në kundër tregtisë me njerëz²⁴. Ky plan del nga misionet zbuluese të SPTF-së në vendet e rajonit, të cilat edhe i kanë identifikuar kapacitetet, nevojat dhe mangësitë. Kjo paraqet kornizë gjithëpërfshirëse për të gjithë aktivitetet relevante dhe i përpunon aktivitetet e fushave kryesore, duke e përfshirë edhe vetëdijen, stërvitjen dhe rritjen e kapaciteteve, bashkëpunimin në sigurimin publik, mbrojtjen për viktimat, kthimin dhe riintegrimin, reformat në ligjdhënie dhe preventivën.

Përveç kësaj, SPTF-ja vendeve të EJL-së u siguron mundësi të mëdha për zhvillimin e Planeve të tyre për Aksion Nacional (PNA)²⁵, të cilat i identifikojnë përparësitë e tyre në luftën kundër tregtisë me njerëz dhe nevojën e tyre për ndihmë ndërkombëtare. Procesi i zhvillimit dhe i implementimit të PNA-së që është menduar si proces transparent dhe demokratik, i bazuar në principe të të drejtave të njeriut, kishte pasoja të drejtpërdrejta jo vetëm në punën kundër tregtisë jolegale, por në mënyrë të tërthortë ndikoi për t'u bërë model i funksionimit të shteteve demokratike në ndërtimin e bashkëpunimit midis institucioneve të ndryshme dhe pjesmarrjes kufitare të shoqërisë qytetare në jetën shoqëro-politike. Sipas udhëzimeve të SPTF-së, të gjitha vendet e EJL-së kanë krijuar mekanizma për implementimin e këtyre planeve. Secili vend:

- Ka emëruar koordinator nacional/qeveritar, i cili i koordinon masat kundër tregtisë me njerëz në kuadër të qeverisë dhe është person kontaktues me të gjitha entitetet e përfshira në luftën kundër tregtisë me njerëz në atë vend; dhe
- Ka krijuar grupe punuese multidisiplinore nacionale të përbëra nga përfaqësues kryesorë të ministrive, organizatave ndërkombëtare, OJQ-ve dhe organizatave ndërqeveritare.

Në kuadër të aktiviteteve të shumta kundër tregtisë jolegale, SPTF-ja i identifikoi edhe përparësitë për vitin 2003, përfshirë edhe dy zona me rëndësi specifike – tregtia me fëmijë dhe mbrojtja e viktimave/dëshmitarëve:

1. Preventiva ndaj tregtisë me fëmijë - sipas punës së përgatitur nga UNICEF-i, SCF-ja, ILO/IPEC-i dhe përvojën në terren të Torre des Hommes, SPTF-ja përqëndrohet në preventivën e tregtisë me fëmijë, përfshirë këtu edhe programe edukative nëpër shkolla. Kjo çështje ishte temë e bisedimeve (si dhe mbrojtja e viktimave/dëshmitarëve) në mbledhjen e pestë të SPTF-së në Portorozh të Slovenisë në mars të vitit 2003.
2. Mbrojtja e viktimave/dëshmitarëve - mbrojtja është njëri ndër parakushtet për rehabilitimin e viktimave, si dhe mundësia për të dëshmuar kundër tregtarëve. Grupi punues ka për qëllim që t'i modifikojë qasjet dalluese për mbrojtjen e dëshmitarëve, duke i vënë në dukje nevojat speciale të viktimave që do të pajtohen të dëshmojnë.
3. Qëndrimi i përkohshëm – SPTF-ja edhe më tej vazhdon ta promovojë nismën për legalizimin e statusit të personave me të cilët është tregtuar dhe në ligjet dhe qëndrimin e përkohshëm ta fusë në përvojën e të gjitha vendeve të EJL-it. Viktimave të tregtisë me njerëz patjetër duhet t'u jepet status legal që ata të mund të qëndrojnë në vendet e caktuara, derisa të mos dëshmojnë kundër tregtarëve. Me këtë, atyre së paku do t'u mundësohet status i qëndrimit të përkohshëm në vend të deportimit të menjëhershëm.

²³ Shih: Shkurtesa dhe akronime

²⁴ Për këtë dokument shikojeni faqen: <http://www.osce.org/attf/index.php3?sc=introduction>

²⁵ Për orientimet e NAP-it, të përgatitura nga vendet e EJL, vizitoni faqen: <http://www.osce.org/attf/index.php3?sc=introduction>

4. Rastet e rrënjëve të tregtisë jolegale – SPTF-ja edhe më tej planifikon të zhvillojë elemente dhe strategji politike për t'u ballafaqur me rrënjët e tregtisë me njerëz, në veçanti me rastet e feminizimit të varfërisë dhe me raste të tjera ekonomike dhe sociale.
5. Aspekti i kërkimeve – SPTF-ja, në bashkëpunim me vendet e caktuar planifikon të bëjë përmbledhjen e përvojave më të mira dhe të promovojë aktivitete efikase të ballafaqimit me kërkesat e tregtisë jolegale (toleranca nulta) si pjesë e qasjes gjithpërfshirëse drejt luftës kundër tregtisë jolegale me njerëz.

1.4. Pika e kryqëzimit rajonal

SPTF-ja, me qëllim të promovimit të programeve gjithpërfshirëse, përkatëse dhe të koordinuara mirë, iniconte pikën e kryqëzimit rajonal kundër tregtisë me njerëz në qershor të vitit 2002, për ndihmë dhe mbrojtje të dëshmitarëve në gjithë rajonin e EJL-së. E vendosur në Beograd, pika e kryqëzimit rajonal udhëhiqet nga IOM-i me përkrahje të ICMC-së. Ajo analizon dhe tubon të dhëna për viktimat e tregtisë me njerëz, si dhe përgatitë projekte për ndihmë dhe mbrojtje të viktimave në rajon²⁶.

Përveç ripërtitjes së të dhënave të shifrave për ndihmë, projekteve dhe trendeve në lidhje me tregtinë e grave për qëllime seksuale, pika e kryqëzimit rajonal zhvillon edhe metodologji për mbledhjen e të dhënave të cilat kanë të bëjnë me tregtinë me njerëz të fëmijëve dhe të të rinjve nën moshën 18-vjeçare që tregtohen për shfrytëzim seksual, punë të detyrueshme dhe për të punuar si lypës rrugësh.

Hapi i ardhshëm do të jetë nevoja për mbledhjen e të dhënave për t'i ndihmuar shtetit në mbrojtjen dhe ndihmën për viktimat në rajon, duke vënë në pah përvojat më të mira dhe sigurimin e rekomandimeve para këshillit rajonal dhe SPTF-së. Gjatë aktiviteteve të ardhshme, pika e kryqëzimit rajonal do të formojë standarde minimale, duke filluar nga standardet për vendosjen e viktimave dhe projekteve për kthimin e tyre.

1.5. Tryeza e punës nr. 3 e PZC-së – Projekti për reforma në sektorin e sigurimit.

Nga nëntori i vitit 2001, Qendra Universitare për Studime të Sigurisë Ndërkombëtare në Nju Jork, në emër të tryezës punuese nr. 3 të PZC-së, zhvillon inventar të nismave për reforma në sistemin sigurisë, ku është e përfshirë komuniteti ndërkombëtar i EJL-së. Duke u mbështetur në këto të dhëna, si dhe duke u mbështetur në kontributin e burimeve rajonale, Qendra për Studime Ndërkombëtare të Sigurisë zhvillon analiza konkrete për mangësitë e shteteve, si dhe përpjekje për t'u identifikuar elementet nga plani i reformave në sektorin e sigurisë, ku është i nevojshëm kujdesi plotësues ndërkombëtar ose ndihma.²⁷

1.6. Nisma për Bashkëpunim në Evropën Juglindore (SECI)

Qendra rajonale për luftë kundër kriminalitetit të organizuar - SECI, u formua si rezultat i marrëveshjes për bashkëpunim në pengimin e kriminalitetit ndërkufitar, marrëveshje kjo për bashkëpunim mes agjencive të sigurimit publik të nënshkruar nga vendet e EJL-së.

Grupi punues për luftë kundër tregtisë jolegale me njerëz u formua në maj të vitit 2000 si nismë e Qeverisë Rumune dhe është i përbërë nga grupi punues rajonal dhe nga koordinatori rajonal.

Struktura rajonale mbështetet nga strukturat vendore, të cilat janë në krijim e sipër. Grupet punuese nacionale në të gjitha vendet e SECI-t udhëhiqen nga koordinatore nacionale (edhe pse në disa vende ende nuk janë emëruar). Grupi punues i SECI-t punon përmes oficerëve për lidhje nga të gjitha vendet pjesëmarrëse, të cilët punojnë në qendrën SECI-t në Bukuresht. Ata janë në kontakt të vazhdueshëm me qeveritë e tyre nacionale, kontakt që realizohet përmes pikave të fokusuara nacionale, personave me të cilët komunikojnë drejtpërdrejt me koordinatorët nacional dhe qendrave nacionale për tregtinë me njerëz.²⁸

Pas dy vjet pune të këtij grupi punues, udhëheqësia e qendrës SECI në fillim të vitit 2002 e inkurajoi idenë për bashkëpunim rajonal. Ky bashkëpunim rajonal koordinohet nga Rumania dhe kishte për qëllimet të bëjë:

²⁶ Raporti i parë është publikuar në shtator të vitit 2003 dhe mund të gjendet në: <http://www.osce.org/attf/index.php3?sc=RCP>

²⁷ Veb faqja e projektit, e cila ka qasje deri te baza e të dhënave, gjendet në: <http://sr.yciss.yorku.ca/>.

²⁸ Nisma kooperative e EJL-së, materialet informative të SECI-t, Bukuresht, 2001.

- Identifikimin e grave të huaja me të cilat është tregtuar në të gjitha vendet e EJL-së, përmes aktiviteteve të koordinuara të agjencive për siguri publike, organizatave ndërkombëtare, institucioneve dhe OJQ-ve, si dhe për të ndërmarrë masa efektive për sigurimin dhe riatdhësimin e tyre në vendet e prejardhjes;
- Identifikimin e grupeve kriminele dhe anëtarët e grupeve të përfshira në tregtinë me gra;
- Inicimin e hetimeve të përbashkëta kundër grupeve kriminele që janë të përfshira në tregtinë me njerëz, duke e bërë këtë në bashkëpunim të ngushtë me agjencitë për sigurim publik të të gjitha vendeve;
- Dallimin e personave të cilët jolegalisht kanë kaluar në vendet e huaja, si dhe identifikimin e grupeve kriminele dhe anëtarët e atyre grupeve, të cilët janë të përfshirë në kontrabandën me njerëz, përmes aktiviteteve kooperative të agjencive për sigurim publik, organizatave ndërkombëtare, institucioneve dhe OJQ-ve; dhe
- Inicimin e hetimeve të përbashkëta kundër kriminelëve dhe zhvillimin e bashkëpunimit më të afërt mes agjencive për sigurim publik, vendeve të SECI-t dhe vëzhguesve.

Operacioni Mirazh ishte përpjekja e parë për të zbatuar operacionin rajonal të qendrës SECI, për pengimin e tregtisë me njerëz dhe emigrimin jolegal.²⁹

2. Organizatat ndërkombëtare

Ekzistojnë më shumë organizata rajonale të cilat punojnë në çështjen e tregtisë jolegale në rajon. Organizatat që do t'i përmendim këtu në veçanti janë aktive në këtë fushë:

2.1. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)

Qasja e OSBE-së ndaj sigurisë është gjithpërfshirëse dhe kooperative. Ajo është gjithpërfshirëse në ballafaqimin me një spektër më të gjërë të çështjeve të sigurisë, duke e përfshirë armatimin jolegal, diplomacinë preventive, masat për rritjen e besimit dhe sigurisë, të drejtat e njeriut, demokracinë, vëzhgimin e zgjedhjeve dhe sigurinë në ekonomi dhe ekologji, bashkëpunimin në kuptimin se të gjitha vendet pjesëmarrëse në OSBE kanë status të njëjtë, ndërsa vendimet merren me konsensus.

Përpjekjet e OSBE-së kundër tregtisë jolegal, viteve të fundit rezultuan me një ngritje të vetëdijes midis shteteve pjesëmarrëse në OSBE dhe në përforcimin e obligimeve në këtë fushë. Vendet pjesëmarrëse në OSBE e pranuan përgjegjësinë kryesore të tyre për pengimin dhe luftën kundër tregtisë jolegal, si dhe për ndihmën e viktimave të tyre që të ndërmarrin masa për t'u ballafaquar me këto çështje.

Përpjekja e parë dhe kryesore e OSBE-së në fushën e luftës kundër tregtisë me njerëz ishte miratuar në Vjenë në vitin 2000, e miratuar si vendim i Këshillit të Ministrave nr.1 dhe ishte plotësuar me vendimin e Këshillit të përhershëm nr: 426, vendimin e Këshillit të përhershëm nr: 6 (të miratuar në Bukuresht në vitin 2001) dhe Deklaratën e Këshillit të Ministrave për tregtinë me njerëz, të miratuar në Porto në vitin 2002.³⁰ Duke e plotësuar përpjekjet ekzistuese, OSBE-ja, përmes grupit punues joformal të saj për barazi dhe luftë kundër tregtisë me njerëz, hartoi plan detal - plani i OSBE-së për luftë kundër tregtisë me njerëz³¹. Ky plan aksional jo vetëm që rekomandon aktivitete specifike për shtetet anëtare të OSBE-së në fushën e preventivës, mbrojtjes dhe ndjekjes gjyqësore, por gjithashtu dërgon edhe trupa relevantë dhe misione për hartimin e angazhimeve ekzistuese përmes ndihmës teknike të shteteve ekzistuese, si dhe me ballafaqimin me çështjet e brendshme organizative, siç është implementimi i kodeksit të sjelljes³² dhe stërvitja përkatëse e personelit.

OSBE/Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejta të njeriut (OSBE/ODIHR ose ODIHR)

ODIHR është në ballë të përpjekjeve ndërkombëtare për pengimin e tregtisë me njerëz dhe për të siguruar përgjegjësi kooperative e cila në vend të parë i vë të drejtat e viktimave. ODIHR krijon dhe

²⁹ Shih: Studimi rajonal, fq. 29

³⁰ Tërësia e teksteve është on-line në: <http://www.osce.org/docs/>

³¹ Shih: <http://www.osce.org/docs/english/pc/2003/decisions/pced557.pdf> i miratuar nga Këshilli i përhershëm i OBSE në korrik të vitit 2003

³² Kodeksi për sjellje i misionëve të OSBE-së mund të gjenden në: <http://www.osce.org/secretariate/general/documents/code-conduct.pdf>

implementon programe kundër tregtisë me njerëz të cilat fokusohen në ngritjen e vetëdijes, rishqyrtim dhe reformat në ligjdhënie, si dhe në ngritjen e kapaciteteve të OJQ-ve për mundësi në këshilla dhe ndihmë të drejtpërdrejtë për viktimat.

Përmes ndihmës në krijimin e mekanizmave nacionalë, ODIHR përpiket të vendosë edhe kornizë kooperative, përmes së cilës obligimet e shteteve për mbrojtjen e të drejtave të viktimave dhe organizimin e mbështetjes, janë të koordinuara me shërbime të cilat i ofron shoqëria civile. Veprimtaritë kundër tregtisë jolegale të ODIHR-së mbulojnë një spektër të gjerë të çështjeve tematike, por në mënyrë të veçantë fokusohen në preventivën dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Në kuadër të SPTF-së, ODIHR-ja, bashkë me CoE dhe UNODC-në, koordinon me fushën e rishqyrtimit edhe reformat në ligjdhënie dhe i mbështet këto përpjekje përmes këmbimit të ekspertëve dhe lobimit plotësues politik. Me këtë qëllim udhërrëfimi për rishqyrtim dhe reforma në ligjdhënien kundër tregtisë jolegale në ODIHR, është mjeti më i dobishëm për ngritjen e vetëdijes për çështjen komplekse të tregtisë jolegal dhe nevoja për ndryshime relevante në ligjdhënie.³³

Me qëllim t'i përgjigjet shkeljes së të drejtave të njeriut dhe ta thejë ciklin e keqpërdorimit, patjetër duhet të zhvillohet mekanizëm përmes të cilit aktorët shtetëror do të mund t'i plotësojnë obligimet e tyre për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe të njerëzve me të cilët është tregtuar, në pajtim dhe partneritet strategjikë me shoqërinë qytetare dhe të gjithë aktorët tjerë të cilët ballafaqohen me viktimat e tregtisë me njerëz. Me qëllim që të ndihmohet ky proces, ODIHR-ja krijoi një doracak për orientim, si dhe principe për krijimin dhe implementimin e mekanizmave nacional për udhëzime.

Njësia për luftë kundër tregtisë jolegale të ODIHR-së, kryesisht në misionet e saj të OSBE-së, gjithnjë e më shumë merret me rolin e një shtëpie klinike duke ndihmuar përmes konsultimeve në krijimin e rrjetave dhe këmbimin e të dhënave.

Misionet e OSBE-së në terren

OSBE-ja ndërtoi një rrjet të gjerë të pikave lokale kundër tregtisë me njerëz (operatorë terreni) me qëllim që vendeve anëtare të OSBE-së t'u ndihmohet në plotësimin e përcaktimeve të tyre për pengimin dhe luftën kundër tregtisë me njerëz.³⁴ Misionet e OSBE-së në terren kanë rol vital në punën kundër tregtisë jolegale në vendet e tyre nikoqire, duke përfshirë monitoringun dhe implementimin e projekteve. Përmes fondit të projektit për luftë kundër tregtisë jolegale në OSBE, misionet e OSBE-së janë të inkurajuar dhe të mbështetura që me partnerët lokal të krijojnë dhe implementojnë projekte kundër tregtisë jolegale.

2.2. Këshilli i Europës (CoE)

Si organizatë panevropiane, Këshilli i Europës në mesin e 45-vendeve anëtare të saj përfshin vende të prejdardhjes, vende tranzitore dhe të caktuar të viktimave të tregtisë me njerëz. Lufta me tregtinë me njerëz ka një rëndësi të madhe për CoE-n dhe është çështje kyçe e agjendës së saj për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Çdo masë e marrë për luftën kundër tregtisë jolegal nuk duhet të ndikojë në të drejtat e njeriut ose në dinjitetin e njeriut, posaçërisht në të drejtat e viktimave të tregtisë me njerëz. CoE hartoi disa tekste ndërkombëtare të të drejtave të cilat kanë të bëjnë në mënyrën specifike të tregtisë me njerëz për qëllime seksuale:

- Rekomandimin nr. R (2000) 11 për aktivitetet kundër tregtisë me njerëz për qëllim seksuale të datës 19.05.2000;
- Rekomandimin nr. R (2001) 16 për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual;
- Rekomandimi nr. R 1454 (2002) të Kuvendit parlamentar të CoE-së për fushatën kundër tregtisë me njerëz.³⁵

Instrumentet e tjera juridike që janë përshkruar nga CoE-ja janë relative në këtë fushë, posaçërisht ato që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të drejtat e fëmijëve, të drejtat sociale, me viktimat dhe të dhënat personale, si dhe ato që kanë të bëjnë me korrupsionin, kriminalitetin e

³³ Shih: <http://www.osce.org/odihr/>

³⁴ Shih: http://www.osce.org/field_activities/

³⁵ Shih: http://www.CoE.int/T/E/human_rights/trafficking/1_overvieë/introduction.asp# top of page

organizuar, larjen e parave, kriminalitetin kompjuterik, duke përfshirë edhe marrëveshjet për bashkëpunim ndërkombëtarë për çështje kundërvajtëse e kështu me radhë.³⁶

CoE, gjithashtu, formoi një grup ekspertësh që ta shohin rëndësinë e ndikimit të teknologjisë së re për tregtinë me njerëz për qëllime seksuale. Raporti i përgatitur nga ky grup ishte publikuar në vitin 2003. Gjithashtu, që nga viti 2002, një grup ekspertësh merret me çështjen e mbrojtjes së fëmijëve nga shfrytëzimi seksual.³⁷

Përfundimisht, si pjesë e kontributit të nismave të PZC-së, CoE-ja implementoi projekt pilot në Rumani dhe Moldavi – Reforma në ligjin për kundërvajtje për tregtinë me njerëz në Evropën Juglindore (i njohur edhe si Projekti Lara). Ky projekt kishte për qëllim që të kontribuojë për kriminalizimin efikas të tregtisë me njerëz në nivel rajonal dhe për sigurimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut për personat me të cilët është tregtuar. Pas suksesit të aktiviteteve nga projekti pilot, projekti u zgjerua në të gjitha vendet e EJT-së, me qëllim që kështu të mbështeten reformat në ligjet kundërvajtëse rajonale për pengimin dhe luftën kundër tregtisë me njerëz. CoE-ja projektin e saj Lara e lansoi në korrik të vitit 2002.³⁸

Megjithatë, CoE-ja llogarit se tani nuk mjafton të mbështetemi vetëm në rekomandimet dhe aktivitetet konkrete. Ata llogaritin se është koha që të hartohet instrumenti obligues ndërkombëtar – Konventa Europiane për aktivitete kundër tregtisë me njerëz. Vështrimi i fenomenit të tregtisë jolegale në mediumet evropiane dhe masat të cilat patjetër duhet të përshtaten për luftë efikase, evaluam ashtu që u bë i domosdoshëm formimi i instrumentit obligues juridik që do të jetë i orientuar drejt mbrojtjes së të drejtave të viktimave dhe respektimin e të drejtave të njeriut, si dhe të jetë baraspeshë e mirë ndërmjet të drejtave të njeriut dhe ndjekjes gjyqsore.

2.3. Organizata Ndërkombëtare për Emigrim (IOM)

IOM-i iu ka përkushtuar principit se emigrimi i vazhdueshëm i njerëzve është ndihmë për emigrantët dhe shoqërisë i ndihmon në plotësimin e nxitjeve operative të emigrimit, të kuptuarit të avancuar të çështjeve të emigrimit, inkurajimin e zhvillimit social dhe ekonomik përmes emigrimit dhe veprimin në drejtim të respektimit efektiv të dinjitetit njerëzor dhe statusit social të emigrantëve.³⁹ Nën titullin Tregtia me emigrantë, IOM-i në mënyrë të veçantë u kushton kujdes atyre emigrantëve të cilët tani apo në të kaluarën janë mashtruar ose janë detyruar në gjendje të eksploatimit ekonomik, që pastaj të shndërrohet në punë të detyrueshme, shërbim të detyrueshëm, marrëdhënie të kushtëzuara apo çënime të tjera të të drejtave të tyre elementare njerëzore. Gjithashtu, IOM-i brengoset edhe për tregtinë jolegale, sepse ajo paraqet problem për udhëheqjen me emigrantët në vendet e prejardhjes, si edhe me ata të vendeve tranzitore dhe në vendet e cakut.⁴⁰ IOM-i është aktiv në aktivitetet kundër tregtisë me njerëz që nga viti e 90-ta. IOM-i shfrytëzon qasje të gjithanshme për pengimin e tregtisë me njerëz, si dhe mbrojtje të viktimave përmes partneriteteve kooperative në vendet e prejardhjes, vendet tranzitore dhe vendet e cakut.

Preventiva

Në fushën e preventivës, IOM-i në vendet e prejardhjes realizon fushatën informative për informimin e viktimave potenciale për rrezikun nga tregtia me njerëz dhe emigrimi jolegal. Aktivitetet e ngritjes së vetëdijes të IOM-it u fokusuan në shkolla, njësitë rurale dhe urbane, si dhe në familje. Metodologjia e krijuar për secilin grup qëllimor shërbehet me aktivitete të ndryshme komunikative dhe me shumë takime me gazetarët. Përmes medimeve masive, informacioni shpejt arrin deri te publiku më i gjerë, ndërsa kontaktet e drejtpërdrejta mundësojnë ambient joformal, që është i nevojshëm për biseda të hapura dhe më të thella.

Ndihma dhe mbrojtja

Për ndihmë dhe mbrojtje të viktimave të tregtisë me njerëz, IOM-i bashkëpunon me OJQ-të, organizatat tjera ndërkombëtare dhe agjencitë qeveritare që kështu të sigurojë këshilla juridike e

³⁶ Shih: http://www.CoE.int/T/E/human_rights/

³⁷ Për raportin e plotë shih: http://www.CoE.int/T/E/human_rights/trafficking/3_documents/reports/default.asp#topofpage

³⁸ Për raportin e plotë shih: http://www.CoE.int/T/E/human_rights/trafficking/3_documents/reports/default.asp#topofpage

³⁹ Rezoluta nr. 923 (LXXI) nga 27.11.1995

⁴⁰ Për më tepër shih: http://www.iom.int/en/ëho/main_policies_trafficking.shtml

mjekësore dhe shërbime të tjera sociale. Viktimave u ofrohen bujti të sigurt dhe vendosje të sigurt, pastaj kthim vullnetar dhe riintegrim. Ndihma e përgjithshme, kthimi vullnetar dhe riintegrimi, të cilin e ofron IOM-i për viktimat e tregtisë me njerëz është e lidhur me komponentën e riintegritit të viktimës në vendet e prejardhjes. Pakoja e ndihmës për riintegrim e IOM-it është krijuar që të sigurohet riintegrim dinjitoz i viktimave në shoqëri. Pikërisht për këtë pranuesit patjetër duhet të japin pëlqimin e tyre informues para se të marrin ndihmë.

Projektet e reja të IOM-it për preventivë dhe ndihmë për viktimat

Nga muaji maj 2001, IOM-i implementoi projekt rajonal, të financuar nga SIDA,⁴¹ me të cilin viktimave të tregtisë me njerëz u jep mundësi për kthim të sigurt dhe dinjitoz në vendet e tyre amë, si dhe këshilla psikologjike dhe ngritje të vetëdijes në strehimore dhe informim juridik. Deri në janar të vitit 2003, projekti mbuloi Shqipërinë, BH-në, Kroacinë, IRJM-në, Moldavinë, SMZ-në, përfshirë edhe Kosovën, Rumaninë dhe Ukrainën. Projekti implementoi aktivitete të fokusuara në aspektin e preventivës ndaj tregtisë me njerëz, përmes sigurimit të mbështetjes institucionale të pjesëmarrësve qeveritarë dhe joqeveritarë, si dhe të organizatave ndërkombëtare për zhvillim të sistemit të përcjelljes efikase dhe të koordinuar, i cili do të mundësojë që t'i mbrojtë dhe t'i ndihmojë viktimat nga tregtia me njerëz.⁴² Në kuadër të SPTF-së, IOM-i është agjenci prijëse për ndihmë gjatë kthimit dhe reintegritit.

2.4. Zyra e Komesarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut në KB (UNOHCHR)

Misioni i UNOHCHR-së është mbrojtja dhe promovimi i të gjitha të drejtave të njeriut për të gjithë njerëzit. UNOHCHR-ja në punët e saj udhëhiqet me Konventën e KB, Deklaratën Universale për të drejtat e njeriut dhe instrumentet përcjellëse për të drejtat e njeriut, Deklaratën e Vjenës dhe Programën për aksion të vitit 1993. Promovimi i ratifikimit universal dhe implementimi i konventave për të drejtat e njeriut është aktiviteti më i rëndësishëm i UNOHCHR-it. UNOHCHR-ja aktivitetin e saj e bazon në principin se të drejtat e njeriut janë universale, të pandara, të varura të lidhura ndërmjet vete. Programi për tregtinë jolegale i UNOHCHR-së ishte formuar në vitin 1999. Projekti i ka katër qëllime thelbësore:

1. Sigurimi dhe rritja e kapacitetit të Komesarit të Lartë, që kështu të sigurojë politikë udhëheqëse për çështjet e tregtisë jolegale;
2. Forcimi i kapacitetit të UNOHCHR-it dhe sistemit për të drejtat e njeriut të KB-së për t'u ballafaquar me dimensionin e të drejtave të njeriut të tregtisë jolegale;
3. Sigurimi i integritetit dhe perspektivës së të drejtave të njeriut në punën kundër tregtisë jolegale të agjencive të tjera dhe programeve të KB-së dhe ngritja e vetëdijes dhe njohjen për tregtinë jolegale si çështje e të drejtave të njeriut në gjithë sistemin e KB-së; dhe
4. Inkurajimi i qeverive dhe organizatave të jashtme (organizatat ndërqeveritare, organizatat joqeveritare, organizatat ndërkombëtare, organizatat joqeveritare nacionale dhe institucionet nacionale për të drejtat e njeriut) që ta kenë parasysh çështjen e tregtisë jolegale në politikën dhe aktivitetet e tyre.

Deri para do kohe, Programi për tregtinë jolegale i UNOHCHR-së ishte i fokusuar në sigurimin e standardeve përmes formulimit të mjeteve dhe instrumenteve të të drejtave të njeriut. Kjo ishte arritur me krijimin e principeve të qarta dhe orintimeve për ndihmë dhe mbrojtje të viktimave. Në korrik të vitit 2002, Komesari i Lartë për të Drejtat e Njeriut i publikoi principet dhe orientimet e rekomanduara për të drejtat e njeriut dhe tregtinë me njerëz.⁴³ Principet dhe orientimet e tij janë zhvilluar ashtu që të sigurohet orientim praktik në politikën për preventivë në tregtinë jolegale dhe mbrojtjen e viktimave të tregtisë me njerëz që është e mbështetur në të drejtat. Qëllimi i tyre është promovimi dhe sigurimi i integritetit të perspektivës së të drejtave të njeriut në ligjeve, politikave dhe itervenimeve nacionale, rajonale dhe ndërkombëtare kundër tregtisë jolegale.

Faza e ardhshme e programit do të fokusohet në preventivë, duke e përforcuar njëkohësisht edhe ndihmën dhe mbrojtjen e viktimave. Do të ndiqen qasje të dyanshme strategjike:

1. Preventiva e tregtisë me njerëz: Kjo nënkupton ndërlikime të qarta me të gjitha çështjet zhvillimore, përfshirë edhe zbatimin e ligjit, emigrimin jolegal, punën e detyrueshme dhe diskriminimin gjinor, të cilat nxitin lëndim nga disa të këqija;

⁴¹ Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar

⁴² Per evaluimin e projektit të IOM-it, Shih: Programi rajonal i IOM-it kundër tregtisë me njerëz në Ballkanin Perëndimor, Raport i SIDA-s, korrik 2003.

⁴³ Orientimet mund të shihen në: [http://www.unhcr.ch/huridocda/huridocda.nsf/\(symbol\)/E.2002.68.add.1.en?opendocument](http://www.unhcr.ch/huridocda/huridocda.nsf/(symbol)/E.2002.68.add.1.en?opendocument)

2. Mbrojtja e viktimave nga tregtia me njerëz: Kjo nënkupton përforsim të iniciativave juridike dhe politike, si dhe programe të cilat do të mundësojnë ndihmë dhe mbrojtje për viktimat e tregtisë me njerëz përmes dënimit të tregtarëve dhe zhvillimin e programeve për riintegrim të viktimave, strehim, stërvitje dhe skema të riintegrit.

Qasja strategjike e dyanshme do të realizohet përmes fokusimit të agjendës thelbësore të të drejtave të njeriut të

UNOHCHR në këto pika të rëndësishme:

1. Përforsimi i aktiviteteve të KB-së që janë të orientuara kah të drejtat e njeriut në nivel shtetëror nën Planin për aksion të Komitetit Ekzekutiv të grupit Zhvillimor të KB-së për çështje humanitare, përmes rritjes së kapaciteteve të ekepeve shtetërore dhe ndërtimin e preventivës ndaj tregtisë jolegale në kontekst të çështjeve zhvillimore;
2. Vazhdimi me aktiviteteve e caktuara dhe agjendën e mekanizmave të ndryshëm për të drejtat e njeriut dhe me integrimin më të mirë në çështjen e tregtisë jolegale në punën e trupave të me të cilët jemi marrë vesh, procedurave speciale, grupeve punuese dhe komisionit për të drejtat e njeriut; dhe
3. Përforsimi i partneriteteve dhe bashkëpunimit në formë të organizimit (puna e interagjencive) dhe në formë tematike (tema interdisiplinore, siç është tregtia jolegale dhe gjinia, pakicat etj.)

2.5. Fondi i Fëmijëve i KB-së (UNICEF)

UNICEF-i punon në të gjitha vendet në zhvillim, pa dallim të sistemeve ekonomike, politike apo sociale, gjithë kjo me qëllim të avancimit të të drejtave të fëmijëve dhe grave të cilat janë në buzë ekzistencës, për zhvillimin, mbrojtjen dhe pjesëmarrjen e tyre sipas kornizave që i përmban Konventa për Zhvillimin e Fëmijëve (CRC)⁴⁴ dhe Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Gruas (CEDAW).⁴⁵ Marrë në përgjithësi, përvoja e UNICEF-it për t'u ballafaquar me tregtinë me njerëz dhe shfrytëzimin seksual komercial të fëmijëve në Azi dhe në Afrikën Perëndimore fokusohet në ngritjen e vetëdijes publike, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe përmirësimin e gjendjes së fëmijëve në rrezik.

Në kuadër të SPTF-së dhe në bashkëpunim me organizatën “Shpëtoni fëmijët”, UNICEF-i është agjencia prijëse për ngritjen e vetëdijes. Këto organizata gjithashtu janë të interesuara për një qasje më të gjerë në pengimin e tregtisë me gra dhe fëmijë duke u ballafaquar me rastet e përmendura - përmes fokusimit të masave speciale për mbrojtjen e fëmijëve, dhunës gjinore, zhvillimin e shkathtësive të të rinjve për jetë, për mbrojtjen e tyre nga shfrytëzimi, përfshirë edhe rezikun nga sëmundje seksuale HIV/SIDA dhe tregtia me njerëz.

Në bashkëpunim me ILO-n dhe organizatën “Shpëtoni fëmijët”, UNICEF-i mundësoi që çështja e tregtisë me njerëz dhe mbrojtja e fëmijëve të vijë në rend dite në SPTF. UNICEF-i përgatiti analizë për gjendjen dhe së bashku me organizatën “Shpëtoni fëmijët” dhe ILO-n zhvilloi strategji për përparësitë dhe rekomandimet për tregtinë me fëmijë dhe mbrojtjen e tyre në EJL.⁴⁶

Në përgjigje të kërkesës së SPTF-së dhe në bashkëpunim me qeveritë dhe OJQ-të e vendeve të EJL-së, UNICEF-i zhvilloi orientime për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në EJL⁴⁷ që janë viktima të tregtisë me njerëz, gjë që është hapi i parë i kalimit nga teoria dhe standardet në praktikë, me theks të veçantë në mbrojtje dhe ndihmën për fëmijët viktima të tregtisë me njerëz nga identifikimi elementar deri te integrimi përfundimtar dhe sanimi i fëmijës. Këto drejtime janë zhvilluar në bazë të instrumenteve relevante ndërkombëtare dhe rajonale,⁴⁸ të cilat janë nënshkruar dhe ratifikuar nga vendet e EJL-së dhe në pajtueshmëri me të cilën janë të obliguar t'i rishqyrtojnë/interpretojnë ligjet e veta. Orientimet na mundësojnë kontroll të drejtpërdrejtë të politikës dhe përvojës së domosdoshme për implementimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve – viktima të tregtisë me njerëz. Ata kanë për

⁴⁴ Mund të gjendet në: www.unicef.org/crc/convention.html

⁴⁵ Mund të gjendet në: www.un.org/ëomenëatch/daë/CEDAW/

⁴⁶ Mund të gjendet në: www.seerights.org

⁴⁷ Orientimet e UNICEF-it për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktima të tregtisë me njerëz në EJL, korrik 2003. Mund të gjenden në: www.seerights.org

⁴⁸ Duke përfshirë Konventën për të Drejtat e Fëmijëve (CRC), protokollin plotësues të CRC-së për tregtinë me fëmijë, mbrojtjen e fëmijëve dhe pornografinë fëmijërore. Protokollin i KB për pengim, zvogëlim dhe dënim të tregtisë me njerëz, në veçanti për gratë dhe fëmijët, me plotësim të Konventës së KB për kriminalitetin e organizuar transnacional (Protokollin i Palermos për tregtinë ilegale) dhe Konventa ILO 182 për format më të këqija të punës së fëmijëve.

qëllim që qeverive dhe agjencive shtetërore, organizatave ndërkombëtare dhe OJQ-ve t'u mundësojnë udhëheqje në zhvillimin e masave të veçanta për mbrojtjen e fëmijëve – viktima të tregtisë me njerëz.

Në bashkëpunim me Universitetin e Kolumbias (Nju Jork), UNICEF bëri një analizë dhe një vlerësim të projekteve aktuale për ngritjen e vetëdijes dhe preventivës në Shqipëri, Moldavi dhe Rumani, me qëllim të evaluimit të efekteve dhe mangësive në qasjet aktuale.⁴⁹ Raporti i paraqet rezultatet nga studimet që i analizonin nivelet momentale të vetëdijes së fëmijëve, i klasifikonte parashikimet e fëmijëve nga rreziqet e tregtisë me njerëz apo punës në vend të huaj, si dhe bënte analizë të reagimit të tyre ndaj nismave aktuale kundër tregtisë jolegale.

Projektet e nismës rajonale të Evropës Juglindore kundër tregtisë me njerëz

Në vitin 2001/2002 UNICEF, UNOHCHR dhe OSBE/ODIHR e mbështetën përgatitjen e raportit të përbashkët në kuadër të SPTF-së - Tregtia me njerëz në EJT - i cili e paraqiti situatën dhe reagimet ndaj tregtisë me njerëz në Shqipëri, BH, Bullgari, Kroaci, SMZ, IRJM, krahinën e Kosovës nën administrimin e KB-së, Moldavi dhe Rumani.⁵⁰

Raporti identifikon pengesat e mbrojtjes adekuatë dhe ndihmës për viktimat dhe përmban rekomandime për përmirësimin e reaguesve momentale nga qeveritë e shteteve, OJQ-ve dhe organizatave ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, pastaj masa të veçanta për mbrojtjen e fëmijëve dhe mekanizma nacionalë për riorientim. UNICEF-i, UNOHCHR-ja dhe OSBE/ODIHR-ja, përmes monitorimit të implementimit të Planeve Nacionale për Aksion për luftë kundër tregtisë me njerëz në rajon dhe përmes zhvillimit të drejtave për politik rajonale, të cilat fokusohen në rekomandimet e raportit të mëparshëm, e vazhduan bashkëpunimin e tyre edhe në vitin 2003.

Qëllimi kryesor i projekteve të SEE RIGHTS është promovimi i ndryshimeve në politikën e luftës kundër tregtisë me njerëz në EJT kundruar nga perspektiva e sigurisë publike përmes perspektivës së të drejtave të njeriut/të drejtat e fëmijëve. Qëllimet e projektit janë

- Të ofrojë mbështetje në zhvillimin dhe harmonizimin e mekanizmave nacional për riorientim në bazë të principeve dhe drejtave të UNOHCHR-së për të drejtat e njeriut;
- Të bëjë përpjekje për programe gjithpërfshirëse që janë të bazuara në të drejtat e njeriut, për qasje në tregtinë me njerëz duke u fokusuar në mbrojtjen e viktimave (përfshirë edhe fëmijët) si strategji gjithpërfshirëse për luftë kundër tregtisë jolegale, si dhe të sigurojë ndjekje për tregtarët;
- Të sigurojë mbështetje ndaj zhvillimit të mekanizmave specialë për mbrojtjen e fëmijëve – viktima të tregtisë me njerëz; dhe
- Të zhvillojë strategji për ndërlidhjen e aktiviteteve për preventivë me mekanizmat për riorientim.

Si pjesë e projektit u formua edhe baza e internetit për të dhënat e tregtisë me njerëz në EJT. Kjo bazë e të dhënave ka inventar të regullt dhe të përditshëm të projekteve kundër tregtisë dhe aktiviteteve jolegale, si dhe emra të rëndësishëm të qeverive të shteteve relevante, organizatave ndërkombëtare dhe OJQ-ve në vendet e EJT-së.⁵¹

2.6. Fondi për Popullsinë e KB-së (UNFPA)

UNFPA-ja shërbehet me mandat të përgjithshëm i cili del nga Programi aksional i Konferencës ndërkombëtare për popullsi dhe zhvillim të mbajtur në Kairo në vitin 1994 për mbrojtjen e shëndetit riprodhues dhe promovimin e të drejtave riprodhuese të të gjitha grave dhe burrave. UNFPA punon në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave njerëzore të grave, me kujdes të veçantë në shfrytëzimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe vajzave. Dhuna gjinore është çënim i të drejtave të njeriut, e cila fuqishëm është e lidhur me shëndetin riprodhues, sepse shpesh manifestohet me luftën për kontroll në zgjedhjet riprodhuese të grave. Në rajonin e EJT-së, UNFPA-ja në bashkëpunim me agjencitë e KB dhe OJQ-të, zhvilloi një numër të caktuar të nismave për t'u ballafaquar me nevojat e shëndetit riprodhues të viktimave të tregtisë me njerëz. Për shembull, në BH, UNFPA-ja ofroi mbështetje për

⁴⁹ UNICEF lidhur me Shkollën për çështje juridike ndërkombëtare të Universitetit Kolumbia (maj 2003), Nuk është për shitje: Pengimi i tregtisë me fëmijë në Evropën Juglindore, hulumtimet pilot në Shqipëri, Moldavi, Rumani.

⁵⁰ Barbara Limanovska, Tregtia me njerëz në Evropën Juglindore. Gjendja momentale dhe reagimet ndaj tregtisë me njerëz në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, krahinën e Kosovës që është nën administrimin e KB-së, IRJ të Maqedonisë, Moldavi, Rumani dhe Serbi e Mali të Zi. UNICEF, UNOHCHR dhe OSBE/ODIHR, Beograd 2002. Raporti mund të gjendet në: www.seerights.org

⁵¹ www.seerights.org

intervenimet që kanë drejtuar kah sigurimi i shërbimeve për shëndetësi riprodhuese për vajzat dhe gratë me të cilat është tregtuar, të cilat qëndrojnë në strehimoret e IOM-it si pjesë e programit më të madh rajonal të IOM-it kundër tregtisë me njerëz. UNFPA-ja gjithashtu ofroi mbështetje edhe në nismat në Kosovë, ku madje është organizata e vetme e cila ofron mbështetje për stërvitjen e mjekëve me përvojë private që ata punëtorëve seksual t'u ofrojnë shërbime elementare për shëndet riproduktiv.

UNFPA-ja, në bazë të leksioneve të mësuar nga përvoja e mëparshme dhe si përgjigje çështjeve të reja në fushën e popullacionit dhe shëndetit riproduktiv, në këtë moment zhvillon strategji rajonale për Evropën dhe Azinë Qendrore. Ballfaqimi me pasojat e tregtisë me njerëz do të jetë elementi kryesor i strategjisë rajonale, veçanërisht në kontekstin e të drejtave të njeriut, krijimin e mundësisë për shërbime shëndetësore riprodhuese dhe preventivës ndaj sëmundjes HIV/SIDA.

2.7. Komisari i Lartë i për Refugjatë i KB-së (UNHCR)

UNHCR-ja ka mandat për udhëheqje dhe koordinim të aksioneve ndërkombëtare për mbrojtjen të refugjatëve dhe për t'u ballfaqur me çështjet e refugjatëve në gjithë botën. Qëllimi kryesor i saj është mbrojtja e të drejtave dhe të mirave të refugjatëve. Ajo përpaket të sigurojë të drejtën e azilit dhe ikjes së sigurt në ndonjë shtet tjetër për të gjithë, me mundësi për kthim vullnetar në shtëpi, për integrim lokal ose vendosje në një vend të tretë. Edhe pse nuk është i domosdoshëm ndonjë përcjellës në fushën e aktiviteteve kundër tregtisë me njerëz, UNHCR-ja me gjithatë kujdeset për ndikimin negativ të tregtisë me njerëz ndaj njerëzve, andaj në punën e UNHCR-së janë të kyçur një numër i caktuar i aktiviteteve të ndërlidhura kundër tregtisë jolegale.

Në vitin 2000 UNHCR-ja lansoi bisedime globale për mbrojtjen ndërkombëtare, rezultati i të cilave është Agjenda për mbrojtje. Ajo përbëhet nga gjashtë qëllime dhe veprime përcjellëse, nga të cilat, në veçanti qëllimi i dytë, mbrojtja e refugjatëve në kuadër të emigrimit tejkufitar, ka të bëjë me çështjen e tregtisë me njerëz. Me këtë UNHCR-ja, ia jep Agjendës detyrën që t'i forcojë përpjekjet ndërkombëtare për luftë kundër tregtisë jolegale dhe kontrabandës që të hulumtojë dhe të thirrë takime ekspertësh, që janë të fokusuar në nevojën për mbrojtjen e fëmijëve me të cilët është tregtuar, si dhe bashkëpunimin më të ngushtë me IOM-in dhe me organizata të tjera të ngjashme me UNOHCHR-në, ILO-n dhe OJQ-t në zhvillimin e fushatave informative.⁵²

UNHCR-ja brengoset për dëshmitë e dokumentuara për rritjen e kontrabandës dhe për faktin se azilkërkuesit dhe refugjatët nga popullata më e gjërë e emigrantëve shpeshherë kalojnë në shërbimin e tregtisë jolegale dhe kontrabandës. Kjo mund të ketë pasoja të rënda, përfshirë edhe lëndime fizike deri edhe vdekje. Përveç kësaj, UNHCR-ja është e brengosur se masat e luftës kundër tregtisë me njerëz mund të kenë ndikim negativ te azilkërkuesit dhe refugjatët dhe për sigurinë e tyre. UNHCR-ja plotësisht e pranon faktin se tregtia me njerëz mund të sjellë edhe skllavëri të kushtëzuar dhe skllavëri të tillë, siç është treguar qartë në Protokollin e Palermos që ka të bëjë me tregtinë jolegale. Të vetëdijshëm për implikimet konkrete për azilantët dhe refugjatët, UNHCR bashkëpunon me qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare dhe për nismat rajonale dhe nacionale ofron ndihmë për qeveritë gjatë përforcimit të ligdhënies relevante. UNHCR-ja është e përfshirë në sigurimin e aktiviteteve që janë të ndërlidhura me stërvitjen e gjyqësisë dhe sigurisë publike, duke e përfshirë këtu edhe autoritetet kufitare. Gjithashtu UNHCR-ja në mënyrë efektive merr pjesë në organizatën ndërkombëtare në Gjenevë – grupi kontaktues për tregtinë me njerëz dhe kontrabandën me emigrantë.

Programi për fëmijët e ndarë në Europë (SCE) është nismë e përbashkët e lidhjes së organizatave "Shpëtoni fëmijët" dhe UNHCR-së. Programi ka për qëllim realizimin e të drejtave dhe interesave më të mira të fëmijëve të ndarë (fëmijë nën moshën 18 vjeçare) të cilët kanë hyrë ose kanë udhëtuar nëpër Evropë. Njëra ndër të arriturat e SCE-së ishte edhe deklarata e praktikës së mirë, e cila jep një sasi principesh gjithpërfshirëse të strukturuar mirë dhe (duke i përfshirë këtu edhe ato që kanë të bëjnë me tregtinë me njerëz e njerëzve), të cilat ofrojnë standarde të përbashkëta për luftë me të gjithë fëmijët e ndarë në të gjitha vendet.⁵³

2.8. Fondi i Grave për Zhvillim i KB-së (UNIFEM)

UNIFEM-i mundëson ndihmë financiare dhe teknike për programet inovative dhe strategjitë të cilat promovojnë të drejta të njeriut për gratë, për pjesëmarrjen politike dhe sigurinë ekonomike. Në kuadër të sistemit të KB-së, UNIFEM-i promovon barazi të gjithanshme dhe, përmes promovimit të

⁵² Për më tepër, shih: www.unhcr.ch

⁵³ Shih: www.separated-children-Europe-programme.org

bashkëpunimit dhe sigurimit të ekspertizës teknike të mainstreamingut gjinor për rritjen e forcës së grave, i ndërlidh çështjet dhe brengat e grave me agjendat nacionale, rajonale dhe globale. UNIFEM-i vazhdon me strategjitë inovative në dobi të grave në Evropë dhe në vendet e CIS-it, të cilat fokusohen në tri fusha bazë: Qeverisje - promovim të femrave lidere në të gjitha nivelet dhe proceset e paskonflikteve në ndërtimin e paqes; Të drejta ekonomike – mbështetje të të drejtave ekonomike të grave në kontekst të procesit të privatizimit, globalizimit dhe integritit rajonal; Të drejta të njeriut - çrënjësje të të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe promovim të sigurisë njerëzore.

Në fondet e saj globale për eliminimin e dhunës ndaj grave, UNIFEM-i ofron mbështetje për projekte të cilat ballfaqohen me të gjitha format e dhunës ndaj grave, duke përfshirë edhe tregtinë me njerëz. Aktualisht po financohen projekte vijuese në BH, Rumani dhe Turqi. UNIFEM-i aktualisht zhvillon program subrajonal me qëllim të dhënies së pushtetit dhe mbrojtjen e të drejtave të grave në EJT, në veçanti në punën e UNIFEM-it në Kosovë. UNIFEM-i bisedonte me UNOHCHR-në për mundësitë e përforsimit të bashkëpunimit në këshilla dhe mbrojtje të të drejtave të grave, përfshirë këtu edhe çështjen e tregtisë me njerëz.

2.9. Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP)

UNDP-ja është rrjet global për zhvillim i KB-së i cili përqipet të bëjë ndryshime dhe ndërlidhje të vendeve me njohje, përvojë dhe burime për ndihmë ndaj njerëzve gjatë krijimit të një jete më të mirë. Në terren, UNDP-ja në 166 vende shërbehet me rrjetin e saj global që t'i ndihmojë sistemit të KB-së dhe partnerëve të saj në ngritjen e vetëdijes dhe avancimit, në të njëjtën kohë duke krijuar lidhje edhe me vendet tjera me njohje dhe burime të nevojshme për aritjen e këtyre qëllimeve. Nën vështirimin e bashkëpunimit më të mirë rajonal në luftë kundër tregtisë me njerëz, UNDP-ja në Rumani filloi me implementimin e projektit për krijimin e një doracaku disagjuhësh për sigurinë publike në rajonin e EJT, me qëllim të krijimit të doracakut për hulumtuesit rajonalë, i cili do të ndikojë në zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive hulumtuese të atyre që kanë obligime të përditshme në luftën kundër kriminalitetit në tregtinë me njerëz dhe për përmirësimin e bashkëpunimit të hulumtuesve të specializuar në rajon. Doracak, i krijuar sipas dispozitave të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut që fokusohet në sigurinë dhe jetë më të mirë për viktimat, i ka tre pjesë elementare: kompendiumin rajonal të ligjeve dhe procedurave, dispozitat e përbashkëta për ndihmë juridike dhe nevoja operative procedurale; ekzemplarë nga shembujt më të mirë të cilët japin orientime konkrete për trajtimin e viktimave, mbledhjen e informatave, bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar, veprimet e përbashkëta proaktive dhe teknikat speciale hulumtuese proaktive; dhe njësi hulumtuese speciale të drejtorisë rajonale për kontakt, prokurorë dhe OJQ.

Ekziston një simbiozë e qartë midis projektit të UNDP-së dhe ICMPD-së që është dhënë më poshtë, sepse ato janë të disenjuar që t'i avancojnë reagimet e sigurisë publike të tregtisë me njerëz. Si mbështetje e asaj që u tha më lart, në kuadër të SPTF-së janë paraparë masa të koordinuara dhe të përbashkëta për përcjellje nga ICMPD-ja dhe UNDP-ja.

2.10. Qendra Ndërajonale për hulumtimin e Kriminalitetit në Kombet e Bashkuara (UNICRI)

UNICRI punon në përforsimin e aktiviteteve në KB për preventivë dhe kontroll të delikucencës së të miturve dhe kriminaliteti të të miturve. Ky institut zhvillon program rajonal, i cili ka për qëllim zvogëlimin e dimensioneve dhe pasojave të kriminalitetit të organizuar ndaj tregtisë me fëmijë dhe gra të reja, si dhe fokusimin në fluksin e tregtisë me njerëz nga Ukraina, Moldavia dhe Rumania, kryesisht përmes Hungarisë në Austri, Gjermani dhe Zvicër. Propozimi përfshin tri faza (analizë qëllimore detajisht të orientuar, stërvitje për ndikimin e kriminalitetit të organizuar dhe kornizën ligjdhënëse, si dhe përpjekjen për bashkëpunim ndërinstitucional tej kufitar) për mbështetjen e reagimeve efikase dhe përforsimin e koalicioneve kundër tregtisë me njerëz të aktorëve kryesorë gjatë gjithë rrugës së tregtisë me njerëz, me qëllim të zvogëlimin më efikas të pasojave serioze dhe dimensionit të komponentës së kriminalitetit të organizuar në tregtinë me njerëz. Projekti duhet të fillojë në fund të vitit 2003

2.11. Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Kriminalitetin (UNODC)

UNODC-ja është është udhëheqëse e përgjithshme në luftën kundër kriminalitetit ndërkombëtar të palejuar dhe drogës. Në vitin 1999 UNODC-ja e lansoi programin e përgjithshëm kundër tregtisë me njerëz (GPAT), i cili vendeve anëtare u ndihmoi në përpjekjet e tyre në luftë kundër tregtisë me njerëz. Qëllimi kryesor është zbardhja e pjesëmarrjes së grupeve kriminele të organizuara në tregtinë me njerëz

dhe promovimi i zhvillimit të reagimeve efikase të ligjeve për kriminalitet. Protokollin për pengimin, zvogëlimin dhe dënimin e tregtisë me njerëz, në veçanti me gra dhe fëmijë, i Konventës kundër kriminalitetit të organizuar transnacional të KB, shërben si kornizë dhe orientim për programin në fjalë. UNODC/GPAT-i aktualisht punon me projekt në Moldavi, ku është i kyçur në përmirësimin e reagimeve juridiko-penale të tregtisë me njerëz, në veçanti sepse ky vend është i lidhur me pjesëmarrjen e grupeve kriminale të organizuara përmes përforsimit të praktikës dhe politikës nacionale. Si pjesë e GPAT-së, UNODC-ja i mbështeti aktivitetet rajonale për stërvitjen e zbatuesve të së drejtës penale, përfshirë këtu edhe stërvitjen për gjykatësit dhe prokurorët moldavë.

2.12 Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO)

ILO është agjenci e specializuar e KB e cila punon në promovimin e të drejtës sociale, të drejtave të njeriut dhe të drejtave të punës që janë të pranuar ndërkombëtarisht. Në kuadër të punës e cila ka të bëjë me standardet, ILO ndeshet me çështjen e tregtisë me njerëz në raport me punën e detyrueshme (duke ndikuar kryesisht ndaj keqpërdorimit të punëtorëve emigrantë, siç janë gratë apo popujt autokton) dhe njëtrën ndër format më të këqija të mundimit të fëmijëve. ILO ballafaqohet me tregtinë me njerëz përmes konventave për punën e detyrueshme (Nr. 29 dhe 105)⁵⁴ dhe me konventat për format më të këqija të mundimit të fëmijëve (Nr. 182).⁵⁵ ILO deklaron se në kontekstin evropian, tregtia me njerëz, në veçanti me grave dhe fëmijë, ekzistoj jo vetëm në industrinë e seksit, por edhe në sektorët tjerë, siç është fuqia e punëtorëve të pakualifikuar dhe lypësve.

ILO në këtë moment zhvillon program subrajonal për luftë kundër tregtisë me fëmijëve dhe të rinj për punë dhe eksploatim seksual në Ballkan dhe në Ukrainë. Faza e parë e këtij programi duhet t'i identifikojë strategjitë për aksion kundër tregtisë jolegale përmes analizës së situatës dhe vlerësimit të reagimeve aktuale në rajon. Kjo përfshin zhvillim të mëtejshëm të metodologjisë për vlerësim të shpejtë të ILO-s për format më të këqija të mundimit të fëmijëve, stërvitje të partnerëve nacional, kontrolle operative, punëtori dhe analiza. Në bazë të mësimave të fazës së parë, programi gjithpërfshirës për aksion do të theksojë dhe do të fokusohet në preventivën dhe riintegrimin, ndërsa do të fillojë në vjeshtën e vitit 2003.

ILO është pjesëmarrëse në SPTF dhe është anëtare e Grupit për Koordinim.

Qendra Ndërkombëtare për Zhvillim të Politikës së Emigrimit (ICMPD)

ICMPD-ja është organizatë ndërkombëtare e formuar në vitin 1993 me nismë të Zvicrës dhe Austrisë. Selia e saj është në Vjenë. Qëllimi i organizatës është promovimi i politikave gjithpërfshirëse dhe të qëndrueshme për emigrim, si dhe funksionimi i mekanizmave për këmbim të shërbimeve për qeveritë dhe organizatat, kryesisht për çështje që kanë të bëjnë me emigrimin evropian. Në kuadër të SPTF-së, ICMPD-ja është agjenci kryesore për stërvitje dhe këmbim, e cila zhvillon program rajonal gjithpërfshirës për stërvitjen dhe ndërtimin e kapaciteteve për tregtinë me njerëz që kanë lidhje me qeveritë e EJT-së dhe me aktorët relevantë (përfshirë edhe përfaqësues të qeverive, sigurimit publik, gjykatave dhe OJQ-ve). Qëllimi i këtij programi, i cili implementohet në bashkëpunim me qendrën SECI dhe IOM-in, është arritja e procesit të strukturuar dhe të qëndrueshëm, stërvitja dhe këmbimi mes vendeve të EJT-së, zhvillim të praktikës më të mirë në rajon dhe përpunim të bashkëpunimit rajonal ndërmjet të gjithë aktorëve dhe të gjitha vendeve që janë të inkuadruar në këtë proces. Takimi i parë i ekspertëve të lartë, i cili do t'i tubojë koordinorët qeveritarë dhe të angazhuarit në sigurimin publik, përfaqësuesit e gjykatave dhe të OJQ-ve të 13-vendeve pjesëmarrëse në EJT, u mbajt në Bukuresht në shtator të vitit 2002. Pjesëmarrësit u morën vesh për përparësitë nacionale dhe rajonale në fushën e ndërtimit të kapaciteteve, stërvitjes dhe i identifikuan hapat që vijnë në drejtim të implementimit të NAP-it të tyre kundër tregtisë me njerëz.

Në kuadër të kësaj, nënprogrami Zhvillimi i modelit për stërvitje të policisë kundër tregtisë me njerëz të implementuar në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme të Austrisë, ky program u lansua në nëntor të vitit 2002. Në të njëjtin nivel është edhe programi me kontribute ekspertësh nga CoE-ja dhe Zyra e KB-së për drogë dhe kriminalitet (UNODC) për zhvillim të modeleve të stërvitjes për prokurorët dhe gjykatësit për t'u ballafaquar me tregtinë me njerëz. Gjithashtu, në prill të vitit 2003 u hap edhe veb-faqja speciale me qasje të kufizuar qëllimi i të cilës është forcimi i kapaciteteve përmes stërvitjes dhe bashkëpunimit për luftë kundër tregtisë me njerëz.⁵⁶ Shërbimi i veb-faqes shërben si qendër e burimeve informative të aktiviteteve për stërvitje dhe bashkëpunim ndërmjet pjesëmarrësve të programit gjithpërfshirës për stërvitje dhe forcim të kapaciteteve, por edhe për aktorët tjerë në terren.

⁵⁴ Teksti i Konventës mund të gjendet në: www.ilo.org/public/english/standards/norm/whatare/fundam/

⁵⁵ Teksti i Konventës mund të gjendet në: www.ilo.org/public/english/standards/ipecc/ratificatio/convention/text.htm

⁵⁶ www.anti-trafiking.net

ICMPD-ja po bën vëzhgim dhe korrëgjim të të gjitha nën-modeleve për forcim të kapaciteteve, për stërvitje dhe bashkëpunim në vendet/territoret pjesëmarrëse, përfshirë këtu edhe mbështetjen për implementim në nivel nacional, aty ku ajo është e nevojshme.

2.13. EUROPOL-i

EUROPOL-i është organizatë e Enionit European për siguri publike e cila merret me kundërzbulime penale. Qëllimi i saj është përmirësimi i suksesit në mesin e autoriteteve gjegjëse të vendeve anëtare për pengimin dhe luftën kundër kriminalitetit serioz të organizuar ndërkombëtar. Misioni i EUROPOL-it është të japë kontributin e tij të duhur ndaj aktiviteteve në fushën e sigurimit publik në UE për luftë kundër kriminalitetit të organizuar, me theks të veçantë ndaj organizatave kriminele.

EUROPOL-i mbështet vendet anëtare të UE-së përmes:

- Krijimit të mundësisë për këmbim të të dhënave (personale dhe jopersonale) në pajtim me ligjet nacionale, përmes oficerëve për lidhje të udhëhequr në EUROPOL-i nga 15 vende anëtare, 5-vende candidate (Estonia, Polonia, Republika Çeke, Hungaria dhe Sllovenia) dhe Norvegjia si përfaqësuese e agjencive të ndryshme nacionale për siguri publike;
- Sigurimit të analizave operative si mbështetje ndaj operacioneve dhe raporteve strategjike dhe analizave të kriminalitetit në vendet anëtare, në bazë të të dhënave të përgjithshme dhe të dhënave të kundërzbulimit të dorëzuara nga vendet anëtare, në pajtim me EUROPOL-in apo janë tubuar nga burime tjera.
- Sigurimit të ekspertizave dhe mbështetjeve teknike për hetimet dhe operacionet vijuese të kryera nga agjencitë për siguri publike të vendeve anëtare, nën mbikqyrje dhe përgjegjësi ligjore të vendeve anëtare.

Definicioni i EUROPOL-it për tregtinë me njerëz:

Tregtia me njerëz (THB) do të thotë nënshtrim të ndonjë personi për të sunduar me të ilegalisht përmes përdorimit të dhunës apo përmes keqpërdorimit të autoritetit ose intrigave, veçanërisht në aspektin e shfrytëzimit për prostitucion, përmes formave të shfrytëzimit seksual apo përmes sulmit ndaj të miturve ose tregtinë me fëmijë të lënë.

Këto forma të shfrytëzimit gjithashtu përfshijnë edhe prodhimin, shitjen ose distribuimin e materialit pornografik për fëmijë.⁵⁷

⁵⁷ E-mail i marrë nga EUROPOL më 22 maj 2003

3. Organizatat joqeveritare

3.1. Fondacioni La Strada

OJQ-ja më aktive në fushën e pengimit të tregtisë me njerëz, ndihmës ndaj viktimave dhe riintegrimin është fondacioni La Strada.⁵⁸ La Strada punon si rrjet i organizatave të pavarura në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore (Polonia, Republika Çeke, Ukraina, Bullgaria, Bellarus, BH-ja, IRJM-ja dhe Moldavia). La Strada bashkëpunon me institucionet qeveritare dhe me organizatat ndërkombëtare, si dhe e shfrytëzon rrjetin e OJQ-ve vendore për të përforcuar punën e saj.

Programi La Strada përqipet ta bëjë të qartë tregtinë me gra dhe të ndikojë në autoritetet dhe që mendimin publik të orientohet në këtë temë nga perspektiva e të drejtave të njeriut. Programi, gjithashtu përqipet që t'i orientojë viktimat kah rrjetet mbështetëse dhe t'i edukojë gratë dhe vajzat për rreziqet potenciale nga tregtia me njerëz. Nevojat dhe të drejtat e grave përbëjnë pikën fillestare të të gjitha aktiviteteve.

Programi La Strada funksionon nën strukturën e vazhdueshme të fushatës tripjesëshe me qëllim që më me efikasitet t'i mbulojë të gjitha aspektet e tregtisë me njerëz. Fushata për shtyp dhe lobim punon në ngritjen e vetëdijes publike dhe çështjen e tregtisë me njerëz e parashtron para autoriteteve nacionale si shkelje serioze të të drejtave të njeriut. Fushata për preventivë dhe edukim punon me viktimat potenciale të tregtisë me njerëz me qëllim të edukimit për rreziqet nga tregtia me njerëz. Përveç kësaj, linja e drejtpërdrejtë telefonike ofron këshilla dhe të dhëna të sakta për gratë të cilat mendojnë të emigrojnë në Evropën Perëndimore. Fushata për ndihmë sociale i ndihmon personat me të cilët është tregtuar. Përmes pamfleteve dhe linjës së drejtpërdrejtë ata ofrojnë ndihmë të drejtpërdrejtë dhe këshilla, por mund edhe t'i udhëzojnë gratë viktimat në rrjetin profesional ku mund të marrin ndihmë juridike, emotive, mjekësore dhe ndihmë praktike. La Strada mund të ofrojë ndihmë edhe për gratë të cilat dëshirojnë t'i paditin personat që kanë tregtuar me to.

3.2. Komiteti Ndërkombëtar Katolik për Emigrim (ICMC)

ICMC-ja ofron ndihmë të shpejtë dhe promovon zgjidhje të qëndrueshme për refugjatët, personat e shpërngulur brenda vendit, të kthyerit dhe emigrantët, duke u fokusuar te më të lëndueshmit në kuadër të kësaj popullate. ICMC-ja është e interesuar për mbrojtjen e të drejtave dhe dinjitetin e personave me të cilët është tregtuar dhe atë në forumet ndërkombëtare, rajonale dhe nacionale, siç është Kuvendi i përgjithshëm IOM-it, Komisioni për të drejtat e njeriut i KB-së dhe ILO-s. Në Ballkan ICMC-ja jep mbështetje në zhvillimin e kapaciteteve lokale për të ofruar ndihmë, mbrojtje dhe zgjidhje të qëndrueshme për personat me të cilët është tregtuar.

Nga viti 1999 deri në vitin 2002, ICMC-ja bashkëpunonte me IOM-in në ofrimin e mbrojtjes dhe ndihmës për femrat viktimat të tregtisë me njerëz në Shqipëri. Qendra për studime të refugjatëve dhe emigrantëve e ICMC-së në Shqipëri, kishte rol të rëndësishëm në krijimin e Rrjetit ATAC (Të Gjithë së Bashku Kundër Tregtisë me Fëmijë), Koalicioni i organizatave ndërkombëtare dhe OJQ-ve, të cilët punojnë në pengimin e tregtisë me njerëz me fëmijë në Shqipëri, përmes dhënies së ekspertizave juridike dhe këshillave të përgjithshme. Njëra ndër brengat e vazhdueshme të Qendrës është çështja e tregtisë gra dhe fëmijë nga komunitetet shqiptare, rome dhe egjiptase - komunitetet më të rezikuara sociale dhe ekonomike në Shqipëri (dhe në gjithë rajonin).

ICMC-ja luan rol të rëndësishëm në aktivitetet kundër tregtisë me njerëz në Kroaci. ICMC-ja dhe Dhoma e grave, në bashkëpunim me me La Strada-n koordinuan dhe organizuan në Republikën Çeke një seri stërvitjesh për rrjetin për luftën kundër tregtisë me njerëz, PETRA, pastaj bënë disenj, implementim dhe vëzhgim të fushatave vendore për njohje, preventivë dhe informacion, linjën SOS dhe udhëzime për punën me media.

ICMC-ja merr pjesë në ekipin koordinues të ekspertëve të SPTF-së. ICMC është koordinatore e ekipit për programet e mbrojtjes së viktimave. Në emër të SPTF-së, ICMC-ja dhe IOM-i bashkëpunuan në formimin e Qendrës rajonale për rrjetet nacionale për mbrojtjen dhe ndihmën viktimave, selia e së cilës është në Beograd.

Aktualisht, ICMC implementon programe kundër tregtisë me njerëz në Indonezi, Liban dhe në Ejl.⁵⁹

⁵⁸ Shiko: www.soros.org/women/html/info_trafficking.html

⁵⁹ Për të dhëna të mëtejme, shih veb-faqen e ICMC: www.icmc.net

3.3. Preventiva transnacionale e Sidës/sëmundjet gjinore të prostituteve-emigrante në Europë (TAMPEP)

TAMPEP-i është projekt për rritjen e forcës dhe vetëbesimit në mesin e prostituteve emigrante. Ai bën edukimin e institucioneve mjekësore dhe sociale për përgjigje më të mirë ndaj nevojave të emigrantëve - punëtor të seksit. TAMPEP-i është pikë referimi për emigrantet - punëtore të seksit, sepse i ruan variacionet dhe emigrimin në vendet në të cilat funksionon projekti. Ai, përmes punës së rregullt në teren në vende të ndryshme të prostitucionit, i hulumton kushtet sociale, ligjore dhe ato të punës për emigrantët punëtorë të seksit.

TAMPEP-i në vitin 1993 filloi të punojë në 4 shtete të Europës: Holandë, Itali, Gjermani dhe Austri. Ky është model i intervenimit, i cili punon me më shumë se 20 nacionalitete të ndryshme të grave dhe transseksualëve nga Evropa Qendrore dhe ajo Lindore, Azia Juglindore, Afrika dhe Amerika Latine.

Në vitin 2000, TAMPEP-i filloi ta zgjerojë rrejtin e tij me përfshirjen edhe të vendeve nga Evropa Lindore, si dhe të vendeve anëtare të UE-së. Në vitin 2001 filloi me ndërtimin e rrejtit të organizatave në Evropën Lindore, duke përfshirë Rumaninë dhe Bullgarinë, qëllimi i të cilit është sigurimi i duhur momental i edukimit për HIV/sëmundjet ngjitëse seksuale, burimi dhe materiali për emigrantët - punëtore të seksit/femra me të cilat është tregtuar. Ato krijuan material për informim në dhjetë gjuhë të ndryshme.⁶⁰

3.4. Lidhja Save the Children

Në vitin 2001, Save the Children tregtinë me fëmijë e identifikoi si njërin ndër përparësitë në EJT-së dhe në mars të vitit 2001 e publikoi raportin Tregtia me fëmijë në Shqipëri.

Në maj të vitit 2002, Save the Children e lansoi një program rajonal 18-mujor si përgjigje ndaj tregtisë me fëmijë, në të cilin i implementoi 6-intervenime pilot kundër tregtisë me fëmijë, duke u fokusuar te fëmijët me rrezik të lartë apo me të cilët është tregtuar, gjithë kjo e realizuar përmes zyrave nacionale të Save the Children dhe partnerëve lokalë për implementimin e Programit në Shqipëri, Kroaci, në Kosovë, Mal të Zi, Serbi dhe Rumani. Diapazoni i projekteve pilot është ngritja e vetëdijes së grupeve më të rrezikuara deri te sigurimi i këshillave të drejtpërdrejta dhe ndihma për riintegrimin e viktimave të tregtisë me njerëz.

Në tetor të vitit 2002, Save the Children lansoi një projekt njëvjeçar për tregtinë me fëmijëve në Evropën Qendrore dhe atë Juglindore dhe në vendet Baltike që ishte i koordinuar nga Save the Children në Rumani. Ata përgatitën raport hulumtues për tregtinë me njerëz në bashkëpunimin me partnerë nga Shqipëria, BH-ja, Bullgaria, Kroacia, Estonia, Lituania, IRJM-ja, Moldavia, Rumania, Serbia dhe Sllovenia. Së bashku me UNICEF-in, Save the Children realizoi edhe projekt hulumtues për tregtinë me fëmijë dhe për format më të vështira të punës së fëmijëve në Bosnje e Hercegovinë. Rezultatet nga të dy projektet hulumtuese priten kah fundi i vitit 2003.

Save the Children - Rumani realizon edhe një vlerësim të shpejtë për tregtinë me fëmijë në Rumani. Këtë e bën në bashkëpunim me ILO/IPEC dhe institutin për hulumtimin e cilësisë të jetesës dhe kështu përgatit raport nacional për tregtinë me fëmijë për shfrytëzim komercial seksual. Në këtë projekt është e kyçur edhe OJQ-ja ndërkombëtare Fund për pornografinë dhe tregtinë e fëmijëve.

Në prill të vitit 2003, Save the Children lansoi edhe projektin Rrjeti evropian kundër tregtisë me fëmijë (projekt i koordinuar nga Save the Children-Itali, përfshirë edhe Greqinë, Rumaninë, Bullgarinë, Spanjën, Danimarkën dhe Britaninë e Madhe), i cili do të mundësojë këmbim të të dhënave, hulumtim, dokumentim dhe mbështetje teknike për luftën kundër tregtisë me fëmijë. Në kuadër të SPTF-së, Save the Children fokusohet në hulumtimin dhe ngritjen e vetëdijes për tregtinë me fëmijë, ndërsa me ICMC-në dhe organizatat e tjera e mbështetin rritjen e pjesëmarrjes së OJQ-ve në aktivitetet e SPTF-së.

3.5. Këshilli Ndërkombëtar për Hulumtim dhe Këmbim (IREX)

Në shtator të vitit 2001, IREX-i - OJQ me seli në SHBA, filloi me një nismë rajonale për rritjen e forcës së grave, e cila ishte e financuar nga Departamenti Amerikan i Punës. Programi promovon rritjen e forcës së grave nga vende të caktuara të ish Bashkimit Sovjetik dhe EJT-së, veçanërisht nga Federata Ruse, Bullgaria, Rumania, Moldavia, Lituania, dhe SMZ-ja, me qëllim të pengimit të tregtisë me njerëz para se gratë t'i braktisin vendet e tyre. IREX-i bashkëpunon me organizatat vendore në këto

⁶⁰ Për më shumë të dhëna, shih veb-faqen: www.tampep.com/

vende me qëllim të implementimit të programit gjithpërfshirës kundër tregtisë jolegale dhe atë me katër fusha kryesore të veprimit: 1. Sigurimi i stërvitjes për shkathtësi elementare për punë dhe ndihmë gjatë rangimit; 2. Ngritja e forcës së grave në rrezik përmes stërvitjes dhe ndihmës psikologjike e juridike; 3. Ngritja e vetëdijes për skemat potenciale të tregtisë me njerëz përmes fushatave të drejtuara kah grup qëllimorë; 4. Stërvitje të ndërmarrjeve të vogla dhe granteve për mbështetje të femrave drejtoresha për të krijuar ndërmarrjeve të qëndrueshme.

3.6. Organizatat joqeveritare vendore

Organizatat e grave në nivel lokal kryesisht merren me tregtinë me njerëz. Disa prej tyre kryesisht punojnë në rajonet e dhunës ndaj grave dhe të drejtave të tyre, ndërsa të tjerat udhëheqin me strehimoret për viktimat e dhunës. Organizatat për të drejtat e njeriut dhe organizatat për të drejtat e emigrantëve akoma mendojnë se tregtia jolegale është më tepër çështje e dhunës së përgjithshme se sa keqpërdorim i të drejtave të njeriut, andaj ajo zakonisht u lihet grupeve të grave.

Krijimi i rrjetit të OJQ-ve në nivel rajonal është i vogël. Kjo veçanërisht bie në sy në mesin e vendeve amë dhe të vendeve të caktuar. Deri tani të gjitha nismat që janë bërë për krijimin e rrjetit janë bërë nga grupet vendore të cilat dëshirojnë të lidhin kontakte me organizatat simotra apo organizatat partnere në vende tjera, të kenë pak mbështetje nga qeveritë e tyre dhe përfshirje të disa organizatave ndërkombëtare, siç është OSBE/ODIHR. Bashkëpunimi më i ngushtë dhe këmbimi i ideve mundësohet vetëm për OJQ-të e lidhura me La Strada-n ose TAMPEP-in. Megjithatë, edhe këto rrjete organizohen më shumë për shkaqe praktike, që të mundësojnë mbështetje të drejtpërdrejtë për personat e tregtuar dhe të organizojnë aktivitete për preventivë dhe ngritje të vetëdijes, sesa që të krijojnë koalicionin të OJQ-ve me program dhe qasje gjithpërfshirëse rajonale.

Konferenca e parë rajonale e OJQ-ve vendore nga EJL, falë ndihmës së OSBE-së u mbajt në nëntor të vitit 2002 në Beograd. Në Konferencë morën pjesë më shumë se 30 OJQ vendore, të cilat punojnë në tregtinë me njerëz nga gjithë EJL-ja dhe u dakorduan për krijimin e rrjetit joformal të OJQ-ve vendore, rrjet për luftë kundër tregtisë me njerëz (@net). Edhe UNICEF-i, OSBE-ja dhe ekspertë nga projekti SEE RIGHTS ishin ftuar nga OJQ-të që të marrin pjesë në Konferencë që kështu të sigurohet koordinim me SPTF-në dhe me organizatat ndërkombëtare. OJQ-të i identifikuan tri përparësi për bashkëpunim rajonal: këmbimi i të dhënave, sigurimi i shërbimeve për viktimat e tregtisë me njerëz dhe përfaqësimi dhe lobimi për politikën.

Pjesëmarrja e komuniteteve vendore dhe OJQ-ve vendore në punën kundër tregtisë me njerëz është jashtëzakonisht e rëndësishme për qëndrueshmërinë e aktiviteteve kundër tregtisë me njerëz. Organizatat vendore janë në pozitë më të mirë që të përpiqen për të drejtat e njeriut të viktimave dhe atyre t'u sigurojnë ndihmë të domosdoshme. Ata, gjithashtu, mund të krijojnë programe të reja dhe qasje të reja që ashtu t'u përgjigjen situatave dhe skemave të përpunuara të tregtisë me njerëz. OJQ-të do të jenë partnerët e vetëm validë pasi që komuniteti ndërkombëtar ta lëshojnë rajonin.

4. Studimi rajonal - Operacioni Mirazh - aksion rajonal për sigurinë publike

Në shtator të vitit 2002 qendra SECI organizoi aksion rajonal kundër tregtisë me njerëz dhe kontrabandës, aksion i quajtur Mirazh.⁶¹ Operacioni përfshin sigurinë publike, OJQ-të dhe IOM-in nga vendet anëtare të SECI-t: Shqipëria, BH-ja, Bullgaria, IRJM-ja, Greqia, Hungaria, Moldavia, Rumania dhe Turqia. Ukraina, Serbia dhe Mali i Zi dhe Misioni i KB në Kosovë në këtë operacion morën pjesë si partnerë. Qëllimet kryesore të operacionit Mirazh ishin:

- Identifikimi i viktimave të tregtisë jolegale dhe riatdhesimi i sigurt;
- Identifikimi i personave të mashtruar;
- Identifikimi i grupeve kriminele që janë të inkuadruar në tregtinë me njerëz dhe/apo kkontrabandën me njerëz; dhe
- Fillimi i hetimeve të përbashkëta kundër tyre.

Operacioni filloi me bastisje policore në gjithë rajonin, në vende të caktuara, siç janë baret, motelet, hotelet, disko-klubet, klubet e natës, parkingjet, pikat kufitare dhe në të gjitha vendet për të cilat policia ka informacione se aty kryhet tregtia me njerëz, kontrabandë dhe aktivitete të tjera jolegale. IOM-i, e në

⁶¹ Të gjitha të dhënat dhe numrat janë marrë nga Operacioni Mirazh, përpjekje e SECI-t në luftë kundër kontrabandës ndërkufitare me njerëz dhe emigrimit ilegal. Raporti për evaluim, SECI, Bukuresht, i publikuar në janar të vitit 2003.

disa vende edhe OJQ-të vendore, ishin informuar dhe ishin përgatitur të kujdesen për viktimat të cilat mund të identifikohen gjatë kohës së operacionit.

Rezultatet e operacionit Mirazh i hapën disa çështje të cilat ishin të lidhura me numrin e viktimave të tregtisë me njerëz në rajon dhe me efikasitetin e qasjes së sigurisë publike në formën të cilën e kishte zgjedhur operacioni Mirazh.

Nga dokumentet e dhëna nga SECI, si dhe nga bisedat me funksionarët e SECI-t, duket se ata i kanë vërtetuar dhe ndryshuar vlerësimet për numrin e viktimave të tregtisë me njerëz në rajon. Vlerësimet e IOM-it nga viti 2001, të cituara nga SECI në dokumentet e tyre, tregojnë se brenda një viti në Ballkan tregtohet me rreth 170.000 njerëz⁶². Me ndërmarjen e operacionit në të gjitha vendet në të njëjtën kohë ku duhej të merreshin parasysh vendet më të theksuara për tregtinë me njerëz jolegal, numri i viktimave 63 - të cilëve u ishte ofruar ndihmë, ishte mjaft brengosës. Gjithashtu befason edhe përqindja e grave dhe vajzave, të cilat ishin identifikuar nga të gjitha viktimat e dyshimta që ishin marrë në pyetje. Gjatë vitit 2001, përafërsisht 35% nga të gjitha viktimat, të cilat i regjistroi policia (punëtorë emigrantë të seksit të kapur nëpër bare nga policia dhe të cilët janë viktimat të dyshimta të tregtisë me njerëz), si të tilla ishin identifikuar dhe u ishte ofruar ndihmë në vendet e caktuara, me gjithsej 7% të cilët marrin ndihmë afatgjate për riintegrim.⁶³ Gjatë kohës së Operacionit Mirazh, u identifikuan vetëm 237 viktimat të tilla (14% nga 1738 gra të ftuara në bisedime për së dyti nga ana e policisë, për të cilat dyshohet se janë viktimat të tregtisë me njerëz), kurse ndihmë morën vetëm 63 viktimat (që paraqet 4% nga të ftuarat për së dyti si viktimat të dyshuara të tregtisë me njerëz, nga të cilat të gjitha janë adoleshente, nën moshën 18-vjeçare).

Rezultatet e operacionit Mirazh:

- Është kryer kontroll në 20,558 vende;
- Janë marrë në pyetje 13.000 gra dhe fëmijë;
- 1.738 persona janë futar për së dyti në bisedime (persona të cilët kanë qenë të kontrolluar për dhe në ta është dyshuar se janë viktimat për shkak të identitetit dhe lejeqëndrimit në atë vend);
- 273 gra dhe fëmijë, me të cilët është tregtuar, janë identifikuar (14% nga viktimat e dyshimta);
- 63 viktimave të tregtisë me njerëz u është dhënë ndihmë nga IOM-I dhe OJQ-të (4% nga viktimat e dyshimta);
- 174 prej tyre u janë nënshtruar masave preventive (u është ndaluar të hyjnë ose ta lëshojnë vendin);
- janë identifikuar 293 tregtarë të njerëzve.

⁶² Nga i njëjti burim.

⁶³ Barbara Limanovska, Tregtia me njerëz në Evropën Juglindore. Gjendja momentale dhe reagimet ndaj tregtisë me njerëz në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, krahinë e Kosovës nën administrimin e KB-së, IRJ të Maqedonisë, Moldavi, Rumani dhe Serbi e Mali të Zi. UNICEF, UNOHCHR dhe OBSE/ODIHR, Beograd 2002. Raporti mund të gjendet në: www.seerights.org

Raporti që, pas operacionit u përgatit nga SECI, është mjaft i përgjithësuar dhe nuk u përgjigjet disa pyetjeve:

- Informatat për viktimat dhe kryerësit nuk janë ndarë sipas gjinisë, moshës dhe vendit amë;
- Nuk ka dallime të qarta në mes të të dhënave për kontrabandën dhe tregtinë me njerëz;
- Nuk ka të dhëna për numrin e procedurave penale kundër kryerësve dhe bazave juridike për ato raste; dhe
- Nuk ka të dhëna konkrete për natyrën e masave konkrete administrative të cilat janë ndërmarrë kundër grave dhe për bazat e tyre.

Ekzistojnë disa shpjegime të mundshme për diskriminime të shumta në mes të viktimave të dyshimta dhe viktimave reale të cilave u është ndihmuar në rajon dhe rezultateve të Operacionit Mirazh:

- Numri i viktimave në vitin e fundit u zvogëlua në mënyrë marramendëse;
- Tregtarët e ndryshuan *modus operandi* e tyre, ashtu që bastisjet policore gjatë kohës së operacionit kontrolluan vende të gabuara;
- Operacioni Mirazh nuk u krijua që t'i identifikojë dhe t'u ndihmojë viktimave të tregtisë me njerëz;
- Operacioni Mirazh u krijua që t'i identifikojë dhe t'u ndihmojë viktimave të tregtisë me njerëz, por nuk pati sukses dhe nuk i dha rezultatet e pritura;
- Edhe pse i organizuar si duhet në nivel rajonal, Operacioni Mirazh nuk ishte implementuar si duhet në nivel vendor; dhe
- Qasja tradicionale e sigurisë publike, siç ishte propozuar nga Operacioni Mirazh dhe ishte implementur nga policia vendore, më tej nuk është efikase.

Në njëfarë mase, të gjitha shpjegimet e mësipërme janë të sakta. Siç do të shihet edhe në shembujt e vendeve të rajonit, trendet e tregtisë me njerëz ndryshojnë gjatë rrjedhës së raportit. Ka zvogëlim të numrit (të regjistruar) të grave dhe vajzave të cilave u është dhënë ndihmë pas nisjes nga Ballkani apo nëpër Ballkan. Aksionet e deritanishme të policisë kundër tregtisë me njerëz për identifikimin e viktimave të kësja tregtie u treguan si të pasuksesshme.

Brengosja për rezultatet e Operacionit Mirazh iu prezentua përfaqësuesve të qendrës SECI-t në mledhjen për evaluimin e Operacionit Mirazh, e cila ishte e organizuar nga Qendra në fillim të vitit 2003. Rekomandimet e propozuara në këtë mbledhje nga përfaqësuesit e OSBE/ODIHR-së dhe UNICEF-it bazohen në orientimet dhe principet e rekomanduara për të drejtat e njeriut dhe në tregtinë me njerëz të UNOHCHR-së:

- Fokusimi vetëm në luftën kundër tregtisë me njerëz, duke e dalluar atë nga format e tjera të kriminalitetit;
- Udhëzime të hollësishme për trajtimin e viktimave dhe memorandume për mirëkuptim mes autoriteteve shtetërore dhe ofruesve të shërbimeve në të gjitha vendet anëtare të SECI-t;
- Bashkëpunimi dhe këmbimi me të gjithë partnerët relevantë në mekanizmat nacionalë për riorientim;
- Zhvillimi i udhëzimeve të qarta dhe i kahjeve për identifikimin e viktimave;
- Sigurimi i identifikimit dhe trajtimit të veçantë të fëmijëve, duke u mbështetur në përcaktimet e UNICEF-it për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve - viktimat të tregtisë me njerëz në EJT;
- Sigurimi i trajtimit adekuat i viktimave dhe i viktimave potenciale; dhe
- Filtrimi i të dhënave.

ISH REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË

Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (IJR e Maqedonisë) kufizohet me Shqipërinë, Bullgarinë, Greqinë dhe Serbinë e Malin e Zi (SMZ). Nga dy milionë banorët sa i ka, 65% janë maqedonas etnikë, 23% - shqiptarë etnikë, ndërsa të tjerët janë turq romë dhe serbë.

Në kohën e shpalljes së pavarësisë, në nëntor të vitit 1991, Maqedonia ishte vendi më i pazhvilluar nga republikat jugosllave. Mungesa e infrastrukturës, sanksionet e KB-së ndaj Republikës Federative të Jugosllavisë (RFJ), që ishte njëri ndër tregjet më të mëdha, pastaj embargoja ekonomike greke për shkak të mospajtimit ndaj emrit ligjor dhe flamurit të shtetit, e penguan zhvillimin ekonomik të këtij shteti deri në vitin 1996. BDP—ja rritej vazhdimisht deri në vitin 2000. Më pas, edhe konflikti i brendshëm etnik i vitin 2001 i pengoi reformat ekonomike. Për shkak të pakësimit të tregtisë, u dobësua ekonomia, kufijtë vazhdimisht mbylleshin, u rrit deficiti për shkak të shpenzimeve për nevojat e sigurisë dhe njëheri edhe pasiguria për investime. Zhvillimi mezi u kthye në vitin 2002. Papunësia nga 1/3 e forcës punuese bëhet problem kritik.³⁵⁵ Në zhvillim e sipër janë bisedimet mes IRJ të Maqedonisë, NATO-s dhe UE-së për anëtarësim në këto organizata. Tani IRJ e Maqedonisë është anëtare e Partneritetit për paqe, ndërsa në vitin 2001 e nënshkroi Marrëveshje për Stabilizim dhe Asociim me UE-në. Megjithatë, nuk ka më as plane të mëtutjeshme, e as afate për hapa më konkretë.

Si rezultat i konfliktit etnik të vitit 2001, aktivitetet kundër tregtisë me njerëz, disa muaj u ndërprejnë, ngase pjesa më e madhe e tregtisë me njerëz bëhet në anën perëndimore të vendit, territor kyme me shumë trazira dhe konflikte, ku madje është vështirë edhe të merren të dhëna për tregtinë me njerëz. Përpos Tetovës dhe Gostivarit, policia akoma nuk është plotësisht e pranishme në pjesën perëndimore të IRJ të Maqedonisë.

1. Emigrimi, prostitucioni dhe tregtia me njerëz

Emigrimi jolegal është problem tashmë i pranuar në IRJ të Maqedonisë, i cili shërben si vend tranzitore për emigrantët nga Evropa Lindore, të cilët përpiqen të kalojnë në perëndim, si dhe për emigrantët nga Lindja e Afërt dhe Afrika të e shfrytëzojnë korridorin turko-bullgaro-maqedon që të udhëtojnë për në perëndim. Kufijtë të cilët më së shpeshti kalohen jolegalisht janë ato me Greqinë (40%) dhe Serbinë (47%). Kufiri shqiptar më rrallë kalohet jolegalisht (10%). Shumë më tepër emigrantë janë meshkuj sesa femra. Për shembull, në vitin 2001, 3400 meshkuj rumunë dhe 650 femra u ndaluan në kufirin e IRJ të Maqedonisë, ndërsa 550 meshkuj dhe 50 femra ishin moldave.³⁵⁶ Megjithatë nuk ka të dhëna për numrin e viktimave potenciale në mesin e emigrantëve jolegal.

Prostitucioni në IRJ të Maqedonisë nuk është kriminalizuar, por ai konsiderohet si prishës i qetësisë publike. Edhe ndërmjetësimi në prostitucion është akt penal. Sipas OJQ-ve, aktiviteti kryesor i policisë lidhur me prostitucionin është përpjekja për të kapur femra në flagrancë, që ato të dëshmojnë për tregtinë me njerëz, përfshirë këtu edhe veprat që kanë të bëjnë me pengimin me forcë të femrave dhe fëmijëve, kushtet e vështira ekonomike, implementimi i ligjdhënies kundër diskriminimit, deri në marrjen e masave konkrete në fushën e sigurisë publike. Këndellja në sigurinë publike do të ndikojë pozitivisht në zbulimin e kanaleve të kontrabandës, kontrollimin e veturave dhe të numrave të telefonave të cilët janë të lidhur me kontrabandën, si dhe për marrjen në pyetje të vizitorëve të klubeve të natës, bareve dhe moteleve. Këto aktivitete duhet të implementohen nga ana e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Planet Nacionale për Aksion (PNA) nxitën krijimin e një qendreje tranzitore për ndihmë dhe përkrahje të viktimave të tregtisë me njerëz, me çka do të sigurojnë vendqëndrim, ushqim, përkthyes dhe informata për të drejtat, mbrojtjen shëndetësore dhe sociale, si dhe ndihmë tjetër të nevojshme. Kjo qendër do të jetë nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Punës dhe Politikës Sociale, Shëndetësisë dhe Drejtësisë.

Spektori i PNA-së për kthim dhe riintegrim ka për qëllim (që për viktimat) të sigurojë të drejtë për kthimin dhe riintegrimin e tyre në vendlindjet. Aktivitetet specifike e përfshijnë edhe aspektin financiar të kthimit, nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale për kthim, inkuadrimin e bashkëpunimit midis

³⁵⁵ Shih faqen: www.cia.gov/cia/publications/factbook/geos/mk.html

³⁵⁶ Statistika e vitit 2002. Të dhëna nga zyra e IOM-it në Shkup, 12.10.2002.

qendrave tranzitore (vendstrehimeve) dhe OJQ-ve, si dhe përgatitjen e programit për riatdhësim të viktimave në vendet e treta. Përgjegjësia për këto aktivitete bie mbi Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Bashkëpunimi ndërkombëtar, si pjesë e PNA-së, ka të bëjë me bashkëpunimin rajonal dhe bilateral ndërmjet agjencive për sigurinë publike për mbylljen e kanaleve të tregtisë me njerëz dhe këmbimin e të dhënave, të cilat shpiejnë në ndjekjen gjyqësore. Vetëm një pikëe ketij bashkëpunimi ka të bëjë me bashkëpunimin mes Qeverisë dhe OSBE-së, IOM-it dhe SECI-t, me qëllim që ashtu të sigurohet kujdes përkatës, kthim dhe riintegrim i viktimave, në veçanti i grupeve të rrezikuara, siç janë gratë dhe fëmijët. Këto aktivitete janë nën përgjegjësinë e Ministrisë së Drejtësisë, të Punëve të Brendshme dhe të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Dispozitat qytetare fokusohen në bashkëpunimin ndërmjet agjencive qeveritare dhe joqeveritare dhe në sigurimin e stërvitjes dhe të dhënave për të gjitha institucionet të cilat janë të kyçura në aktivitetet kundër tregtisë me njerëz.

Për bashkëpunim më efikas kundër tregtisë me njerëz, do të formohet një bazë qendrore e të dhënave për individë dhe grupe të cilët merren me tregtinë me njerëz, për rastet e regjistruara, të dhënat për kundërvajtje dhe akte penale, paditë nga zyra e Prokurorit publik dhe aktpaditë penale. Kjo bazë e të dhënave do të vihet në raport të ndërsjellë për moshën, gjininë, kombësinë dhe prejardhjen sociale.

Departamenti për luftë kundër tregtisë me njerëz pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme është përgjegjës për aktivitetet operative të cilat shpiejnë deri te identifikimi dhe ndjekja gjyqësore e tregtarëve. Department i njëjtë është përgjegjës edhe për krijimin e bazës së të dhënave dhe për udhëheqjen me Komitetin Nacional për asgjësim të tregtisë me njerëz në IRJ të Maqedonisë. Nga ana e tij, Komiteti nacional, do të bashkëpunojë me PNA-në dhe me agjencitë qeveritare e joqeveritare që janë të kyçura në implementimin e PNA-së dhe do të përgatitë raporte vjetore.

PNA-ja maqedonase njëkohësisht është edhe shumë e përgjithësuar dhe shumë e detajuar. Nga njëra anë ajo detajisht i përshkruan aktivitetet të cilat duhet të ndërmerren nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërsa nga ana tjetër, ai, në mënyrë shumë të përgjithësuar i përshkruan përgjegjësitë dhe kopetencat e ministrive të tjera. Fitohet përshtypje se PNA-ja është krijuar kryesisht që agjencitë për siguri publike të ndërmarrin masa të caktuara dhe se agjenda e saj udhëhiqet nga qasja e çështjes së tregtisë me njerëz nga aspekti i sigurisë publike, me më pak vëmendje në aspektet e tjera të punës për luftë kundër tregtisë me njerëz. Për shembull, nuk ka asgjë në PNA kur bëhet fjalë për masat mbrojtëse të të drejtave të njeriut për viktimat e tregtisë, veçanërisht për masa të veçanta për ndihmë dhe mbrojtje të viktimave fëmijë. Githashtu nuk ka as buxhet për implementimin e aktiviteteve të cilat janë paraparë në PNA.³⁶⁰

2.2. Ligdhënia për luftë kundër tregtisë me njerëz

Këshilli nacional për tregtinë me njerëz dhe emigrimin jolegal, që është përcaktuar nga Qeveria në shkurt të vitit 2001, organizoi një komitet interdisiplinor të udhëhequr nga ministrinë e drejtësisë për harmonizimin e ligjeve maqedonase me kërkesat e Protokollit të Palermos. Forma e drejtë duhet të përmbajë:

- Hyrje në kodin penal të veprës së re penale - tregtia me njerëz – në lligjin penal, sipas definicionit të Protokollit të Palermos për tregtinë me njerëz, si dhe shtimin e dënimit në rregullimet aktuale për format e organizuara të tregtisë me njerëz;
- Hyrje në veprën penale - Kalimi jolegal i kufirit;
- Amandamenti i Ligjit për veprë penale, me të cilin do të mundësohet hetimi i të gjitha formave dhe aktiviteteve të kriminalitetit të organizuar dhe përfshirja e teknikave të reja për hetim (elektronike dhe formave të tjera të vëzhgimit);
- Modifikimi i rregullimit ligjor ekzistues për inspektimin shëndetsor dhe të punës për rritjen e mundësisë për identifikim të personave me të cilët tregtohet, përmes zbatimit të ndryshimeve në lligjin e punës dhe ligjëdhënien shëndetësore përmes dhënies së lejeve të punës; dhe
- Përmirësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar me vendet e tjera me qëllim të ekstradimit të tregtarëve.

³⁶⁰ Në vitin 2003, Komisioni nacional, përmes identifikimit të përparësive të aktiviteteve të tij, e solli PNA-në zyrtare. Të dhëna nga OSBE-ja, Xheraldin Bjelersted, letër e datës 21.08.2003.

IRJ e Maqedonisë e ka nënshkruar, por ende nuk e ka ratifikuar, Protokollin e Palermos. Neni i ri për tregtinë me njerëz (Neni 418a nga Ligji Penal) është nënvizuar nga Komiteti interdisiplinor dhe i është dorëzuar Kuvendit në vitin 2001. Ky nen hyri në fuqi më 25.01.2002.

Ligji, si vepër penale, e identifikon përdorimin e vetëdijshëm ose krijimin e mundësisë që të tjerët të shfrytëzojnë shërbime seksuale nga viktimat e tregtisë me njerëz. Dënimi është nga 6 muaj deri në 5 vjet burg. Kur viktimat është fëmijë, dënimi nuk është më i vogël se 5 vjet burg.

Në IRJ të Maqedonisë prostitucioni nuk është kriminalizuar, por ndërmjetësimi dhe bashkëveprimi është i ndaluar. Ndryshimet në ligjet për prostitucionin dhe mundësitë për legalizimin e prostitucionit në IRJ të Maqedonisë diskutohen që nga pavarësia e saj dhe dy herë janë propozuar para Kuvendit (në 1994 dhe 1998), por nuk janë miratuar. Tregtia me njerëz mund të gjykohej edhe sipas neneve tjera të Ligjit penal, përfshirë edhe kalimin jolegal të kufijve shtetëror (neni 402), detyrimi (neni 139), privimi jolegal nga liria (neni 140), kidnapimi (neni 141), ndërmjetësimi për zbatimin e prostitucionit (neni 191), gjetja dhe krijimi i kushteve për veprim seksual (neni 192), dhunimi fëmijëror i personit të pandihmë (neni 187), sulmi seksual ndaj fëmijës (neni 188) dhe krijimi i raporteve robëruese dhe transportimin e personave në robëri (neni 418).³⁶¹

Ligjdhënia më gjithëpërfshirëse e cila ka të bëjë me tregtinë me njerëz për momentin po përgatitet me ndryshimet e Ligjit penal dhe Ligjit për vepër penale, për t'u përshtatur kështu me të drejtat ndërkombëtare. Nenet e tjera do të përfshijnë mbrojtjen e dëshmitarëve, dispozitat e së drejtës për përmirësimin e bashkëpunimit me të drejtën ndërkombëtare, kontrabandën me emigrantë jolegalë, teknikat speciale për hetim, si dhe përgjegjësinë penale për avokatët dhe konfiskimin e mjetve nga veprimet kundërvajtëse. Gjithashtu propozohet që tregtarëve me njerëz t'u konfiskohet malli.

Ligji i ri për azil – Ligji për azil dhe mbrojtje të përkohshme - është miratuar para do kohe.³⁶²

2.3. Ndihma për viktimat

2.3.1. Identifikimi

Në vitin 2001 IOM-i dhe Qeveria nënshkruan marrëveshje që policia ta njoftojë IOM-in për të gjitha gratë - emigrante jolegale. Kështu sistemi për identifikimin dhe mbikëqyrjen e femrave me të cilat është tregtuar funksionon në kuadër të kësaj marrëveshje. Policia i identifikon gratë dhe vajzat me të cilat mund të tregtohet dhe i transferon në qendrën tranzitore – strehimoren për viktimat e tregtisë me njerëz në Shkup, ku IOM-i bën vlerësimin e dytë.

Sipas menaxhmentit të strehimores,³⁶³ në priudhën prej janarit 2001 deri në tetor 2002, 189 viktimat të tregtisë jolegale me njerëz janë regjistruar në strehimore në Shkup, 12% prej tyre nën moshën 18-vjeçare.³⁶⁴ Gjithsejt, 251 persona kanë qëndruar në strehimore gjatë kësaj periudhe, mirëpo disa prej tyre nuk ishin viktimat të tregtisë me njerëz, por emigrantë jolegalë të cilët ishin vendosur në të njëjtën ndërtesë. 34 nga gratë dhe vajzat, me të cilat ishte tregtuar, ishin nga Rumania, 32 nga Moldavia, 16 nga Ukraina, ndërsa të tjerat nga Federata Ruse (8), Bullgaria (5), Kosova (2), Kroacia dhe Serbia (nga një).³⁶⁵ Gjithashtu, kishte 12 gra të huaja të cilat kishin ardhur nga Moldavia dhe Rumania të dëshmojnë si dëshmitare në rastin e tregtisë me njerëz dhe ishin vendosur në strehimore gjatë kohës së qëndrimit të tyre në IRJ të Maqedonisë.

Si rezultat i marrëveshjes me Ministrinë për punë të brendshme dhe IOM-it, gratë dhe vajzat janë nën mbikëqyrjen e IOM-it përmes (kujdesit) përcjelljes policore. Mënyra kryesore me të cilën policia kontakton me viktimat potenciale të tregtisë me njerëz bëhet përmes bastisjes së bareve. Bastisjet zakonisht organizohen si operacione të mëdha, ku bastisen, njëkohësisht 5 ose 6 establishmente. Sipas

³⁶¹ Ligji Penal i IRJM, Gazeta Zyrtare e RM nr.52/1991, sipas: Tregtia me njerëz, biznesi kriminal me pasqyrë të skllavërimit, IOM, Shkup, 2001, P.29-37.

³⁶² E publikuar në Gazetën Zyrtare nr. 49 të 25.07.2003; hyri në fuqi më 04.08.2003.

³⁶³ Intervistë me Mlladen Trajkovskin, drejtor i Qendrës tranzitoree për të huaj, Shkup, 10.12.2002.

³⁶⁴ Megjithatë sipas statistikës së IOM-it, 455 persona u ndihmuan në këtë periudhë. Gjatë gjithë vitit 2002, 213 gra dhe vajza u ndihmuan dhe 95 u ndihmuan në vitin 2003 (janar – qershor).

³⁶⁵ Sipas statistikës së IOM-it, 50% e grave, të cilave u është ndihmuar nga shtatori i vitit 2000 deri në maj të vitit 2003, ishin nga Moldavia, 30% nga Rumania, 11% nga Ukraina, 3% nga Bullgaria, 2% nga Rusia. Të tjerat janë nga Bjellorusia, SMZ-ja, Kosova, Republika Çeke, Litunia dhe Kroacia (raste të ndara).

burimeve vendore, këto operacione jogjithmonë janë të organizuara si duhet, nga të dhënat e bastisjeve të mëparshme, koha dhe lokacionet vështirë zgjedhen.

Të gjitha gratë dhe vajzat të cilat gjenden nëpër bare dërgohen në stacione policore, ku policia e repartit për hetime penale realizon intervista fillestare për mbledhjen e të dhënave elementare për gratë. Në rastet kur gratë janë të huaja, e veçanërisht kur dokumentet e tyre nuk janë në rregull, policia nga inspektoriat për të huaj i merr ato në pyetje që ta verifikojë statusin e tyre legal në vend. Ato gra të cilat nuk kanë dokumente legale, shpeshherë përzihen nga vendi. Nëse policia zbulon se dëshmitë e grave janë të dobishme për hetimin e kriminalitetit të organizuar, atëherë njoftohet njësia për kriminalitetin e organizuar. Nuk ka kritere të qarta me të cilat policia mund t'i identifikojë gratë ose vajzat si viktimat të tregtisë jolegale me njerëz. Konsiderohet se njëri ndër kriteret më kryesore është sa është i dobishëm viktimat si dëshmitar, edhe pse njëkohësisht policia se për IOM-in kriteri akoma është përgatitje e viktimës që të kthehet në vendlindje.

Edhe pse bastisjet nëpër bare rezultojnë me deportimin ose transferimin e grave dhe vajzave në strehimore, pronarët e bareve rëndom nuk arrestohen dhe baret nuk mbyllen. Ky fakt, bashkë me praninë e dobët të policisë në disa rajone të IRJ të Maqedonisë, i bën tregtarët të ndjehen të padënueshëm.

Sipas policisë, të gjitha gratë e tregtuara, me të cilat kanë rënë në kontakt, vijnë në strehimore, e më pas IOM-i e përcjell riatdhesimin e tyre. Megjithatë, vëzhgimet e misioneve të pasuksesshme të OSBE-së, nuk janë të mendimit që të gjitha gratë të dërgohen në strehimore, sepse strehimorja i pranon vetëm ato gra të cilat dëshirojnë të kthehen në vendet e tyre amë. Gratë me të cilat tregtohet, e që nuk dëshirojnë të kthehen në vendet amë, nuk kanë zgjidhje tjetër, pos që të deportohen. Pikërisht për këtë, metoda momentale për identifikimin e viktimave, të cilën e përdor policia, nuk ua siguron të gjitha viktimave të drejtën për ndihmë në procesin e kthimit.

2.3.2. Ndihma

IOM-i bën kontroll të të dhënave të cilat ua jep policia për gratë dhe vajzat me të cilat është tregtuar. Në disa raste, edhe gratë dhe vajzat të cilat nuk janë viktimat të tregtisë me njerëz, mund të kyçen në programet për kthim, nëse për to IOM-mendon se edhe ato mund të kyçen në tregtinë me njerëz, ashtu që nëse deportohen, e nuk përkrahen nga IOM-i. Këto gra kthehen në vendet e tyre amë si viktimat të dyshimta, pa asnjë ndihmë gjatë riintegrit.

Edhe përkundër kësaj, gratë të cilat janë viktimat të tregtisë me njerëz dhe që nuk pajtohen të kthehen në vendet e tyre amë, janë sjellë në strehimore nga ana e policisë, mirëpo nuk janë përfshirë në program, ashtu që nuk mund të llogaritin në ndonjë ndihmë. Këto gra patjetër duhet të nënshkruajnë se e refuzojnë ndihmën për kthim dhe u drejtohen autoriteteve. Sipas IOM-it, nuk ekziston e drejtë elementare për prolongimin e qëndrimit në strehimore për gratë të cilat nuk dëshirojnë të kthehen në shtëpi. Megjithatë, IOM-i gjithashtu vuri në pah se për viktimat nga Rumania, teoritikisht ekziston mundësi që të aplikojnë për azil humanitar, duke u mbështetur në frikën nga ndjekja gjyqësore. Regullimi ligjor speciale rumun nr. 122³⁶⁶ dhe neni 20³⁶⁷ nga Ligji penal që kanë të bëjnë me prostitucionin, u jep viktimave mbështetje për gjykim korrekt pas kthimit të tyre. Deri tani nuk ka ndonjë rast të ndonjë viktime rumune të tregtisë me njerëz, e cila kërkon vizë humanitare në IRJ të Maqedonisë.

Qendra tranzitore

Qendra tranzitore, e vendosur në Shkup, është strehimore për gratë me të cilat është tregtuar. Ajo ka kapacitet të sigurojë vendstrehim për më së shumti 20 gra. Ajo është formuar nga Ministria e Punëve të Brendshme në mars të vitit 2001. Gratë dhe vajzat marrin ndihmë shëndetësore dhe sociale, por ka vetëm ndihmë juridike elementare, përveç nëse gratë nuk vendosin të dëshmojnë, me ç'rast, OJQ-ja

³⁶⁶ Sipas IOM-it: Strehimorja është institucion përmes të cilit viktimat e tregtisë me njerëz fitojnë të drejtën e zgjatjes së qëndrimit legal dhe kushte derisa presin riatdhesimin vullnetar të tyre. Shih: www.iomskopje.org.mk/CT/projects/da/refferals.html. Accessed, 10 gusht 2003.

³⁶⁷ Sipas Dispozitës speciale nr.112 të shkurtit të vitit 2003. Për qytetarët rumunë të cilët hyjnë në një shtet të huaj apo e lëshojnë atë përmes kalimit ilegal të kufijve, llogaritet se kanë bërë veprë penale. Në rastet e tregtisë me njerëz, kur viktimat rumunë të tregtisë jolegale i kanë kaluar kufijt e vendit tranzitor apo të vendeve të caktuar, ajo/ai do të paditet, ndërsa në Rumani për këtë veprë penale paditet pas kthimit vullnetar, të detyrueshëm ose riatdhesimit.

vendore do të duhej t'u sigurojë avokatë të cilët do t'u ndihmonin.³⁶⁸ Në fillim të vitit 2003, IOM-i akoma zhvillonte bisedime me OJQ-të vendore, të cilat grave viktime të tregtisë me njerëz, ishin të gatshme t'u siguronin këshilla të domosdoshme juridike dhe mbështetje.

Sipas IOM-it, hapësirat janë tepër të vogla dhe nuk ka vend për fëmijë dhe për aktivitete plotësuese, siç janë stërvitjet dhe aktivitetet fizike, si dhe hapësira për pajisje plotësuese.

La Strada - Porta e hapur

OJQ-ja vendore La Strada, udhëheq me informacione, ka linjë të nxehtë preventive për tregtinë me njerëz që nga tetori i vitit 2002. Gjashtë persona nga La Strada kaluan kursin stërvitës për punë me linja të nxehta për luftë kundër tregtisë me njerëz, që janë të kryera nga La Strada nga Bullgaria. Linja e nxehtë punon 12 orë në ditë, nga ora 8 e mëngjesit deri në ora 20 e mbrëmjes, nga e hëna deri të premten. Atyre që paraqiten u jepen të dhëna për agjencitë për udhëtime dhe punë jashtë vendit si dhe këshilla juridike për emigrimin. Disa thirrje janë nga viktimat e tregtisë me njerëz, të cilëve u nevojitet ndihmë dhe përkrahje. Ka edhe thirrje nga prindër të grave dhe vajzave të huaja me të cilat është tregtuar, të cilët përpiqen t'i gjejnë fëmijë të tyre. Të dhënat për rastet e tregtisë me njerëz i jepen policisë. Prindërit dhe personat tjerë, të cilët kanë informata për rastet e tregtisë me njerëz këshillohen që të paraqiten në polici.

Deri para do kohe, La Strada nuk mbante kontakte të drejtpërdrejta me viktimat e tregtisë jolegale me njerëz dhe nuk kishte të dhëna për rastet e identifikuar nga rrjeti i La Strada-s. Në muajt e fundit La Strada filloi një bashkëpunim më të ngushtë me Ministrinë e Punëve të Brendshme. Me kërkesë të Ministrisë, ata ofruan ndihmë për dy gra, viktime të tregtisë me njerëz, duke siguruar mjete financiare për bileta aeroplani, si dhe ndihmë emotive dhe organizim për riatdhesimin e tyre. Pas kthimit në vendlindje, zyra e La Strada-s, u ndihmon grave në vendin amë dhe mban përgjegjësi për riintegrimin e mëtejshëm të tyre.

Porta e Hapur – La Strada në Programin për ndihmë të nrejtëpërdrejtë i ofron këto shërbime:

- Linja SOS ofron:
 - Mbështetje emotive;
 - Riorientim të shërbimeve të tjera;
 - Ndihmë për marrjen e vendimeve dhe përgatitjen e planit e të sigurisë dhe planin të veprimt;
- Këshilla psikologjike, mbështetje emotive, intervenime në kriza;
- Strehim të përkohshëm (nga La Strada në bashkëpunim me organizatat e tjera);
- Kthim të dokumenteve personale;
- Ndihmë elementare juridike dhe riorientim për shërbime të tjera juridike;
- Sigurim të kontaktit me familjen (nëse kjo është e nevojshme);
- Ndihmë humanitare në formë të ushqimit, barnave dhe mjeteve bazë.

La Strada, gjithashtu, punon edhe në rastet e tregtisë me njerëz të brendshëm, të cilat nuk janë paraqitur ose që nuk ndiqen nga policia. Ata janë të gatshëm të hapin strehimore për gratë dhe vajzat të cilat nuk kualifikohen për programin e IOM-it.

Megjithatë, Ministria e Punëve të Brendshme është e gatshme të nënshkruajë marrëveshje (MOU) me OJQ-të vendore për sigurimin e strehimores dhe të dakordohet për kriteret e bashkëpunimit për shkak të pengesave juridike³⁶⁹

2.4. Tregtia me fëmijë

³⁶⁸ Prostitucioni në Rumani është vepër penale, por neni 20 i Kodit penal nënkupton që viktimat e tregtisë me njerëz të cilat kanë kryer vepër penale prostitucion, nuk do të mbajnë përgjegjësi për veprën penale, pos nëse para fillimit të hetimit të padisë penale tregti me njerëz, ky person i lajmëron organet kompetente dhe, nëse me fillimin e hetimeve, ndihmon për kapjen e fajtorëve. Shih kapitullin për Rumaninë.

³⁶⁹ Sipas marrëveshjes së shkruar me IOM-in (të korrikut 2003). Shoqata e Juristëve Maqedonë (TEMIS) do të sigurojë ndihmë juridike vetëm të miturve, viktimave të tregtisë me njerëz, të hendikepuarve apo të sëmurëve mendorë. TEMIS është me fazën e parë të hulumtimeve, analizë dhe elaborim të rekomandimeve për kornizë të drejtë institucionale të ndrueshme të këto kategori të viktimave. Ata akoma nuk kanë filluar të ofrojnë ndihmë juridike në Qendrën tranzite, sepse presin autorizim definitiv nga Ministria për Punë të Brendshme dhe Komisioni Nacional.

Përafërsisht 12% e viktimave të tregtisë me njerëz, të cilëve u është dhënë ndihmë në IRJ të Maqedonisë, janë nën moshën 18-vjeçare.³⁷⁰ Këtu nuk ka të dhëna për tregtinë me fëmijë lypës.³⁷¹

Vashëzat e huaja nën moshën 18-vjeçare, të cilat janë gjetur gjatë bastisjeve të bareve (nuk është e qartë a trajtohen si viktima të gjitha vashëzat nëpër bare që janë nën moshën 18-vjeçare), trajtohen si të rritura dhe ato vendosen në strehimore, derisa policia të vendosë se janë ato janë viktima të tregtisë me njerëz. Ato në strehimore trajtohen si edhe viktimat tjera, por për ta ka edhe program tjetër speciale, i cili është përgatitur nga qendra për punë sociale, ndërsa ambasadat relevante informohen për të gjitha rastet e personave të mitur të cilët janë të vendosur në strehimore. Kthimi i tyre organizohet përmes IOM-it, kurse fëmijët në vendet amë pranohen nga personeli i IOM-it. Edhe UNICEF i zbatoi mënyrat e tij për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktima të tregtisë me njerëz tek anëtarët e Komisionit Nacional për rishqyrtim të implementimit sipas PNA-së.

Sipas La Strada-s, ka të dhëna për vashëza të IRJ të Maqedonisë të cilat janë tregtuar në Itali dhe për tregti tjetër të brendshme me njerëz. Në një rast, tri vashëza të tregtuara nga një qytet tjetër u gjetën në një banesë private në Shkup. Ato u dërguan në Qendrën për punë sociale dhe prej aty u kthyen në shtëpi. Kërkimet shkencore të disa studentëve të Universitetit Kolumbia që janë realizuar për UNICEF-in, gjithashtu tregojnë se tregtia me njerëz të brendshëm është çështje serioze në IRJ të Maqedonisë, edhe pse shpeshherë ajo nuk pranohet si e tillë. Disa fëmijë të cilët kishin marrë pjesë në disa grupe të fokusuara, e quajtën këtë prostitucion sekret. Një pjesë e të dhënave, të cilat studiuesit i morën nga grupet e fokusuara ishin parashikime personale të anëtarëve të familjeve dhe shokëve të afërt, me të cilët është tregtuar në këtë vend.³⁷²

2.5. Ndjekja gjyqësore

Deri në fillim të vitit 2002, kur neni i ri për tregtinë me njerëz u vendos në Kodin penal, anëtarët të cilët më së shpeshti u përdorën për rastet e gjykimeve për tregtinë me njerëz ishin kalimet jolegale të kufijve, krijimi i kushteve për prostitucion, ndërmjetësim dhe mundësim të shërbimeve seksuale. Si edhe në vendet tjera të ish Jugosllavisë, neni për robërinë rrallë shfrytëzohej për ndjekjen gjyqësore të tregtarëve. Megjithatë, për herë të parë në vitin 2000 u ngritën akt padi penale kundër 8 personave sipas nenit 418 për robëri.³⁷³

Në Janar të vitit 2002 u vendos neni special kundër tregtisë me njerëz (neni 418). Që atëherë, sipas ligjit të ri, kundër tregtarëve kanë filluar 8 raste, përfshirë edhe 4 në Shkup. Dy nga ato u mbyllën para tetorit të 2002-shit. Njëri nga rastet, që kishte të bënte me tregtinë e rumuneve dhe të moldaveve përmes kufirit serb nga ana e taksistëve, u gjykua dhe u dënua vetëm me një muaj burg. Gjykimi mbaroi me dënimin e tregtarëve me 4 vjet burg. Gjatë kohës së procedurës, dëshmitarët ishin të vendosur në qendrën tranzitore, e cila është strehimore për viktimat e tregtisë me njerëz. Në tetor të vitit 2002, në strehimore kishte 10 dëshmitarë të cilat pritin të dëshmojnë për dy raste. Meqë në IRJ të Maqedonisë nuk ka ligj për mbrojtjen e dëshmitarëve, gratë janë të mbrojtura gjatë kohës sa zgjat gjykimi, ashtu që ato qëndrojnë në qendrën të sigurt tranzitore dhe ndaj tyre nuk merren masa të tjera për mbrojtjen e tyre.

Në vitin 2002 kishte 3 aktgjykime sipas ligjit të vjetër. Në rastin më të njohur të atij viti, të ashtuquajturin rasti i Kumanovës, tregtarët u akuzuan dhe u dënuan për vepër penale kontrabandë dhe vepra të tjera penale në lidhje me prostitucionin.³⁷⁴ Dëshmitarët, femra nga Moldavia dhe Rumania, të cilat tashmë ishin kthyer në vendlindjet e tyre, u kthyen në IRJ të Maqedonisë gjatë gjykimit, kështu që mund të dëshmonin kundër tregtarëve të tyre. Udhëtimi i tyre për në IRJ të Maqedonisë u organizua nga Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me OJQ-të dhe IOM-in. Nuk është e qartë se a u ndërmor ky aktivitet në pajtim me kornizën ligjore ndërkombëtare duke mbajtur llogari të mjaftueshme edhe për sigurinë e dëshmitarëve.

³⁷⁰ Intervistë me Jasmina Dimishkovska-Rajkovska, Koordinator nacional, Porta e Hapur La Strada, Shkup, 13.12.2002

³⁷¹ Intervistë me Mladen Trajkovski, drejtor i Qendrës Tranzite për të huaj, Shkup, 10.12.2002.

³⁷² Të dhënat preliminare nga hulumtimet në Universitetin Kolumbia, të përgatitura për UNICEF, NJujork, treguan se tregtia me fëmijë për punë nuk llogaritet si problem, në bazë të grupeve të fokusimit me të cilët është punuar. Madje edhe në fokus grupet afër kufirit të Greqisë - ku shumë fëmijë nga Shqipëria janë shitur për punë - nuk dyshohet për tregti me fëmijë për punë.

³⁷³ Nuk është për shitje: Preventiva e tregtisë me fëmijë në EJL. Hulumtimi pilot në Shqipëri, Moldavi, dhe Rumania. Raport i shkruar për UNICEF-in në bashkëpunim me Shkollën për çështje publike dhe ndërkombëtare të Universitetit Kolumbia, Punëtorja për Zhvillim Ekonomik dhe Politik. 01.05.2003.

³⁷⁴ Intervistë me përfaqësuesin e zyrës së Prokurorit publik, Shkup, 07.11.2003.

3. Përfundimi

Të dhënat nga IRJ e Maqedonisë tregojnë se tregtia me njerëz në IRJ të Maqedonisë nuk rritet. Numrat e viktimave të tregtisë me njerëz, të cilëve u është ofruar ndihmë dhe vendosje në qendrën tranzitore, nuk ndryshojnë, mirëpo qendra është e hapur vetëm për viktimat e huaja të tregtisë me njerëz, të cilat kanë dëshirë të kthehen në vendlindjet e tyre. Gratë dhe fëmijët me të cilët tregtohet brenda vendit në përgjithësi nuk janë identifikuar.

PNA-ja në njëfarë mënyre është shumë e përgjithësuar, ndërsa në disa raste shumë e detajizuar. Nga njëra anë, detajisht i përshkruan aktivitetet të cilat duhet t'i ndërmarë Ministria e Punëve të Brendshme, kurse nga ana tjetër, flet për përgjegjësitë e përgjithshme të ministrive të tjera. Kështu fitohet përshkrimi se ajo është themeluar kryesisht që të mundësohen disa veprime nga ana e agjencisë për siguri publike dhe se agjenda e saj është dhënë si çështje për sigurim shoqëror të tregtisë me njerëz, pa pasur shumë konsideratë për aspektet e të drejtave të njeriut në luftën kundër tregtisë me njerëz.

Nuk PNA nuk ka asgjë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut për viktimat e tregtisë jolegale ose për masat speciale të cilat duhet të ndërmerren për ndihmë dhe mbrojtje të viktimave fëmijë. PNA, po ashtu, nuk siguron as burime buxhetore për implementimin e aktiviteteve të propozuara.

Definicioni i tregtisë me njerëz në nenin e ri të kodit penal, i cili e kriminalizon tregtinë me njerëz është në përputhshmëri me Konventën për tregtinë me njerëz të Palermos. Ligjdhënia gjithpërfshirëse e cila ka të bëjë me tregtinë me njerëz për momentin po përgatitet me ndryshimet e Ligjit penal dhe Ligjit për vepër penale, për t'u përshtatur kështu me të drejtat ndërkombëtare. Neni ri do të përfshijë mbrojtjen e dëshmitarëve, dispozitat e së drejtës për përmirësimin e bashkëpunimit me të drejtën ndërkombëtare, kontrabandën e emigrantëve jolegalë, teknikat speciale për hetim, si dhe përgjegjësitë penale për avokatët dhe konfiskimin e mjeteve të fituara nga aktivitetet kriminale.

Viktimat e dyshimta të tregtisë me njerëz identifikohen nga policia në kohën e bastisjeve të bareve. IOM-i bën vlerësimin përfundimtar për atë se cilat viktima kualifikohen për ndihmë gjatë riatdhesimit. Ministria e Punëve të Brendshme udhëheq/punon përmes qendrës tranzitore e cila i pranon vetëm ato viktima të cilat dëshirojnë të kthehen në vendlindjet e tyre. Nuk ka procedura të qarta për identifikimin e viktimave të tregtisë me njerëz. Deri tani, OJQ-të nuk kanë mundësi që në mënyrë aktive të marrin pjesë në procesin e orientimit.

Viktimat e huaja, të cilat nuk kanë mundësi/nuk duan që menjëherë të kthehen në vendlindjet e tyre, si dhe për gratë me të cilat është tregtuar brenda vendit, gjithashtu nuk ndihmohen. Gjithashtu nuk ka ndihmë të veçantë as për fëmijët.

Ndihma për viktimat sigurohet në qendrat tranzitore, edhe pse organizimi për gratë në Qendër është i dyshimit: nuk ka liri të lëvizjes; ekziston kontroll i pamjes fizike dhe i zgjedhjes së teshave; bëhet konfiskimi i pasurisë dhe në ndërtesë ka roje të uniformuara. Përveç kësaj, qendra tranzitore është pothuaj komode dhe kushtet për jetë në të janë shumë të mira. Të gjitha nevojat elementare të drejtpërdrejta të grave dhe femrave aty janë të mjaftueshme. Gjithashtu, atyre u ofrohet shërbim shumë i mirë si dhe ndihmë psikologjike nga kadro të larta profesionale. Ekziston një dallim i madh midis kufizimeve të mëdha të të drejtave të grave dhe atyre të panevojshme (për shembull, kufizimin e të drejtës për lëvizje), si dhe të shërbimit profesional të krijuara që t'i përmbushin nevojat e tyre. Nëse nuk është e qartë për vizitorët se vallë a janë gratë dhe vajzat viktima të cilat vullnetarisht e pranojnë ndihmën që u ofrohet ose mos janë emigrantë jolegalë të cilët presin deportim në kushte më humane, gjendja sigurisht që është më e paqartë për vetë gratë.

Patjetër duhet thënë se nisma maqedonase është shembull i veçantë dhe shumë pozitiv për përpjekjen serioze nga ana e shtetit për t'u përballuar me problemin shumë serioz dhe mjaft të ri që t'u ndihmojë dhe t'i mbrojë viktimat e tregtisë me njerëz. Këto komente duhet të kuptohen si kritikë konstruktive për aktivitetet qeveritare dhe si pikënisje për strukturat dhe strategjitë e ardhshme në programet kundër tregtisë jolegale. Modeli maqedonas duhet të shihet/të përdoret si shembull për mbrojtjen e viktimave.

Gjithashtu, shtrohet pyetja edhe për qëllimin dhe të drejtat elementare për dhënien e informatave bazë për të gjitha gratë dhe vajzat të cilat vendosen në strehimore dhe për besueshmërinë e të dhënave. Nëse gratë dhe vajzat nuk janë të akuzuara për ndonjë krim dhe vullnetarisht e pranojnë ndihmën e ofruar,

përse atëherë merren në pyetje deri në 4 herë para riadhesimit, fotografohen, u merren shenjat e gishtërinjve dhe këto të dhëna dërgohen në bazën e të dhënave?

Për vitikamt e tregtisë me njerëz në strehimore nuk jepet as ndihmë juridike. Edhe pse bisedimet mes IOM-it dhe OJQ-së vendore, e cila mund të sigurojë ndihmë, rrjedhin një kohë më të gjatë, viktimat akoma kanë ngelur pa këshilla juridike.

Është bërë përparim i madh në fushën ndjekjes gjyqësore. Disa raste mbaruan me dënimin e tregtarëve për aktet penale që ata i kishin kryer. Rastet ishin përgatitur shumë mirë dhe shumë mirë ishin përcjellë. Për herë të parë në gjithë rajonin, policia maqedonase në gjykim siguroi praninë e viktimave/dëshmitarëve, të cilat pastaj u kthyen në vendet e tyre amë. Gratë nga Moldavia dhe Rumania u pajtuan të dëshmojnë dhe të kthehen në IRJ të Maqedonisë gjatë gjyqimit. Gjatë kohës së qëndrimit të tyre në vend, ato ishin të mbrojtura nga policia dhe të vendosura në Qendrën tranzitore për viktimat e tregtisë me njerëz. Megjithatë nuk është e qartë nëse ky aktivitet ishte ndërmarrë në pajtim me kornizën ndërkombëtare juridike dhe me kujdes të mjaftueshëm për sigurinë e dëshmitarëve. Ky shembull hedh dritë për nevojën e mëtutjeshme të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndërmjet agjencive të ndryshme.

4. Studime për Maqedoninë: Strehimorja shtetërore për viktimat e tregtisë me njerëz

Në mars të vitit 2001, Departamenti për azil pranë Sektorit për të Huajt dhe Emigrimin (DFII) në Ministrinë e Punëve të Brendshme, formoi qendrën tranzitore – strehimore për viktimat e tregtisë me njerëz. Nëse, pas bastisjes së ndonjë bari, policia e DFII-së gjen se një grua apo një vajzë e huaj është viktimë e tregtisë me njerëz, dërgohet formular special deri te shefi i zyrës së DFII-së me të cilin kërkohet pranim të saj në qendrën tranzitore. Pas pranimit, gratë dhe vajzat dërgohen në strehimore ku fillimisht i kontrollon polici-grua. Gjithë pasuria e tyre, me përjashtim të teshave, ruhet dhe u dorëzohet para nisjes.

Mesatarja e qëndrimit në strehimore është 20 ditë. IOM-i kujdeset për udhëheqjen e përditshme të Qendrës dhe për kontrollimet mjeksore. Kushtet në strehimore janë të mira dhe gratë janë të mbrojtura mirë nga tregtarët edhe pse liria e lëvizjes së tyre është plotësisht e kufizuar: si të hyjnë në strehimore, ato nuk mund të largohen prej aty kur të duan ato, madje nuk kanë të drejtë as edhe të shetisin jashta ndërtesës. Policia, përmes policit-roje, i cili qëndron në portën e jashtme të oborrit të ndërtesës, kujdeset për sigurinë e tyre. I pranishëm në ndërtesë 24 orë është edhe një roje e uniformuar, polic-femër.

Rregullat në qendrën tranzitore janë shumë të rrepta, ashtu si ato në strehimore ku gratë hyjnë vullnetarisht. Gratë nuk kanë të drejtë të mbajnë me vete mjete bizhuterie, nuk u lejohet që t'i ngjyrosin flokët dhe nuk kanë të drejtë të mbajnë tesha provokuese. Policia e përcakton çfarë është provokuese dhe, nëse ka nevojë, mund të kërkojë nga gratë që ta ndërrojnë veshjen. Është pozitive që grave dhe vajzave në pushimore u sigurohen atlete (trajnerka) dhe bluza.

Pas një apo dy ditësh, secila nga gratë merret në pyetje nga DFII-ja që të përcaktohet identiteti i saj. Këto të dhëna këmbehen me IOM-in dhe me ambasadat relevante. Të dhënat e të gjitha grave dhe vajzave të cilat hyjnë në strehimore ruhen në bazën e kompjuterizuar të të dhënave, e cila i përmban edhe fotografitë dhe shenjat e gishtërinjve të viktimave. IOM zhvillon biseda edhe për nevojat e veta. Sektori për kriminalitet të organizuar këtu e zhvillon bisedën e tretë me rradhë. Gratë të cilat pajtohen të dëshmojnë në procedurat penale kundër tregtarëve, mbeten në Qendër deri në fund të procedurës (më së gjati 80 ditë). Për ato që nuk dëshirojnë të dëshmojnë, qëndrimi zgjat aq sa është i nevojshëm organizimi për kthimin e tyre (zakonisht 5 – 10 ditë).

Para muajit qershor të vitit 2002, grave dhe vajzave të cilat kishin qëndruar në Qendër, nuk u ishte siguruar kurrfarë këshille apo ndihmë psiko-sociale. Megjithatë tash gjendja ka ndryshuar mjaft. OJQ-a vendore që është e angazhuar nga IOM-i - Shoqata për ndihmë fëmijëve dhe familjeve të rrezik "Për fëmijëri të lumtur" (FHC) filloi të punojë me gratë dhe vajzat që gjendeshin në qendër. Grupi përbëhej nga 5-terapeutë dhe 1-koordinator, ndërsa në strehimore, për çdo ditë, nga ora 8 e mëngjesit deri në orën 20 të mbrëmjes, punojnë dy ekipe. Ata sigurojnë ndihmë psiko-sociale dhe këshilla të përgjithshme si dhe mbikëqyrje të të gjitha aktiviteteve në strehimore. Qëllimi kryesor i aktiviteteve është sigurimi i ndihmës psikosociale për të gjitha gratë në strehimore. Aktivitetet programore përbajnë:

- Ndhimë psiko-sociale, të siguruar gjatë 24 orëve të para në strehimore;
- Aktivitete edukative, përfshirë edhe stërvitje për të marrë njohuri për vetveten, stërvitje për vetmbrojtje nga dhuna dhe keqpërdorimet, stërvitje dhe të dhëna për atë se si të punohet më sigurt jashtë vendit, në seminare edukuese për pranimin e të drejtës për jetë pa dhunë, stërvitje për krijimin e pamjes pozitive për vetveten dhe aktivitete për përforsimin e aftësive, siç është stërvitja për përdorimin e kompjuterit, qendrisja ose gatimi;
- Aktivitete individuale terapeutike, siç janë: këshillat individuale dhe terapia dhe psikoterapia e shkurtër;
- Aktivitete grupore terapeutike, siç janë: terapia grupore, psikodrama, socio-terapia grupore, këmbimi i të dhënave me anëtarët e tjerë të ekipit dhe anëtarët e IOM-it;
- Këshilla individuale me kërkesë; dhe
- Rehabilitimi dhe përgatitje për riintegrim në shoqëri (stërvitje për shkathtësitë sociale).

Shumë gra dhe vajza të cilat hyjnë në strehimore kanë probleme serioze psikologjike - amnezi, anoreksi, histeri, depresion etj. Atyre u duhet terapi dhe mbështetje. Para riatdhesimit, FHC-ja përgatit raport për gjendjen shëndetësore si dhe për sjelljen e secilës nga gratë. Raporti nuk i tregohet gruas. Ai është informim për zyrën e IOM-it në vendlindje. Sipas FHC-së, të gjitha gratë që marrin pjesë në program, vërtetë dëshirojnë të kthehen në vendlindje (80-90%).

Strehimorja është shembull i vetëm i strehimores shtetërore për gra dhe vajza me të cilat është tregtuar në këtë rajon.³⁷⁵ Edhe pse kufizimet për gratë dhe rregullat drastike të menaxhimit të strehimores mund të jenë problematike për gratë që vijnë aty në mënyrë vullnetare, shërbimet që i siguron FHC-ja janë të shkëlqyeshme. Ai është shembull i menduar mirë dhe implementi i kujdesshëm i shërbimit për viktimat e tregtisë me njerëz, të cilat presin kthimin në vendlindjet e tyre. Problem i vetëm është mungesa e bashkëpunimit me organizatat të cilat ofrojnë shërbime të njëjta në vendet amë dhe mungesa e sistemit të orientimit të grave të cilat kanë nevojë për ndihmë të mëtutjeshme psikologjike apo ndihmë psikiatrike.

Oda Maqedonase e Avokatëve (MBA), duhej të siguronte ndihmë për viktimat e tregtisë me njerëz që janë të vendosura në qendrën tranzitore. IOM-i dhe MBA duhej të ofronin këshilla juridike preliminare për të gjitha viktimat e vendosura në qendrën tranzitore, si dhe të sigurojnë përfaqësim juridik dhe ndihmë për ato që ftohen në procedura penale kundër tregtarëve.³⁷⁶ Në këtë moment bisedohet për bashkëpunim më formal me Shoqatën Maqedonase të Grave Gjykatëse (TEMIS), siç është memorandumimi për mirëkuptim. Shpresojmë se disa aspekte të bashkëpunimit teknikisht do të modifikohen, me qëllim që ashtu të promovohet efikasitet më i madh në përfaqësimin juridik të viktimave.

³⁷⁵ Në momentin e shkrimit, strehimorja në Tiranë, e formuar nga Ministria Shqiptare për Qetësi Publike, akoma nuk funksiononte.

³⁷⁶ Të dhëna të siguruar nga IOM për shërbimet juridike të grave me të cilat është tregtuar në strehimore nuk ishin përkrahur nga MBA.

Përfundimet dhe rekomandimet

1. Koordinimi i aktiviteteve për luftës kundër tregtisë me njerëz në kuadër të Planit Nacional për Aksion.

Me nënshkrimin e Deklaratës së ministrave të SPTF-së për EJL-në³⁸⁴ në Palermo, Itali, qeveritë e vendeve të EJL-së pranuan ta kenë rolin udhëheqës në aktivitetet kundër tregtisë me njerëz. Kështu është krijuar një sistem i mbrojtjes regjionale, që është i koordinuar nga SPTF-ja me të cilin çdo vend obligohet të krijojë sistem unik të strukturuar për luftë kundër tregtisë me njerëz dhe këtë duhet ta në formë Planit Nacional për Aksion (PNA) Këto PNA përfshijnë agjenci qeveritare, joqeveritare dhe ndërkombëtare të cilat deri tani janë treguar si korniza teorike mjaft të dobishme.

Megjithatë PNA-të ende nuk janë implementuar plotësisht, sepse qeveritë e vendeve të EJL-së nuk janë ende plotësisht të angazhuara. Kjo është nga mungesa e kapaciteteve, interesi politik dhe mjetet e nevojshme financiare për trajtimin e tregtisë me njerëz. Pamundësia për të krijuar struktura qeveritare gjithpërfshirëse për luftë kundër tregtisë së jolegale, mund të jetë pengesë kryesore për krijimin e strategjive të suksesshme afatgjate për luftë kundër tregtisë me njerëz.

Policia gjithnjë e më tepër është e pranishme në aktivitetet kundër tregtisë me njerëz. Bashkëpunimi në mes të policisë dhe IOM-it si partner kryesorë dhe shpeshherë i vetëm, është në nivel, dhe mjaft i zhvilluar si model funksional për pjesmarrje në sigurimin publik/emigrimin e aktiviteteteve kundër tregtisë me njerëz në regjion. Momentalisht gati të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me preeventivën, mbrojtjen dhe ndjekjen gjyqësore ndërmerren dhe implementohen në kornizat e këtij modeli. Megjithatë kjo qasje në luftë kundër tregtisë me njerëz që është e mbështetur në bashkëpunimin e policisë vendore me një organizatë ndërkombëtare, nuk mund të qëndrojë sepse nuk përfshin edhe autoritete të tjera përgjegjëse apo shoqëri civile. Përkundrazi, në disa vende inkuadrimi i OJQ-ve bie, ashtu që tash ka gjithnjë më pak organizata vendore që janë të angazhuara në aktivitetet kundër tregtisë me njerëz në terren. Pastaj, policia akoma nuk i zbaton principet e të drejtave të njeriut gjatë aktiviteteteve të veta kundër tregtisë me njerëz, andaj edhe sistemi i orientimit dhe ndihmës për viktimat e tregtisë me njerëz mbetet joadekuat.

Bashkëpunimi në kuadër të PNA-së

Megjithëse është arritur përparim i dukshëm, prapë ndërtimi i strukturave për luftë kundër tregtisë me njerëz është treguar i vështirë dhe kërkon vëmendje dhe burime të përhershme. Disa PNA nuk kanë shkuar më larg se plani i parë; të tjerët ende nuk janë dokumente gjithëpërfshirëse, por vetëm kombinim i projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme të mbledhura në një vend pa ndonjë qëllim dhe strategji afatgjate. Ato kryesisht fokusohen në aktivitetet e sigurimit publik, duke iu shmangur apo duke i trajtuar si çështje të përgjithshme të drejtave të njeriut, preventivën shkaqet burimore të tregtisë me njerëz. Shpeshherë nuk ka afate kohore për aktivitetet e propozuara dhe në shumë raste PNA-të janë të hartuar pa buxhet, ashtu që financimi joadekuat dhe mungesa e burimeve shpesh e pengojnë implementimin. Në procesin e implementimit, shumë PNA pësojnë nga këto mangësi:

- Mospjesëmarrja e disa institucioneve qeveritare, më shpesh ministrite e Arsimit, Shëndetësisë dhe Politikës Sociale;
- Mosekzistimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të ndryshme qeveritare.;
- Rikonfirmimi i sigurimit publik, ashtu që tregtia me njerëz mbetet vetëm çështje Ministrisë së Punëve të Brendshme ;
- Pjesëmarrja jo e mjaftueshme e organizatave joqeveritare dhe
- Vëmendja jo e mjaftueshme ndaj standardeve dhe principeve të të drejtave të njeriut.

Kosova, e cila e miratoi ligjdhënien më të mirë për luftën kundër tregtisë me njerëz dhe standardet më të mira për veprim kundër tregtisë me njerëz në vitin 2001, ende nuk ka PNA, e as përcaktim të qartë për themelimin e strukturave të domosdoshme për luftë kundër tregtisë me njerëz nga UNMIK-u, institucionet amë apo vetëqeverisja vendore (PISG). Jo fort moti PNA-të e themeluara në Kroaci dhe në Shqipëri janë shumë më të detajizuara dhe më mirë të strukturuar se ato që formuar më herët në BH dhe Rumani. Edhe pse Bullgaria nuk ka hartuar PNA, ligjdhënëia bullgarë që u miratua pra do kohe e krijon obligimin juridik ndaj qeverisë së Bullgarisë që të hartojë plane punuese afatshkurtëra për agjencitë që merren me luftën kundër tregtisë me njerëz. Marrë në përgjithësi, PNA-të më të reja që shërbehen me përvojën e së kaluarës janë më të përparuara dhe më mirë i përmbushin nevojat të cilat

³⁸⁴ Deklarata kundër tregtisë me njerëz mund të gjendet në www.osce.org/attf_pd.pdf

janë më mirë të definuara dhe të zgjedhura. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe këmbimi i përvojave dhe të dhënave e ndihmon procesin. Është e qartë se në zhvillimin dhe implementimin e PNA-së nuk mund të shikohet si në një proces të njehershëm, por vetëm si në një proces dinamik për të cilin duhet një vëmendje konstante nga qeveria dhe bashkësia ndërkombëtare..

Rekomandimet

PNA-të duhet :

- Të themelohen në bazë të parimeve të të drejtave të njeriut;
- Të përfshijnë qëllime dhe strategji afatgjata për arritjet e tyre;
- Të përmbajnë përparësi, aktivitete konkrete, buxhete dhe korniza të afatizuara për implementim;
- T'i identifikojnë agjencitë për implementim;
- T'i japin përparësi preventivës, në veçanti shkaqeve elementare për tregtinë me njerëz dhe ndihmës për viktimat e tregtuara; dhe
- Të inkuadrojnë edhe partnerë joqeveritarë në bashkëpunimin e mëtejshëm zhvillimor dhe implementimin e PNA-së.

Roli i Qeverisë

Edhe pse qeveria duhet ta luajë rolin kryesorë në themelimin dhe koordinimin me PNA-të, megjithatë implementimi duhet të jetë proces gjithpërfshirës i bazuar në bashkëpunimin ndërmjet agjencive të cilat punojnë në çështjet e tregtisë me njerëz, përfaqësuesve qeveritarë, joqeveritarë dhe ndërkombëtarë. Shteti duhet të caktojë standarde dhe norma që të implementojë dhe zhvillojë procedura të qarta për vëzhgimin dhe evaluimin e aktiviteteve të PNA-së.

Përgjegjësia për koordinimin dhe zhvillimin e implementimit të PNA i bie qeverisë - koordinatorit të emëruar. Koordinatorët nacional janë emëruar në të gjitha vendet e EJL, por mandatet e tyre ndryshojnë. Në të shumtën e rasteve kryeministri emëron koordinator nacional i cili drejtpërdrejtë i jep llogari qeverisë. Ndonjëherë koordinatori nacional emërohet nga ministri i Punëve të Brendshme dhe ai udhëheqë me zyrën përgjegjëse për tregtinë me njerëzve pranë ministrisë. Në këtë rast personi i emëruar zakonisht nuk ka ndikim të mjaftueshëm politik apo përkrahje nga qeveria që të koordinojë me sukses me institucionet tjera qeveritare. Megjithatë, kur emërohet nga kryeministri, puna e koordinatorit për luftë kundër tregtisë me njerëz shpeshherë është njëra nga punët e shumta që i kryen i njëjti njeri, që kështu e kufizon shumë kohën që të mund t'i kushtohet çështjes së tregtisë me njerëz. Koordinatorët nacional nuk kanë përkrahjen e strukturave administrative dhe shpeshherë nuk mund t'i plotësojnë obligimet e veta.

Puna e koordinatorit nacional është që t'i udhëheqë aktivitetet e PNA-së përmes komitetit nacional apo grupit punues nacional të përbërë prej përfaqësuesëve të institucioneve të përfshira në implementimin e PNA-së, përfshirë këtu edhe organizata ndërkombëtare dhe, në disa vende, OJQ. Megjithatë shpeshherë Komitetet nacionale /grupet punuese/ rallë takohen dhe ndryshimet në skenën politike ndikojnë. Si rezultat i kësaj, nuk ka vazhdimësi në punë dhe nuk ka mekanizëm për vëzhgim dhe evaluim të përparimit. Komitetet dështojnë edhe nga mospërkrahja administrative - komunikimi është i rënduar, rezultatet nuk shpërndahen si duhet, kurse të dhënat nuk këmbehen. Në disa vende, organizatat ndërkombëtare marini mbi vehte obligim për përkrahjen e komiteteteve duke siguruar kështu edhe përkrahje logjistike, financiare dhe organizative. Në vende të tjera komitetet formojnë nëngrupe për çështje specifike. Ato grupe që janë më të vogla dhe më të lehta për t'u udhëhequr fokusohen në probleme konkrete dhe rëndom janë më efikase.

Njëri nga elementet më vonë të krijuara të PNA-së në të gjitha vendet e EJL është riorientimi dhe ndihma, përfshirë këtu edhe mbrojtjen që iu ofrohet viktimave të tregtisë me njerëz. Në shumicën e vendeve, pjesa më e madhe e aktiviteteve në këtë lëmë ende kryhen nga organizata ndërkombëtare dhe OJQ-të me ndihmë minimale nga qeveritë. Në disa vende ndihma e shtetit sapo ka filluar. Për shembull, në Shqipëri, bashkë me sistemin për riorientim të të gjitha viktimave të dyshuara nga tregtia me njerëz nga stacionet policore deri në strehimore, është krijuar strehimore e re që grave dhe fëmijëve t'u jepet mundësi për rehabilitim dhe kohë për të vendosur për të ardhmen e tyre. Shembull tjetër është nisma e qeverisë së Rumanisë për formimin e qendrave vendore për viktimat e tregtisë me njerëz. Në Kroaci në proces e sipër është zhvillimi i sistemit të strehimoreve dhe shtëpive të sigurta.

Këto ndryshime janë të mirëseardhura, në veçanti sepse problemi i obligimeve shtetërore ndaj viktimave dhe dëshmitarëve diskutohet në nivel ndërkombëtar. Këto nisma të propozuara mund të merren edhe si modele për ndihmë të cilat mund të aplikohen edhe në rajone të tjera në botë.

Megjithatë shtrohen dy çështje që janë relevante për inkorporimin e ndihmës dhe mbrojtjes në planet qeveritare. Një është nevoja për standarde të qarta, përfshirë edhe standardet e të drejtave të njeriut në punën kundër tregtisë me njerëz. Këto standarde që akoma nuk arrihen madje as në punën e disa organizatave ndërkombëtare, patjetër duhet të jenë të mbuluara nga ligjdhënia e mirë që mundëson krijim të një sistemi gjithpërfshirës për riorientimin e viktimave, sistem ky që viktimave u ofron ndihmë dhe mbrojtje të sigurt.

Çështje tjetër është nevoja për rregulla të qarta të bashkëpunimit ndërmjet agjencive që u ndihmojnë viktimave, veçanërisht OJQ-të vendore. Edhe pse qeveria duhet ta kontrollojë implementimin e PNA-së, të gjitha aktivitetet nuk do të thotë se janë implementuar drejtpërdrejtë nga agjencitë qeveritare. Disa aktivitete më mirë implementohen nga OJQ-të e specializuara për këto çështje. Për shembull, marrja e përgjegjësisë për sistemin e ndihmës nuk do të thotë se agjencitë shtetërore patjetër duhet të udhëheqin me strehimoret e viktimave të tregtisë me njerëz. Definicioni i qartë për rolin dhe zhvillimin e procedurave standarde operative për të gjitha palët e involvuara aty, do të sigurojë ambient më të mbrojtur për gratë dhe fëmijët.

Rekomandimet

Qeveritë duhet :

- Të vendosin norma dhe standarde për implementim të PNA-ve dhe të zhvillojnë procedura të qarta për vëzhgim dhe evaluaime të aktiviteteve në bazë të parimeve të të drejtave të njeriut;
- Të sigurojnë përkrahje politike dhe administrative për koordinatorin nacional dhe komisionin nacional/grupet punuese nacionale që kështu atyre t'u mundësohet që me sukses t'i kryejnë punët e tyre;
- Të përcaktojnë role të qarta për bashkëpunim ndërmjet agjencive, duke përfshirë edhe bashkëpunimin midis qeverisë, organizatave qeveritare dhe OJQ-ve.

Organizatat ndërkombëtare si partnerë të PNA

Në shumë raste impulsi nismëtar për fillimin e punës kundër tregtisë me njerëz dhe për zhvillimin e PNA-së vjen nga organizatat ndërkombëtare dhe nga donatorët e ndryshëm. Këto agjenci ende janë të inkuadruara në disa forma përmes:

- Ndikimit të shtypjes politike;
- Krijimit të standardeve dhe strukturave;
- Hetimit dhe vlerësimit të nismave për luftë kundër tregtisë me njerëz;
- Këshillimit dhe përkrahjes për procedurat ligjdhënëse;
- Pjesëmarrjen në komitetet nacionale;
- Përkrahjes për OJQ-të të cilat punojnë në çështjet e tregtisë jolegale;
- Implementimit të drejtpërdrejtë të projekteve të tregtisë me njerëz;
- Sigurimit të kontakteve ndërkombëtare dhe të kontakteve ndërmjet agjencive.

Në fillim ishte paraparë që organizatat ndërkombëtare të kenë rol përkrahës gjatë krijimit të strukturave për luftë kundër tregtisë me njerëz. Megjithatë falë vazhdimit/zgjatjes/ së pjesëmarrjes së qeverisë në aktivitetet kundër tregtisë me njerëz dhe nevojës së menjëhershme për zhvillimin e aktiviteteve konkrete, në veçanti për preventivën ndaj tregtisë me njerëz dhe ndihmën për viktimat, organizatat ndërkombëtare drejtpërdrejtë ndërhyjnë jo vetëm në përkrahjen, por edhe në implementimin e projekteve kundër tregtisë me njerëz, shpeshherë në bashkëpunim me OJQ-të vendore.

IOM-i

IOM e ka të zhvilluar mirë sistemin për ndihmë i cili është i vendosur në të gjitha vendet e rajonit i cili shërben për ndihmë për viktimat e tregtisë me njerëz, shtetas të huaj që duan të kthehen në vendet e tyre amë. Programet e tyre për ndihmë mbështeteten në IOM dhe agjencitë e tjera qeveritare (rëndom Ministria e Punëve të Brendshme) të cilat janë të themeluara për sigurimin e ndihmës së parë e cila deri atëherë mungonte.

Prej kur filloi të punojë IOM-i në çështjen e tregtisë me njerëz në rajon, disa nga aktivitetet e tij u janë dorëzuar agjencieve qeveritare apo u janë ofruar disa OJQ-ve lokale. Megjithatë, dorëzimi i aktiviteteve të IOM ecë shumë ngadalë dhe rezulton me atmosferë të rrijtjes së konkurrencës dhe frustrimit të partnerët lokal. Një pjesë e madhe e frustrimit ka të bëjë me faktin se mjetet ndërkombëtare shkojnë te organizatat ndërkombëtare për implementimin e aktiviteteve për të cilat

duhet të jenë përgjegjës aktorët (qeveritarë dhe joqeveritarë) vendorë të cilët duhet të kenë kapacitetet të mjaftueshëm që t'i implementojnë sipas PNA-së.

Roli i IOM-it në zhvillimin e strukturave të qëndrueshme lokale për menaxhim me tregtinë me njerëz, edhe më mbetet i paqartë.

Kapacitetet lokale shpejherë janë mjaft të dobëta dhe atyre u nevojitet përkrahje në aspektin e ekspertizës teknike dhe burimeve financiare. Roli kryesor i të gjitha organizatave ndërkombëtare duhet të jetë promovimi i ndërtimit të kapaciteteve të strukturave lokale dhe qëndrueshmërisë së projekteve. OJQ-të nuk duhet të formojnë projekte të reja dhe të shtrenjta, por duhet të fokusohen në dorëzimin e nismave lokale egzistuese agjencive vendore dhe në përkrahjen dhe zhvillimin e kapaciteteve lokale dhe nismave lokale.

Programi i IOM-it për njerëzit që duan të kthehen në vendet e tyre është i vlefshëm dhe ata duhet të vazhdojnë me sigurimin e shërbimeve të tilla. Megjithatë, IOM-i duhet të ketë qëndrim të qartë lidhur me të drejtat e njeriut në aktivitetet e veta, përfshirë këtu edhe standardet për trajtimin e njerëzve që marrin ndihmë dhe standardet e bashkëpunimit me agjencitë qeveritare dhe joqeveritare.

Modele alternative të ndihmës dhe nismat për ndihmë për viktimat e tjera të tregtisë me njerëz - për shembull - për njerëzit me të cilët tregtohet brenda, për fëmijët, për viktimat që nuk duan të kthehen menjëherë në shtëpi apo që kërkojnë mundësi të tjera – duhet të zhvillohen dhe të implementohen nga agjencitë lokale.³⁸⁵

UNHCR, UNICEF dhe OSBE/ ODIHR

Organizatat e tjera ndërkombëtare, përveç IOM-it, rallë herë janë të inkuadruara në implementimin e projekteve kundër tregtisë me njerëz. Ato megjithatë promovojnë standarde të të drejtave të njeriut, ofrojnë ndihmë për avancimin e ligjeve për luftë kundër tregtisë me njerëz, sigurojnë të dhëna për qeveritë, ofrojnë përkrahje për strukturat lokale për luftë kundër tregtisë me njerëz dhe sigurojnë këmbim të të dhënave në nivel rajonal dhe ndërkombëtar. Agjencitë e tjera sigurojnë ndihmë teknike dhe financiare për qeveritë dhe OJQ-të lokale.

Viteve të fundit UNCHR-ja, UNICEF-i dhe OSBE-ja ishin shumë aktive në përkrahjen e luftës kundër tregtisë me njerëz. UNHCR-ja i përgatiti orientimet e para për të drejtat e njeriut të rekomandimeve të KB-së për tregtinë me njerëz që duhet të përdoren në terren dhe për zhvillimin e standardeve për nismat aktuale apo të sapoformuara.

UNICEF-i përgatiti një dokument revolucionar për procedurat standarde të domosdoshme për ndihmën e fëmijëve viktimat të tregtisë me njerëz. OSBE-ja e përkrahu reformën ligjore dhe e vëzhgonte ndjekjen gjyqësore kundër tregtarëve dhe gjatë saj bënte ekspertizë për implementimin e ligdhënies kundër tregtisë me njerëz. OSBE/ODIHR-ja zhvilloi model të mekanizmit nacional për riorientim. Të gjitha këto organizata marrin pjesë në punën e komitetetve nacionale dhe ofrojnë ndihmë për strukturat vendore për implementimin e PNA-së.

Megjithatë, derisa organizatat ndërkombëtare janë të inkuadruara në luftën kundër tregtisë me njerëz në EJT, të gjitha këto agjenci do të duhet në mënyrë më të drejtpërdrejtë të marrin pjesë në përkrahjen e aktiviteteve në terren dhe në angazhimin e tyre për përdorimin e standardeve të të drejtave të njeriut me qëllim që të lënë përshtypje të vërtetë. Propozimet e tyre nuk janë shqyrtuar nga struktura relevante qeveritare apo nga organizatat tjera ndërkombëtare dhe OJQ-të. Ata duhet të veprojnë në mënyrë më të përkushtuara dhe të gjithanshme që të sigurojnë implementim të standardeve dhe modeleve të propozuara në bazë të parimeve të të drejtave të njeriut..

Rekomandimet

Organizatat ndërkombëtare duhet:

- Të vazhdojnë me përkrahjen e zhvillimit të strukturave kundër tregtisë me njerëz dhe implementimin e PNA-së;
- Të hartojnë strategji për përmbylljen dhe implementimin faktik të aktiviteteve të agjencive lokale ;
- Të sigurojnë përkrahje për ndërtimin e kapaciteteve të OJQ-ve duke siguruar ekspertizë teknike, stërvitje dhe ushqim;
- Të bëjnë vëzhgim dhe evaluim të ëktiviteteve për luftën kundër tregtisë me njerëz nga perspektiva e të drejtave të njeriut;

³⁸⁵ Shih: Programi rajonal i IOM-it për luftë kundër tregtisë me njerëz në Ballkanin Perëndimor, Raporti i SIDA-s, korrik, 2003, fq. 115-117.

- Të sigurojnë përkrahje për zhvillimin e strukturave lokale dhe promovimin e standardeve të të drejtave të njeriut në luftën kundër tregtisë me njerëz dhe
- Të zhvillojnë dhe promovojnë procedura standarde operative të bazuara në të drejtat e njeriut.

Pjesëmarrja e OJQ-ve në PNA

Roli i OJQ në implementimin e PNA-së është çështje komplekse. Njëra nga mbeturinat e sistemit të vjetër politik është edhe mosarritja e mirëkuptimit për rolin që e luan shoqëria civile dhe OJQ-të në shoqërinë civile. Kjo e rëndon pozitën e tyre në sistemin e ri demokratik të reformuar.

Qeveritë nuk ju besojnë OJQ-ve si partnere në menaxhimin me problemet sociale dhe pa vullnet u ndihmjnë gjatë punës apo bashkëpunojnë me to si partnerë të implementimit.

Megjithatë OJQ-të ishin të parat që filluan me programe kundër tregtisë me njerëz në rajon. Puna e tyre karakterizohet me inkuadrim të thellë, efektivitet dhe shkathtësi për të zhvilluar nisma në terren të cilat janë relevante për nevojat vendore. Puna e OJQ-ve është e vlefshme jo vetëm në fushën e përkrahjes së drejtpërdrejtë për viktimat e tregtisë me njerëz, por edhe për mbledhjen e të dhënave, kryerjen e hetimeve dhe zhvillimin e standardeve, procedurave, modeleve dhe kontakteve. IOM-i ishte organizata e parë ndërkombëtare e cila e vërejti këtë karakteristikë, ashtu që në bashkëpunim të ngushtë me partnerë lokal u formuan edhe programet e para.

Megjithatë, edhe krahas ekspertizës së tyre, përvojës dhe mirënjohjes së lartë që e ka puna e tyre, OJQ-të shpeshherë nuk ishin të përfshira në grupet që i krijon PNA-ja dhe në këtë moment nuk marin pjesë në nivel të barabartë me partnerët e tjerë në komitetet nacionale. Roli i OJQ-ve është i kufizuar në implementimin e projekteve të tyre të vogla apo të atyre që janë rregulluar nga IOM-i dhe që janë të financuara nga organizatat e huaja ndërkombëtare.

Për paradoks, zhvillimi gjatë vitit të kaluar - inkuadrimi më i madh qeveritarë në aktivitetet kundër tregtisë me njerëz, bashkëpunimi më i afërt me IOM-in dhe rritja e pjesëmarrjes me mjete për përkrahjen e nismave kundër tregtisë me njerëz - rezulton me zvogëlimin e rolit të OJQ-ve. Shumë organizata të cilat disa vite kanë marrë pjesë me projekte kundër tregtisë me njerëz ma nuk janë angazhuar më, disa të tjera i kanë zvogëluar programet e tyre apo nuk hartojnë projekte të reja, ndërkaq të tjerat në pamundësi që të sigurojnë mjete për vetëfinansim shërbejnë si organizata që implementojnë projekte të IOM-it.

Numri i projekteve për preventivë që janë implementuar nga OJQ-të zvogëlohet dhe shumë aktivitete lokale e kanë humbur interesimin.

Numri më i madh i OJQ-ve në rajon që janë të inkuadruara në luftën kundër tregtisë me njerëz janë të pakta, të pazhvilluara dhe të dobëta si në aspektin organizativ, ashtu edhe në atë financiar. Edhe pse karakteri tyre në nivelin themelorë është në përparësi të madhe, në veçanti për projektet që janë të lidhura me bashkësitë lokale, dobësitë e tyre janë se ato nuk mund të implementojnë projekte të mëdha dhe të garojnë me organizata ndërkombëtare, kryesisht IOM-in për donacione apo për vëmendjen e qeverive.

Pozitive është ajo se OJQ-të kanë filluar t'i shënojnë dobësitë e tyre dhe përpiqen ta ndryshojnë mënyrën e punës. Në disa vende, siç janë: Kroacia, BH-ja dhe Rumania, OJQ zhvillojnë rrjet për koordinimin e aktiviteteve kundër tregtisë me njerëz. Po ashtu ka edhe nisma për formimin e rjetit të ri rajonal të OJQ-ve që punon në luftën kundër tregtisë me njerëz - Rjeti për luftë kundër tregtisë me njerëz (@ NET) Zyrat e La Strada-s në EJK sigurojnë përkrahje për ndërtimin e kapaciteteve dhe zhvillimin organizativ të OJQ-ve.

Pjesëmarrja e OJQ është e domosdoshme për sistemin e aktiviteteve për luftën kundër tregtisë me njerëz, e cila funksionon mirë, sidomos në nivel lokal dhe në fushën e ndihmës për viktimat dhe preventivën e tregtisë me njerëz. Vetëm bashkëpunimi me OJQ-të mund të sigurojë sukses për PNA-në, sepse ato bashkësisë vendore i ofrojnë qasje që është mirë e zhvilluar dhe e fokusuar në interesin e klientëve të saj, qasje inovative, efikasitet financiar, kontaktet mes vendeve dërguese dhe pranuese, si dhe respektim të standardeve dhe të drejtave të njeriut. Në planin afatgjatë, pjesëmarrja e OJQ-ve garanton qëndrueshmëri dhe vazhdimësi në punën kundër tregtisë me njerëz në rajon, e cila pason nga tërheqja e domosdoshme e organizatave ndërkombëtare. Nga perspektiva më e gjerë politike, pjesëmarrja e tyre është e domosdoshme për zhvillimin e strukturave dhe mekanizmave demokratikë vendorë.

Rekomandimet

OJQ-të duhet:

- Të themelojnë marrëdhënie pune me agjencitë qeveritare të përfshira në implementimin e PNA ;

- Të gjejnë zgjidhje alternative për problemet e tregtisë me njerëz, në veçanti në lëmin e ndihmës për viktimat dhe preventivën ndaj tregtisë me njerëz.

Qeveritë duhet:

- Të krijojnë marrëdhënie pune me OJQ-të;
- Të sigurojnë pjesëmarrje të OJQ-ve në Komitetet nacionale për luftën kundër tregtisë me njerëz ;
- Të përfshijnë ndërtim të kapaciteteve të OJQ-ve në PNA.

Organizatat ndërkombëtare duhet:

- Të sigurojnë përkrahje për OJQ-të, bashkëpunim ndërkombëtarë dhe projekte të përbashkëta ndërmjet vendeve dërguese dhe pranuese.

2. Reformat ligjdhënëse dhe ndjekja gjyqësore

Reformat ligjdhënëse, përfshirë edhe dispozitat për luftën kundër tregtisë me njerëz, ishin të inicuar me nënshkrimin e Protokollit të Palermos për tregtinë me njerëz³⁸⁶ dhe Deklaratën e Palermos kundër tregtisë me njerëz për EJJ³⁸⁷ nga ana e të gjitha vendeve të rajonit. Qeveritë e EJJ-së janë pajtuar t'i harmonizojnë ligjet penale vendore për inkuadrimitin e dispozitave për tregtinë me njerëz në bazë të definicionit të Palermos për tregtinë me njerëz dhe të hartojnë ligjdhënie kundër tregtisë me njerëz, e cila do të siguronte jo vetëm ndjekje për tregtarët, por edhe ndihmë për viktimat e tregtisë me njerëz.³⁸⁸ Edhe pse reformat ligjdhënëse janë në rrjedhë apo kanë përfunduar, thuajse në të gjitha vendet e rajonit ekzistojnë disa probleme lidhur me implementimin dhe funksionimin e ligjeve të reja.

Në disa vende, si BH-ja dhe Serbia, ligjdhënia e re nuk përputhet tërësisht me Protokollin e Palermos për tregtinë me njerëz. Edhe pse ligjdhënësit janë orvatur të shërbehen me Protokollin e Palermos duke e përdorë si kornizë për ligjet e reja, ata nuk ishin çdoherë të suksesshëm, sepse definicioni i tregtisë me njerëz në Protokollin e Palermos u tregua si i vështirë për t'u interpretuar.

Përveç kësaj, nenet e reja kundër tregtisë me njerëz, që janë përfshirë në ligjet penale të vendeve të EJJ-së, shpesh janë të paqarta. Gjykatësit dhe prokurorët shpesh thonë se nuk e kuptojnë ligjin e ri, se nenet për tregtinë me njerëz nuk korrespondojnë me pjesën tjetër të ligjit penal apo se ligji i ri nuk korrespondon me sistemin tjetër ligjdhënës të shtetit, siç është rasti me Serbinë dhe Rumaninë..

Ligjet e reja llogariten si mjaft të komplikuar. Patjetër duhet të tubohet shumë material dëshmues për të pasur gjykim efektiv, për ç'arsye prokurorët shpeshherë nuk mund t'i fillojnë procedurat juridike kundër tregtarëve me njerëz. Të gjitha këto probleme me ligjet e reja nënkuptojnë se tregtarët ende gjykojnë sipas ligjeve të vjetra për vepra të tjera penale, përveç tregtisë me njerëz, siç është përdorimi i prostitucionit, ndërmjetësimi në prostitucion dhe, në disa raste, për marrëdhënie robërie apo të kontrabandës me emigrantë

Ligjet të reja për tregtinë me njerëz kanë sjellë deri te disa kthesa të papritura të cilat nuk janë përherë të lidhura mirë me kornizën e re ligjore:

- Protokollin e Palermos për tregtinë jolegale dhe definicionin e tij për tregtinë me njerëz është parë me sy kritik që të mund të përdoret për reforma në ligjdhënie dhe për inkuadrimitin e dispozitave ligjore
- Ligjdhënësit, të cilët i shqyrtojnë mjetet për ndjekje gjyqësore të tregtarëve, e kuptuan se paditë e tjera ndoshta duhej të ngrihen kundër kryerësve, sidomos në rastet kur nuk është e mundur të mblidhen fakte të mjaftueshme që të vërtetohet rasti i tregtisë me njerëz;
- Në disa vende nenet për tregtinë me njerëz i akuzojnë edhe klientët e viktimave të tregtisë me njerëz;
- Fakti se viktimat mirën si dëshmitarë potencial, hap diskutime edhe për sigurimin e viktimave dhe mbrojtjen e dëshmitarëve ;
- Gjithnjë e më shumë nënkuptohet se agjencitë për siguri publike dhe gjykatat patjetër duhet të bashkëpunojnë me trupat e tjerë qeveritarë dhe joqeveritarë, në veçanti në lëmin e ndihmës së fëmijëve viktimat të tregtisë me njerëz;
- Puna e policisë duhet t'i bashkangjitet mbarë sistemit të riorientimit dhe ndihmës për viktimat ; dhe

³⁸⁶ Protokollin për tregtinë me njerëz mund të gjendet në: www.unodc.org/unodc/en/trafficking_protocol.html

³⁸⁷ Deklarata mund të gjendet në: www.osce.org/attf/attf_pd.pdf

³⁸⁸ Për më tepër të dhëna për reformat juridike, shih projektin Lara të CoE: www.CoE.int/T/I/legal_affairs/legal_co-eration/combating_economic_crime/project_LARA/

- Ndjekja e tregtarëve në masë të madhe varet nga gatishmëria e dëshmitarëve që të dëshmojnë, gjë që drejtpërdrejtë varet nga sigurimi i mbrojtjes dhe ndihmës për viktimat.

Gjatë implementimit praktik të ligjeve të reja për tregtinë me njerëz, bëhet e qartë se puna e kryer e lligjdhënies së re në fushat e tjera që nuk janë drejtpërdrejtë të lidhura me tregtinë me njerëz, është thelbësore për të pasur gjykim të drejtë. Këtu janë përfshirë:

- Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve;
- Sistemi i të drejtave të të miturve;
- Standardet për kapacitetet e shërbimeve sociale lokale për sigurimin e ndihmës për viktimat;
- Sistemi për mbrojtjen e fëmijëve dhe procedurat standarde për punën me fëmijë, përfshirë edhe strehimoret e veçanta, procedurat për tutori, alternativat për institucionalizim/kthimi i fëmijëve në familje kur kjo është kundër interesit të të fëmijës;
- Ligji kundër diskriminimit në aspekt të grave dhe pakicave;
- Regullimi i tregut të punës; dhe
- Ligjin për emigrim dhe të huaj.

Që korniza juridike lidhur me çështjen e tregtisë me njerëz të mund të regullohet në mënyrë adekuate, është me rëndësi qenësore që të drejtat e njeriut të atyre që janë tregtuar të identifikohen dhe të mbrohen.

Rekomandimet

Në procesin e reformave juridike, qeveritë duhet :

- Ta inkuadrojnë veprën penale tregti me njerëz në ligjet penale dhe ligjet e procedurës penale ;
- Të sigurojnë lligjdhënie gjithpërfhërëse të mbështetur në të drejtat e njeriut, që të sigurojnë ndihmë për viktimat e dhunës, gjë që nuk duhet të varet nga bashkëpunimi i viktimave me agjencitë e sigurimit publik apo nga pëlqimi i tyre / mundësia që të dëshmojnë kundër tregtarëve;
- Të sigurojnë implementimin e ligjeve të reja kundër tregtisë me njerëz, të cilat përfshijnë drejtime, stërvitje dhe të dhëna për agjencitë e sigurimit publik dhe gjyqet;
- Të japin pasqyrë për reforma në të gjithë lëmenjtë relevante të ligjit kundër tregtisë me njerëz, mbrojtjes së dëshmitarëve, punës, të huajve etj;
- Të bëjnë vëzhgimin dhe evaluimin e sistemit ekzistues që ashtu të sigurojnë implementim adekuat të ligjit të ri, përfshirë këtu edhe zbatimin e standardeve për të drejtat e njeriut;
- Të zhvillojnë standarde dhe procedurë konform lligjdhënies vendore dhe standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut për bashkëpunim me sigurimin publik, gjyqësinë dhe OJQ-të, në veçanti në lëmin e identifikimit dhe ndihmës për viktimat;
- Të sigurojnë ndihmë juridike dhe pjesëmarrje për viktimat e tregtisë me njerëz;
- Ta identifikojnë apo çrënjosin qasjen apo pjesëmarrjen e sektorit publik në tregtinë me njerëz.

3. Ndihma për viktimat

Identifikimi

Shifrat për identifikim dhe ndihmë për viktimat e tregtuara në vitin 2002, si dhe rezultatet nga Operacioni Mirazh tregojnë se edhe krahas vështirësive dhe stërvitjeve, polici akoma nuk mund ta identifikojë shumicën e viktimave. Shumë ekspertë, si dhe ata që janë të përfshirë në luftën kundër tregtisë me njerëz, mendojnë se në vend që policia të ngarkohet me detyra kundër tregtisë me njerëz për të cilat nuk janë të përgatitur/që nuk duan t'i kryejnë, qasja për identifikimin e viktimave duhet të ndryshojë. Policija nuk duhet të jetë agjenci e vetme përgjegjëse për identifikimin e viktimave të tregtisë me njerëz. Organizatat e tjera të cilave njerëzit që do t'u ofrohen dhe që do të mund t'u besojnë më tepër, duhet t' qasen viktimave potenciale, t'i identifikojnë dhe t'u ofrojnë ndihmë.

Disa shtetë tashmë i kanë shqyrtuar qasjet e reja drejt identifikimit:

- Në disa vende ku funksionojnë linjat e drejtpërdrejta, disa informacione vijnë përmes këtyre linjave. Për shembull, në Mal të Zi 30% e informacioneve vijnë nga linjat e “nxehta”
- La Strada e Moldavisë ka sistem të organizuar mirë të bashkëpunimit me agjencitë e sigurimit publik në shumë vende dhe mund të jetë shpëtim për shumë gra;
- La Strada inkuadron edhe shumë ambasada në punën kundër tregtisë me njerëz;
- Fushatat drejtuar klientëve kanë pasur rezultat në IJRM të Maqedonisë;

- Në Serbi ka sistem të riorientimit që është i mbështetur në ekipe mobile, të përbëra nga punëtorë social, policë dhe përfaqësues të OJQ, të cilat i identifikojnë dhe i përcjellin gratë e tregtuara;
- Udhëzimet e përkohshme për BH-në, që janë të mbështetura në standardet për të drejtat e njeriut, e hartojnë qartë obligimin e policisë që t'i informojë OJQ-të vendore për të gjitha viktimat potenciale të tregtisë me njerëz dhe të bashkëpunojë me to;
- Obligime të ngjashme të policisë për bashkëpunim me OJQ-të ka edhe në Shqipëri, Mal të Zi dhe Kosovë, gjithë kjo si rezultat i memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet policisë dhe OJQ-ve vendore; dhe
- EUPM-ja e ndryshoi mënyrën me të cilën policia në BH e kupton rolin dhe obligimet e saj. Ata tentojnë të inkuadrojnë mënyrë hetimore të kryerjes së punës, e cila mbështetet më shumë në mbledhjen e të dhënave dhe fakteve kundër tregtarëve, sesa në bastisje masive, të përgatitura dobët, të cilat të drejtuar kundër viktimave potenciale të tregtisë me njerëz.

Pa i marrë parasysh këta shembuj, megjithatë modeli kryesorë i identifikimit vazhdon të jetë ai i vlerësimit preliminar policorë, pa ndjekur standarde apo procedura të qarta. Ai vendos në mënyrë shumë arbitrare për atë se kush është viktimë e tregtisë me njerëz.

Rekomandimet për identifikim

Qeveritë, në bashkëpunim me OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare duhet :

- Të hartojnë rregulla dhe standarde të qarta për identifikimin e të gjitha viktimave, duke përfshirë edhe:
 - Identifikimin e grave dhe fëmijëve me të cilat tregtohet brenda, si dhe gratë e huaja të cilat duan të kthehen në vendet e tyre;
 - Gjetja e mënyrave dhe metodave të reja të identifikimit, përmes linjave të nxehta, fushatave preventive, bashkëpunimi me punëtorët seksualë dhe klientët e tyre, aktivitet ky që realizohet në bashkëpunim me ambasadat ;
- Të sigurohet se identifikimi është pjesë e sistemit gjithpërfshirës të riorientimit, në të cilin janë përfshirë agjenci të ndryshme për ndihmë të viktimave; dhe
- Të bëhet inuadrimi i kryerjes së punës së policisë në formë hetimesh, e cila fokusohet në mbledhjen e fakteve kundër tregtarëve, përgatitjen e rasteve dhe organizimin e aksioneve të drejtuar kryesisht kah burgosja e tregtarëve.

Ndihma

Gjykuar sipas numrit viktimave nga tregtia me njerëz, krijohet përshtypje se agjencitë ndihmëse janë gjithnjë e më pak efikase në gjetjen e viktimave në vitin 2002/2003. Rënia e numrit të rasteve nuk është vetëm rezultat i problemit të identifikimit, por edhe i ndihmës së kufizuar, sepse shumë gra dhe fëmijë më të cilët tregtohet nuk duan të pranojnë ndihmë sipas kushteve që ajo u ofrohet.

Njerëzit që punojnë në strehimore, vërtetojnë se zakonisht gratë dhe fëmijët që kthehen, nuk duan të njihen si viktimë të tregtisë me njerëz. Ata shpesh nuk e pranojnë ndihmën e IOM-it, sepse besojnë se kthimi i tyre në atdhe nga IOM-i do të rezultojë me atë që ata do të konsiderohen si prostitute.³⁸⁹ Gratë nga EJL-ja të cilat marin përkrahje nga OJQ-të në Evropën Perëndimore, shpesh vendosin të kthehen vetë dhe e refuzojnë ndihmën që u takon, sepse frikohen se prapë do të njihen. Tri çështjet kryesore të viktimave të tregtisë me njerëz të cilat kthehen, janë: besueshmëria, siguria dhe ndihma afatgjate psikologjike dhe ekonomike. Këto forma të përkujdesjes rrallë plotësohen nga organizatat për ndihmë. Marrë në përgjithësi, ka dy sisteme paralele për ndihmën në rajon: njëri nga IOM-i dhe tjetri nga OJQ-të lokale. Ka pak programe nga OJQ-të edhe krahas faktit se ato shpeshherë më mirë i plotësojnë nevojat e viktimave dhe janë më të lirë se ato të organizatave ndërkombëtare. Në vend të afrimit dhe bashkangjtitjes, këto dy sisteme duket se largohen gjithnjë e më tepër. Zhvillohen më pak kontakte dhe projekte të përbashkëta dhe ka më pak gatishmëri për të bashkëpunuar ndërmjet IOM-it dhe OJQ-ve.³⁹⁰ Në disa vende, IOM vendos t'i drejtojë strehimoret vetë, ndërsa në raste të tjera, IOM-i bashkëpunon me ndonjërin nga OJQ-të lokale. Megjithatë, sipas OJQ-ve, ky bashkëpunim zakonisht paraqet

³⁸⁹ Krahasoje me Numëruesin rajonal të IOM-it – Programi për tregtinë me njerëz në Ballkanin Perëndimor, raport i SIDA-s, korrik, 2003, fq.20-21, 104.

³⁹⁰ Shih faqen 69.

angazhim me aktivitetet e kufizuara nga ana e OJQ-ve lokale dhe shfrytëzimin e krahut të lirë lokal të punës, në vend të përkrahjes për projektet lokale të OJQ-ve dhe zhvillimin e kapaciteteve.³⁹¹

Ata që punojnë me viktimat shpesh ballafaqohen me situata të papritura, harxhime dhe ndryshime të programeve. Te ata shpesh duhet të ndryshohet rutina dhe shpesh duhet të bëhet qasje inventive dhe fleksibilitet. Megjithatë edhe pse fleksibiliteti, mendimi inovativ dhe gatishmëria për të punuar janë aspekti më i fuqishëm i aktiviteteve të OJQ-ve, prapë bashkëpunimi i tyre i kufizuar me IOM-in shpesh për ta e bën të pamundur shfrytëzimin e këtyre forcave.

Kjo është edhe më tepër e theksuar kur shumica e OJQ-ve lokale nuk kanë burime për të bashkëpunuar me IOM-in në bazë të angazhimit për të cilin janë marrë vesh. OJQ-të rëndom nuk kanë mjete që më parë t'i paguajnë shërbimet për viktimat nga dhuna. Ndjenja e fuqishme e tyre dhe përvoja për të punuar me shumë pak buxhet, që rezulton me kompensimin e disa shpenzimeve të OJQ-së, edhe pse kushtet për një bashkëpunim të tillë nuk lejojnë ndërtim të kapaciteteve, zhvillim organizativ apo ndryshime pozitive të programeve. Si rezultat i kësaj, disa OJQ tërhiqen nga puna kundër tregtisë me njerëz për shkak të mungesës së ndihmës, humbjes së interesit dhe, në disa raste, situatat e rivalitetit me IOM-in. Ekziston një ndjenjë e fuqishme në OJQ se IOM-i vepron më tepër si rival sesa si organizatë ndërkombëtare. Për shembull, në konfliktin e interesave në situatën Bullgari, ku La Strada dhe IOM-i kanë shumë raporte të largëta, gjë që ka rezultuar me mungesë të ndihmës financiare për ato gra me të cilat tregtohet, kthimin e të cilave në Bullgari e organizon La Strada.

La Strada si rjet, vërteton se të mirën dhe interesin e viktimave e vendos mbi të gjitha obligimet tjera. Besueshmëria dhe siguria janë përparësitë kryesore të programit të tyre për ndihmë. La Strada - Bullgari, përgatit plan sigurie³⁹² me çdo viktimitë të cilës i ndihmojnë të bëhet vlerësimi i të gjitha reziqeve dhe vështërsive me të cilat mund të ballafaqohet gruaja pas kthimit dhe lista e të gjitha zgjidhjeve të mundshme. Njëri nga rreziqet kryesore është po qe se femra, nga familja dhe miqtë (të rreziku nga njollosja) apo nga policia (të futet në bazën e të dhënave policore), diktohet se ka qenë viktimitë e tregtisë me njerëz. Ofrimi i të dhënave për policinë gjithashtu mund të jete i rrezikshëm, në veçanti nëse ka mundësi të ketë reperkusione nga tregtarët. Gratë shpesh vendosin të mos flasin me policinë, vendim ky i pranueshëm për kuadrin e La Stradas. Viktimave që u ndihmojnë OJQ-të shumë shpesh nuk bashkëpunojnë me policinë me qëllim që kështu ta sigurojnë veten.

Gtdi të gjitha gratë që marrin pjesë në programet e IOM flasin së pari me policinë. Edhe pse këmbimi i të dhënave me policinë bëhet vullnetarisht dhe shpeshherë është e domosdoshme që për gjykim të drejtë të tregtarëve me njerëz patjetër të pyetemi se a është ajo në interesin më të mirë të viktimave. Pëlqimi për t'i ofruar informacione policisë a është rezultat i pëlqimit për informacione? A janë gratë të informuara mirë për të drejtat e tyre, për mosekzistimin e mbrojtjes së deshmitarëve dhe për pasojat e mundshme nga dëshmia? A është përparësi e programit të IOM-it mbrojtja e interesave të viktimave apo e interesave të agjencive për siguri publike?

Edhe krahas këtyre hamendjeve, ka shumë ndryshime pozitive në programet e IOM-it gjatë vitit të kaluar.

- Programet bëhen gjithnjë më të mëdha dhe ofrojnë kushte më të mira;
- Gjinden mjete të mjaftueshme financiare për ndihmë për viktimat e riorientuar;
- IOM-i ka filluar t'i njohë dhe t'i ndihmojë viktimat e tregtisë me njerëz të brendshëm, drejtpërdrejt apo përmes dhënies së përkrahjes financiare për OJQ-të të cilat punojnë me gratë me të cilat tregtohet brenda; është e njohur situata speciale me fëmijët me të cilët tregtohet, edhe pse rëndom nuk ka programe speciale apo ndihmë; vajzat nën 18 vjeç shpesh janë të identifikuar dhe marin ndihmë si viktima të tregtisë me njerëz;
- Programet për ndihmë sociale dhe psikologjike janë më mirë se më parë të disanjuara për përmbushjen e nevojave të grave; dhe
- Nevoja për programe për integrim dhe ndihmë afatgjate për viktimat është pranuar.

Para agjencive për ndihmë në veçanti para IOM-it, megjithatë ngelin disa sfida³⁹³

- Pamundësia e bashkëpunimit ndërmjet OJQ-ve lokale dhe bashkësive ndërkombëtare;
- Mospasja e dispozitave për ndërtimin e kapaciteteve për OJQ dhe planet për dalje në bashkësitë ndërkombëtare;

³⁹¹ Shih kapitullin për Bosnjen dhe Hercegovinën dhe kushtet për marrëveshjet me OJQ-të që janë përmendur në Qendrën rajonale për tregtinë me njerëz në IOM në Ballkanin Perëndimorë, Raport mbi SIDA n, Korik 2003, fq. 50 dhe fq. 99.

³⁹² Shih kreun për Bullgarinë, pjesa 4.2.

³⁹³ çështje të ngjajshme janë cekur në raportin mbi SIDA. Shih: Programi rajonale për luftë kundër tregtisë me njerëz e IOM në Ballkanin Perëndimorë, raport mbi SIDA n Korik 2003 faqe 110-117

- Mospasja e procedurave operative standarde të shkruara qartë për riorientim dhe strehimore, si dhe në të drejta standarde minimale për trajtim të viktimave të tregtisë me njerëz;
- Standardet e të drejtave të njeriut nuk aplikohen çdoherë në luftën kundër tregtisë me njerëz;
- Mund të ketë konflikt mes interesit më të mirë të viktimës, interesit të sigurimit publik (dëshmia) dhe politikës së emigrimit (kthimin në vendin amë);
- Programet e IOM nuk janë të vëzhguara dhe të evaluuara. Nuk ka, për shembull, statistika të sigurta për programet për riintegrim;³⁹⁴ dhe
- Edhe pse besueshmëria duhet t'i mbrojtë OJQ-të nga tregtarët, në realitet ajo i mbronë nga njohja (madje edhe nga financuesit) si institucione përgjegjëse të cilat me sukses punojnë në çështjen e tregtisë me njerëz.

Siç duket, sistemi i IOM funksionon mirë për ata që duan të kthehen në shtetet e tyre. Që duan të flasin me policinë dhe që nuk kanë të dhëna që do të mund t'i dëmtonin pas kthimit të tyre. Duket se sistemi i IOM it funksionon mirë për ata që duan të kthehen në vendet e tyre, duan të flasin me policinë dhe nuk kanë të dhëna që mund ti dëmtojnë pas kthimit të tyre (ajo mund të shpiejë deri te paragjykimi për tregtarët). Për grupet e tjera të viktimave duhet të formohen programe më të rëndomta të cilat do t'i plotësonin nevojat e tyre për besueshmëri, siguri, pëlqim të informatave zgjedhjen e opsioneve të mundëshme dhe ndihmën afatgjate. Ky lloj ndihme është inkuadruar në programet e OJQ-ve, por këtyre programeve u duhet ndihmë financiare dhe zhvillim i mëtejshëm poqese ata mbesin alternativë e mundshme.

- Zgjidhja kryesore duhet të jetë krijimi i një sistemi gjithpërfshirës i riorientimit për identifikim, ndihmë dhe riintegrim të viktimave të tregtisë me njerëz i cili do të inkuadronte forma të ndryshme të ndihmës (të ofruar nga organizata të ndryshme) që do t'i plotësojë nevojat e viktimave dhe ta ofrojë të gjithë ndihmën e mundëshme.

Rekomandimet për ndihmë

Qeverite duhet:

Të sigurojnë mbrojtje juridike për viktimat (dëshmitarët) dhe familjet e tyre.

Qeveritë, organizatat ndërkombëtare dhe OJQ duhet:

- ◆ T'i sigurojnë që të gjitha programet për identifikim dhe ndihmë të jenë të orientuara së pari për mbrojtjen e të drejtave dhe dinjitetin e viktimave, përfshirë sigurinë, besueshmërinë, pëlqim informative dhe sigurimin e ndihmës specifike afatgjate;
- ◆ Të pranojnë qasje organike të tregtisë me njerëz e cila do t'i integronte çështjet e sigurisë, preventivës dhe ndjekjes gjyqësore në bazë të orientimeve për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e fëmijëve të hartuara nga UNHCR-ja dhe UNICEF-is;
- ◆ Për të gjitha viktimat pa marrë parasysh statusin e tyre pa marrë parasysh statusin e tyre, të sigurojnë arrijtje deri te strehimoret dhe deri te ndihma (përfshirë edhe ndihmën juridike);
- ◆ Të zhvillojnë procedura të qarta operative standarde për strehimore dhe standarde minimale për stërvitje të viktimave në strehimore; dhe
- ◆ Të zhvillojnë programe gjithpërfshirëse për ndihmë për strategji dhe qëllime afatgjate (që janë të përfshirë në PNA si mekanizëm nacional për riorientim) në bazë të bashkëpunimit ndërmjet organizatave qeveritare dhe joqeveritare;

Donatorët dhe agjencitë për implementim duhet të:

- ◆ Bëjnë vëzhgim dhe evaluim të programeve për ndihmë dhe riintegrim në veçanti për rezultatet afatgjate të programeve për riintegrim.

Riintegrimi

Projektet të cilat kanë për qëllim reintegrimin e grave me të cilat është tregtuar janë pjesë kontraverse dhe e komplikuar e sistemit për ndihmë të viktimave e tregtuara. Deri vonë viktimat e tregtisë me njerëz të cilat ktheheshin në vendet e tyre amë nuk mund të llogaritin në ndihmë. Ndihma nga IOM-i ishte rëndom ishte e kufizuar në shumën për riintegrim prej 150 US \$ dhe orientim kah OJQ-të lokale për ndihmë të mëtejshme. OJQ-të lokale megjithatë ishin të papërgatitura të ofrojnë ndihmë të mirëfilltë për gratë e traumatizuara të cilave u duhej shtëpi, punësim dhe ndihmë psikologjike dhe mjekësore. Në

³⁹⁴ Jo moti programet e IOM në EJL u evakuan nga SIDA. Shih: Programi regional për luftë kundër tregtisë me njerëz të IOM në Ballkanin Perëndimorë, raport mbli SIDA n Korik 2003.

praktikë ata mund t'i ofronin vetëm disa takime me viktimën që kthehej, të cilat shpesh quhen sesione terapeutike të cilat nuk ofronin ndihmë konkrete. Mundësia e vetme që u mbetej viktimave ishte kthimi në shtëpi në gjendjen në të cilën kishin filluar në fillim dhe e cila shpesh rezultonte që me ta të jetë tregtuar që herën e parë.

Sipas të dhënave të dorëzuara nga La Strada – Bullgari dhe IOM-i – Moldavi, së paku 30% e viktimave të tregtisë me njerëz të cilët kthehen në shtetet e tyre pësojnë nga çregullime serioze biheviorale, psikike dhe mendore dhe kanë nevojë për stërvitje afatgjate psikiatrike dhe ndihmë. Ata nuk janë në gjendje që drejtpërdrejtë të integrohen në shoqëri dhe lëshohen të gjenden vetë. Po ashtu nuk ka të dhëna për atë se sa viktimat të tregtuara që kthehen janë të varura nga droga, por së paku 3% nga gratë dhe vajzat të cilat kthehen në Moldavi tregojnë shenja të keqpërdorimit të drogës dhe disa nga ato besohet se asnjëherë nuk do mund ta përmbajnë veten.

Gati të gjitha viktimat e tregtisë me njerëz pësojnë nga stresa pastraumatizuese; ata kanë mendim të ulët për veten e tyre dhe kanë nevojë për këshilla psikologjike afatgjate. Atyre po ashtu ju duhet ndihmë praktike, sidomos nëse nuk ju pëlqen të kthehen në shtëpi. Shumica nga gratë dhe vajzat nuk kanë arsimim adekuat shkathtësi apo përvojë pune që të mund të gjejnë punë pa stërvitje të mëtejme apo kthim në shkollë. Përveç asaj, së paku 30% e viktimave kanë nevojë për terapi më afatgjate dhe ndihmë para se të hyjnë në ndonjë program. Kurset afatshkurtëra për ondulim, qepje dhe gatim që u janë ofruar vajzave të traumatizuara, nuk i përgatitin ato për jetë të pavarur. Momentalisht në vendet amë organizohen programe të reja për riintegrim të cilat ofrojnë ndihmë konkrete më thelbësore, edhe pse mundësitë për gratë dhe vajzat që kthehen janë akoma shumë të kufizuara dhe janë adekuate vetëm për një numër të vogël të viktimave të tregtisë me njerëz. Po ashtu nga kjo bëhet e qartë se nuk ka zgjidhje të përsosur për problemet e këtyre grave dhe fëmijëve. Varësisht nga gjendja, nevojat dhe dëshirat e tyre, atyre duhet t'u ofrohet mundësi për stërvitje dhe integrim të cilat janë më adekuate për ta. Bile edhe kur mundësia e tyre e vetme është kthimi në shtëpi, ata nuk duhet të jenë të harrohen pas kthimit. Varësisht nga gjendja e tyre dhe situata mendore, viktimat e kthyer në shtëpi kanë nevojë për forma të ndryshme të ndihmës. Disa OJQ kanë filluar me sigurimin e ndihmës adekuate për gratë me të cilat është tregtuar:

- La Strada - Bullgari ofron terapi individuale afatgjate dhe plane individuale për siguri;
- OJQ-ja e cila punon në Rumani ka strehimore afatgjate, ku gratë mund të rinë derisa të gjejnë punë dhe derisa të mund ta mirëmbajnë veten; dhe
- Programi për fitimin e të ardhurave i konzorciumit italian « Solidarita » u jep grave mundësi për të hapur biznese personale të vogla.

Terre des Hommes dhe OJQ-të vendore në Shqipëri kanë programe për riintegrim të fëmijëve me të cilët është tregtuar. Shërbimet të cilat ofrohen në baza vullnetare, siç janë familjet që përvetësojnë dhe programet e specializuara, siç është riintegrimi social dhe akademik, shpesh konsiderohen si zona të inervenimit.

Në përgjithësi viktimave të tregtisë me njerëz u nevojiten mundësi më të mira për ndihmë, më shumë kohë për t'i hulumtuar ato mundësi dhe sistem më i mirë për riorientim në nivel lokal dhe nacional. Është shfaqur edhe nevoja për rritjen e OJQ të cilat do të bashkëpunojnë, të cilave mund t'u dërgohen disa raste të cilat në bashkëpunim me auditoritetet qeveritare gratë të mund të gjejnë punë dhe të marrin shërbime shëndetësore. Fëmijëve patjetër duhet t'u mundësohet të shkojnë në shkollë dhe të marrin përkrahje që të mund të qëndrojnë me familjet e tyre apo me familje të tjera surrogate.

Rekomandimet

Qeveritë duhet:

- ♦ Të inkuadrojnë programe/aktivitete për riintegrim në PNA dhe të sigurojnë bashkëpunim ndërmjet institucioneve qeveritare dhe joqeveritare;
- ♦ Në nismat egzistuese për grupet me mangësi të inkuadrojnë viktimat të tregtisë me njerëz (shkollimi, programet për ristërvitje, ndihmë sociale, kthim në shkollë etj); dhe
- ♦ T'u kushtojnë kujdes të veçantë programeve për riintegrim të fëmijëve. Ky duhet të jetë riintegrim familjar, kur ky është i mundur në vend të institucionalizimit.

Qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare duhet:

- ♦ T'i vëzhgojnë dhe e valorojnë programet egzistuese për riintegrim dhe efikasitet;
- ♦ T'i hulumtojnë nevojat dhe ato që i presin gratë të cilat kthehen në lëmin e riintegrimit; dhe
- ♦ T'i përkrahin OJQ-të në zhvillimin e programeve inovative për ndihmë dhe riintegrim të viktimave të tregtuara.

Fushatat për ngritjen e vetëdijes të fëmijët shpeshherë nuk janë mirë të menduara. Rekomandimet janë shumë të përgjithshme dhe më tepër i frikësojnë fëmijët sesa që u japin shkathtësi të nevojshme jetësore. Sipas hulumtimeve të UNICEF-it, fëmijët e disa vendeve kanë vërtetuar se kanë të dhëna të mjaftueshme për tregtinë me njerëz dhe mendojnë se rekomandimet vetëm përsëriten dhe janë të mërzitëshme. Njëkohësisht ata nuk i vinin të dhënat në raport me veten dhe nuk dinin si të mbrohen.³⁹⁷ Programet për preventivë ndaj tregtisë me fëmijë dhe për ndihmë të fëmijëve me të cilët është tregtuar, duhet të mbikëqyren dhe evaluohen, sepse ato i realizojnë organizatat pa kurrfarë përvoja paraprake në punën me viktimat e tregtisë me njerëz apo viktimat e dhunës.

Rekomandimet për ndihmë dhe mbrojtje të fëmijëve me të cilët është tregtuar

Qeveritë në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të duhet:

- ◆ Të bëjnë hulumtime dhe analiza të të dhënave në raport me:
 - Tregtinë e brendshme me fëmijë (vajza dhe djem) për shfrytëzim seksual dhe tregtinë e fëmijëve për lypësi;
 - Gjendja me fëmijët e grupeveqë janë nën rrezik të madh;
 - Fëmijë të pashoqëruar, emigrimi dhe tregtia me fëmijë;
 - Kërkesat e fëmijëve për punë;
- ◆ Të udhëheqin fushatë të studiuar mirë për ngritjen e vetëdijes së fëmijëve me theks të veçantë për të drejtat e fëmijëve dhe shkathtësitë jetësore;
- ◆ Të inkuadrojnë preventivën e tregtisë me njerëz në orarin shkollor dhe të ketë stërvitje për arsimtarët;
- ◆ T'i vëzhgojnë dhe evalulojnë programet ekzistuese për ndihmë të fëmijëve dhe për preventivën e tregtisë me njerëz dhe vlerësimin e aftësive të tyre profesionale;
- ◆ T'i implementojnë orientimet e UNICEF-it për të drejtat e fëmijëve viktimat të tregtisë me njerëz në EJL.

5. Ngritja e vetëdijes dhe preventiva

Egzistojnë disa fushata rjedhëse për preventivë dhe ngritje të vetëdijes për tregtinë me njerëz në të gjitha vendet e rajonit. Edhe pse ata nuk janë detalisht të përshkruara në këtë raport, disa vërejtje të përgjithshme mund të bëhen, ngase lloje të ndryshme të fushatave vijnë gati 3 apo 4 vjetë në disa vendë, ku zhvillohen me lloj-lloj rekomandimesh drejtuar grupacioneve të ndryshme.

Fushatat e zgjeruara mediale për ngritjen e vetëdijes

Organizatat ndërkombëtare planifikojnë apo bëjnë fushata të mëdha për informim dhe ngritje të vetëdijes gati në të gjitha vendet e rajonit, pa marrë parasysh se a janë vende amë, tranzitore apo cakut dhe pavarësisht nga përmasat e tregtisë me njerëz në vendet e ndryshme. Këto fushata mediale zakonisht janë në nivel shtetërorë dhe kryesisht i drejtohen opinionit publik në përgjithësi dhe me qëllim që të përfshijnë sa më tepër njerëz. Ata sigurojnë të dhëna të përgjithshme për rreziqet e tregtisë me njerëz dhe të emigrimit. Disa fushata bashkëpunojnë me linjat e nxehta të reja apo me ato që kanë qenë prej më herët, me ç'rast cak grupeve janë njerëzit që duan të arrijnë sukses përmes linjave të nxehta, viktimat e tregtisë me njerëz, viktimat potenciale, familjet e viktimave, emigrantët e mundëshëm apo njerëzit që kërkojnë punë jashtë vendit.

Nuk ka të dhëna për efikasitetin e këtyre fushatave. Parametër i rëndomtë për efikasitet është ndryshimi i vetëdijes, si rezultat i kampanjës. Edhe pse hulumtimi i mendimit publik tregon se gati të gjitha grupet qëllimore të këryre llojeve të fushatave, ishin të vetëdijshëm për tregtinë me njerëz, por nuk e kishim të qartë se si të dhënat për fushatën ndikonin në sjelljen, në vendimin për emigrim apo në ndihmën dhe mbrojtjen e njerëzve nga tregtia me njerëz.

Sipas disa OJQ-ve vendore, grupet qëllimore, kryesisht gra dhe vajza të reja, janë të lodhura apo prekura nga rekomandimet e dhëna dhe fotografitë e figurave të zhveshura të grave në zinxhirë apo forma të ngjashme të ekspozimit. Ato po ashtu theksojnë se karakteri i përgjithshëm i fushatave dhe medimeve që shfrytëzohen për demonstrimin e tyre i kufizojnë grupacionet qëllimore vetëm në ata njerëz që jetojnë në qytetet e mëdha dhe që kanë qasje në shtyp apo në televizorë apo vetëm në njerëzit të cilët tashmë dinë për këtë çështje. Edhe krahas kësaj, lloji i njejtë i rekomandimeve në fushatat e

³⁹⁷ Raporti i UNICEF: Preventiva e tregtisë me fëmijë në EJL, Hulumtimet pilot në Shqipëri, Moldavi dhe Rumani, maj 2003, fq. 54

shtrenjta mediale gradualisht përsëritet në vendet e tjera pa kurrfarë të dhënash për rezultatet e pritura apo të arritura.

Projektet e vogla për ngritjen e vetëdijes

Projektet e vogla aplikohen në nivel lokal dhe janë të orientuara ndaj grupeve të caktuara, kryesisht viktimat potenciale të tregtisë me njerëz dhe familjet e tyre. Këto aktivitete zakonisht organizohen nga OJQ-të vendore, shpesh në bashkëpunim me IOM. Qasja është më e drejtpërdrejtë dhe më saktë e drejtuar kah qëllimi; strategjia kryesore është kontakti i drejtpërdrejtë përmes mbledhjeve në shkolla, komuna dhe OJQ-të vendore, diskutime dhe ligjërrata. Rekomandimet gjithashtu janë më pak të përgjithshme dhe u drejtohen mundësive të caktuara për emigrim dhe dhunë gjinore. Qëllimi kryesor është që grupacionit të caktuar t'i jepen të dhënat e nevojshme dhe aftësitë për ta luftuar tregtinë me njerëz. Përparsi e aktivitetetve hulumtuese është që tregtia me njerëz të kthehet nga niveli abstrakt në të dhëna të dobishme për aftësitë që janë të nevojshme për t'u marrë me rreziqet e tregtisë me njerëz të cilat janë të hartuara sipas nevojave të grupacionit qëllimor të caktuar. Ky lloj i fushatës e hedh problemin nga duart e organizatave ndërkombëtare në duart e bashkësive vendore, duke u mundësuar kështu aktorëve lokal që të udhëheqin me problemet e tyre vendore.

Fushatat e vogla për ngritjen e vetëdijes janë gjithashtu shumë më të lira, edhe pse OJQ-të që i implementojnë mund të kenë më pak të dhëna dhe kuptim për problemin. Si rezultat i kësaj, njerëzit mund të dëgjojnë kërcënime dhe tregime të tmerrshme me të cilat nuk do të mund të lidhen mes vete në vend që të këmbejnë informata që do t'u ndihmonin. Nuk ka metoda të qarta për evaluim për vërtetimin e efikasitetit të kësaj metode të ngritjes së vetëdijes, edhe pse kontaktet e drejtpërdrejta me dëgjuesit lejojnë vlerësimin e efekteve dhe reagimeve ndaj rekomandimit.

Në disa vende diskutohet për inkuadrimin e të dhënave për rreziqet dhe modalitetet e tregtisë me njerëz në planin shkollor. OJQ-të vendore janë përfshirë në përgatitjen e materialeve për stërvitje të veçantë për arsimtarët dhe nxënësit. Disa nisma shërbejnë me arsimimin për të drejtat e njeriut dhe shkathtësitë jetësore që fëmijët do t'i mësojnë për tregtinë me njerëz.

Preventiva përballë ngritjes së vetëdijes

Sipas SPTF dhe disa PNA-ve, preventiva duhet të merret me çështjet rrënjësore të tregtisë me njerëz, si dhe ta ngrejë vetëdijen për tregtinë me njerëz. Megjithatë dispozitat në PNA për çrënjosjen e rasteve të tilla, zakonisht janë shumë të përgjithshme dhe nuk janë të elaboruara mirë. PNA-ve zakonisht u mungojnë afatet kohore, buxhetet dhe ndarja e qartë e detyrave dhe përgjegjësi, në veçanti në raport me aktivitetet preventive. Me qëllim të arritjes së rezultateve afatgjata dhe gjithpërfshirëse, projektet duhet të merren me lëndimet e grave dhe fëmijëve nga tregtia me njerëz, përfshirë këtu edhe dhunën, varfërinë, diskriminimin, pabarazinë dhe kërkesën për shërbime specialistike që i sigurojnë viktimat nga dhuna dhe tregtia me njerëz.

Rekomandimet

Qeveritë, organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të duhet:

- ◆ T'i vlerësojnë nevojat dhe efikasitetin e fushatave të shtrenjta dhe të mëdha për ngritjen e vetëdijes;
- ◆ Të mund t'i dallojnë fushatat në përputhje me tipin e vendit dhe grupin qëllimor;
- ◆ Të inkorporojnë të dhëna për mënyrat legale për emigrim dhe për punësimet në fushatat për ngritjen e vetëdijes në të gjitha vendet ku popullata është në rrezik;
- ◆ T'u kushtojnë vëmendje të veçantë fushatave të vogla të drejtpërdrejta që janë të drejtuara kah grupet në rrezik, në veçanti ndaj grave dhe fëmijëve;
- ◆ Të krijojnë mekanizma për evaluimin e fushatave preventive dhe për ndikimin e tyre në vetëdije;
- ◆ Të bëjnë evaluimin e materialeve, metodave dhe kapaciteteve të organizatave të cilat i udhëheqin fushatat për ngritjen e vetëdijes dhe për informim;
- ◆ T'i zbatojnë dhe t'i ndihmojnë projektet për raportin mes zhvillimit ekonomik, programeve për rikonstruksion dhe tregtinë me njerëz në EJT;
- ◆ T'i ndihmojnë projektet preventive të sëmundjes HIV te puntorët seksual, gratë me të cilat tregtohet dhe te grupet e tjera me rrezik të lartë; dhe
- ◆ Të ndihmojnë në projektet (inkuadrimin e tyre në PNA) që janë të drejtuara kah lufta kundër dhunës ndaj grave dhe fëmijëve, diskriminimin kundër grave, papunësinë, feminizimin e varfërisë dhe mospërfshirjen e grave në jetën publike.

6. Stërvitja

Ekzistojnë shumë programe për trajnim që janë në rrjedhë, të cilat kanë të bëjnë me preventivën e tregtisë me njerëz në EJK, me agjencitë e sigurimit publik, me ofruesit e shërbimeve, OJQ-të, gjykatat, funksionerët qeveritarë, grupet me rrezik të lartë dhe popullatën e rëndomtë. Numri më i madh i këtyre programeve për stërvitje janë të menduar shkëlqyeshëm dhe janë të mbështetur në të dhëna aktuale të rajonit. Njëherit i kanë parasysh edhe të gjitha njohuritë e reja. Gati të gjitha aktivitetet për stërvitje kryhen në kuadër të PNASë.

Shumë nismaa për stërvitje janë organizuar nga ekspertë lokal dhe OJQ-të vendore, kurse ndonjëherë në bashkëpunim edhe me organizatat ndërkombëtare, me çka krijohen struktura lokale të qëndrueshme për stërvitje dhe grupe vendore të stërvitësve me përvojë. Këto nisma përfshijnë edhe stërvitje për stërvitës në fushën e preventivës së tregtisë me njerëz, të cilat janë të drejtuara kah grupet e mësuesve, OJQ-ve, të rinjve etj.

Po ashtu ka nisma edhe për inkorporimin e të dhënave për tregtinë me njerëz në arsimimin formal dhe joformal, si dhe programe për stërvitje të përgjithshme për agjencitë e sigurimit publik dhe për zyrtarët qeveritarë. SPTF-ja e llogaritë si shumë të rëndësishëm harmonizimin dhe koordinimin e këtyre përpjekjeve për këmbimin e të dhënave. ICMPD-ja organizoi program gjithpërfshirës rajonal për stërvitjen e të punësuarëve në sigurimin publik dhe gjyqësi, program ky që u implementua në të gjitha vendet e rajonit përmes stërvitjes së ekipeve të përbëra nga përfaqësues të policisë vendore dhe OJQ-ve lokale. Në disa vende programi është stërvitje vetëm për përfaqësuesit e sigurimit publik, ndërsa në disa vende të tjera mendohet të bëhet stërvitjes së rregullt në lidhje me tregtinë me njerëz për sigurimin publik. Programi i ICMPD-së vlerësohet jashtëzakonisht lart, në veçanti për cilësinë e materialeve, vëmendjes që i kushtohet çështjes së pronësisë vendore dhe për shkak të bashkëpunimit të dhënë ndërmjet agjencive për sigurim publik dhe OJQ-ve.³⁹⁸

Nisma tjetër rajonale është doracaku për tregtinë me njerëz i UNDP-së për policinë vendore. Doracaku fokusohet në sigurinë dhe të mirën e viktimave dhe është i ndarë në tre pjesë: ligjdhënia rajonale dhe doracak procedural; dispozitat për ndihmë juridike dhe nevojat procedurale operative; dhe zgjedhjen e përvojës më të mirë.³⁹⁹

Rekomandimet

Qeveritë duhet:

- ◆ Të përfshijnë të dhëna për tregtinë me njerëz dhe të drejtat e viktimave në planprogramet mësimore, akademitë policore, fakultetet juridike dhe qendrat për stërvitjen e punëtorëve social;
- ◆ T'u kushtojnë vëmendje të veçantë stërvitjes në lëmin e tregtisë me fëmijë, të drejtave të fëmijëve dhe masave e veçanta për mbrojtjen e fëmijëve viktimë të tregtisë me njerëz; dhe
- ◆ Të angazhohen që programet për stërvitje të bazohen në të dhëna nga rajoni dhe të japin përkrahje për nsimën rajonale nacionale në kuadër të PNA-së.

Organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të duhet:

- ◆ T'i përshtatin programet për stërvitje ndaj nevojave lokale në nivel shtetëror dhe ta kenë parasysh zhvillimin e nismave vendore për luftë kundër tregtisë me njerëz dhe zbatueshmërinë e nismave rajonale;
- ◆ Të kujdesen që nisma për stërvitje të përmbajë të dhëna për zhvillimin e drejtimeve për identifikim, riorientim, ndihmë dhe mbrojtje të të drejtave të njerëzve me të cilët është tregtuar për zbatim nga agjencitë specifike (policia, punëtorët social, profesionistët shëndetësorë, OJQ-të etj); dhe
- ◆ Të përkujdesen për nismat rajonale për stërvitje të jenë të njohura për SPTF-në me qëllim të shmangies së dyfishimit dhe që programet për stërvitje t'i reflektojnë dhe t'i identifikojnë përparësitë e identifikuar nga PNA-ja.

Donatorët dhe organizatat ndërkombëtare duhet:

- T'i evaluojnë programet ekzistuese për stërvitje për relevancë dhe kompatibilitet me kornizën ekzistuese të aktiviteteve kundër tregtisë me njerëz.

³⁹⁸ Shih: www.icmpd.org/

³⁹⁹ Për më tepër, shih kapitullin për nismat rajonale.

LISTA E PROJEKTEVE DHE AKTIVITETEVE NË IRJ TË MAQEDONISË ⁴¹⁰

QEVERIA PROJEK TE/ Aktivitete et	Fokusimi i aktiviteve	Afatet kohore	Donator	Partner për bashkëpunim	Partner për implementim	Kontakte
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME						
Koordinimi dhe PNA-së	Sekretari shtetëror i MPB-së është emëruar koordinator i Komisionit nacional; U pranua PNA-ja për luftë kundër tregtisë me njerëz me njerëz. Komisioni shtetëror duhet të merret me reformat juridike, ndihmën për viktimat, informimin dhe bashkëpunimin.	Gjatë vitit 2002	Pa mjete të jashtme	MI, MJ, MH, MES, Prokurori publik, Policia doganore, Policia, MLSP, OBSE, IOM, TEMIS, Porta e Hapur, UNICEF, OPDAT		Zoran Filipov Shef i Kabinetit në Ministrinë e Punëve të Brendshme ZFILIPOV@moi.gov.mk
Qendra tranzitore për njerëzit e tregtuar	Qendra tranzitore dhe pranuese për emigrimin jolegal dhe gratë e tregtuara	Gjatë vitit 2001	Qeveritë e Suedisë, Norvegjisë, Holandës dhe SHBA-ve	UNICEF OSBE	MI, IOM, Për fëmijëri të lumtur, TEMIS, MBA, HOPS	Bllagoja Stojkovski Shef i Departamentit për emigrim dhe azil bstojkov@moi.gov.mk
Departamenti policor kundër krimit të organizuar dhe tregtisë me njerëz	Grupi punues i policisë speciale për luftë kundër tregtisë me njerëz me përfaqësuesit e një pjese të madhe të autoriteteve në IRJ të Maqedonisë. Pjesëmarrja në nismat rajonale të SECI-t dhe SPTF-së	Gjatë vitit 2000		OBSE ICITAP EAR, SECI IOM	MI	Goran Ristovski Shef i Departamentit për luftë kundër krimit të organizuar dhe tregtisë me njerëz . goran_n_ristovski@moi.gov.mk

⁴¹⁰ EAR, Agjencia Evropiane për Rikonstrukcion, ESE, Organizata Joqeveritare Emancipimi, Solidarizimi dhe Barazia e Grave, HOPS, OJQ Projekti për mundësi të shëndoshë; IO, Organizata ndërkombëtare; MBA, Oda e Avokatëve të Maqedonisë; ME, Ministria e Arsimit, MH, Ministria e Shëndetësisë; MI, Ministria e Punëve të Brendshme; MJ, Ministria e Drejtësisë; MLSP, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale; OSI, Instituti i shoqërisë së Hapur; MJA, Shoqata e Gjykatësve të Maqedonisë; TEMIS, Shoqata e Grave Juriste në Maqedoni.

MINISTRIA E DREJTËSISË

Reformat Juridike	Harmonizimi i ligjdhënies kundër tregtisë me njerëz (Amadamentet e Ligjit penal) me standardet ndërkomëtare dhe evropiane. Pjesëmarrja në projektin LARA të Këshillit të Evropës dhe nismat e tjera rajonale nga SPTF-ja.	Në rrjedhë	OBSE, CoE, IOM, ABA/CEELI, EAR, ECJHAT (Misioni i UE-së për Drejtësi dhe çështje amë), OPDAT	MJ, Komisioni për revizionin e ligjeve.	Tanja Kikerekova Shef i Departamenti për çështjet e qytetarët dhe të të drejtave të pakicave. Velko Vllahoviq p.n., Shkup Tel. +389 91 106 558 tkikerekova@mjustice.gov.mk
Ligjdhënia	Aktet e reja kriminale për tregtinë me njerëz të inkuadruara në Kodin penal të vitit 2002.	2002	OBSE, CoE, OPDAT, IOM, ABA/CEELI, EAR, ECJHAT	MJ, MI, MJA, PPA, TEMIS, Asociacioni i Prokurorëve Publik (PPA) Klubi i Grave Parlamentare MJA, Qendra për Stërvitje të Vazhdueshme	Sterjo Zikov Javem Obvinitel Makedonsko zdru`enie na obviniteli sterjoz@yahoo.com
Stërvitja	Implementimi i punëtorisë speciale për stërvitjen e gjykatësve dhe prokurorëve duke përdorur Doracakun për stërvitjen e gjykatësve SPTF (të botuar nga ICMPD)	Vjeshtë 2003			

MINISTRIA E PUNËS DHE POLITIKËS SOCIALE

Barazia gjinore	PNA për barazi gjinore (5/2000); Koordinatorin nacional për gjinitë është po ashtu edhe anëtar i Komisionit nacional për luftën kundër tregtisë me njerëz. Reforma legale dhe lobimi	Në rrjedhë	Projektet janë të financuara nga EU, SP, Norvegjia, OSBE, Suedia/ SIDA, SHBA	OBSE, ARC, SOROS, ABA/CEELI, Kvinna Til Kvinna (KTK), USAID, Ndihma Popullore Norvegjeze	MLSP, Unioni i Grave, Lobi i Grave Maqedonase, Klubi i Grave Parlamentare, ESE	Elena Grozdanova Shef i Departamentit të Barazisë gjinore, Pika e Fokusuar Qeveritare, Grupi punues i rregullt i Paktit të Stabilitetit Tel: +389 2 129 308 elenagr@freemail.org.mk
------------------------	--	------------	--	--	--	--

AVOKATI I POPULLIT

Rritja e vetëdijes dhe mbrojtja e të drejtave civile	Pamfleti i të drejtave të fëmijëve përmban informata për tregtinë me njerëz; Bashkëpunimi dhe organizimin e tryezave të rrumbullakta për dhunën familjare dhe abuzimin e fëmijëve në kuadër të përgatitjes së Kongresit të dytë botëror kundër eksploatimit seksual të fëmijëve;	2001 Shtator, 2003	OSBE, SOROS, ABA/CEELI, CIDA, UNICEF, EU, SIDA	MJ, MI, UNICEF, OBSE, EU, Qeveritë donatore	Advokati i popullit, OJQ OxO	Branko Naumovski Avokati i popullit Ombuds1@mt.net.mk Nevena Krusarovska Zavendësavokat i popullit ombudchild@mt.net.mk
---	--	---------------------------	--	---	------------------------------	--

Ligji i Avokatit të popullit është miratuar.

ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE

Projekti/ Aktivitete	Fokusi i aktiviteve	Afatet kohore	Donator	Partner për bashkëpunim	Partner për implementim	Kontakte
ORGANIZATA PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM NË EVROPË (OSBE)						
Reformat legale dhe stërvitja	Mbajta e punëtorive speciale për trajnim të zyrtarëve qeveritar, komunitetit legal dhe agjentëve të sigurimit publik.	Vazhdon që nga viti 1999	Shtetet anëtare	MI, MJ, MLSP, SECI, IOM, OPDAT	MJA/CCE, PPA, Porta e Hapur /La Strada,	Xheri Bjelersted Bashkëpunëtor me i vjetër për tregtinë me njerëz Geraldine.bjallerstedt@osce.org
Rritja e kapaciteteve të Organizatave Jo Qeveritare	Përforcimi i kapaciteteve të organizatave joqeveritare vendore dhe shoqatave profesionale juridike përmes granteve të projekteve të OSBE-së.					Bart Dug Shef i Njësisë për zhvillim të policisë bart.hooge@obse.org
Zhvillimi dhe stërvitja e policisë	Finacimi i Linjës SOS, linjë për viktimat e tregtisë me njerëz (informata, ndihmë dhe orientim); Sigurim të ekspertizës teknike dhe përkrahjes së Komisionit Nacional Ndërministror për luftë kundër tregtisë me njerëz, MI, MJ, Akademia policore dhe stërvitjet e tjera të specializuara për gjininë dhe tregtinë me njerëz që janë mbajtur për policë dhe kadetë policorë.			ICITAP, SOROS, SIDA, CIDA, ABA/CEELI, UNICEF, UNHCR, USAID	TEMIS, Shoqata e studentëve të Fakultetit Juridik pran Universitetit të Evropës Jug-Lindore	Biljana Lubarovska Asistente në Dep. e zbatimit të Ligjit Biljana.lubarovska@osce.org Misioni Mbikëqyrës i OSBE-së në Shkup
Koordinimi I Donatorëve	Financimi i projekteve preventive gjinore për ngritjen e vetëdijes ndaj dhunës familjare të bashkësive të romëve në vend.	2003	Departamenti i zbatimit të ligjit pranë OSBE-së.		OJQ e Romëve "ROZRP"	Ndërtesa e QBE, Shkup Tel: +389 2 3234 000 www.osce.org
ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE E EMIGRIMIT (IOM)						
Ngritja e vetëdijes	Fushata për ngritjen e vetëdijes: shpërndarja e posterave dhe pakove në 55 stacione policore në gjithë shtetin; Seminare për ngritjen e vetëdijes së avokatëve i cili është organizuar nga MBA.	Në rrjedhë 2002	Belgjika, Franca, Norvegjia, Mbretëria e Bashkuar, Italia, Suedia dhe SHBA	MI, OJQ-të vendore	IOM, Shoqëria artistike IOM, OJQ IOM, OJQ	Guglielmo Schinina Zyrtar programues gschinina@iomsko pje.org.mk

Tregtia me njerëz në Evropën Juglindore

Rritja re kapaciteteve të Organizata ve Jo Qeveritare (OJQ)	Rritja e kapacitetit të OJQ-ve vendore përmes granteve të projekteve të IOM-it; Rritja e kapacitetit të OJQ-ve vendore që punojnë nëpër Qendrat tranzitore për stërvitje; Rritja e kapaciteteve të OJQ-ve juridike për të drejtat e adoleshentëve dhe trajtimet gjyqësore.	Në rrjedhë	Norvegjia, SHBA, Italia	MI, Ambasada Frënge, Lobi i Gruas Maqedonase, MBA	IOM, MBA, Auroeola, Qendra për Aktivitete Mediale, HOPS, Semper, Forumi i Gruas Shqiptare, Phurt, Radika, Për fëmijëri të lumtur,	IOM Shkup Rr. Karcin 2A, Tel. +389 2 382 812/813 Fax + 389 2 382 811
Ndihma e drejtpërdrejtë për viktimat e tregtisë me njerëz	Ndihmë për personat e tregtuar në Qendrën pranuese dhe tranzitore për emigrant jolegal dhe për viktimat e tregtisë me njerëz që përfshijn: Shpenzime për strehim para kthimit në shtëpi, ndihmë urgjente mjekësore; Ndihmë dhe këshilla psikosociale, shëndetësore dhe juridike Marrja e artizanatëve: rrobaqepësi, ondulim, kozmetikë; Aktivitete relaksuese: jogë, terapi artistike dhe muzikë; Edukim shëndetsor dhe programe për ngritjen e vetëdijes.	Vazhdon që nga gushti i vitit 2000	Suedia, Norvegjia, Mbretëria e Bashkuar, Italia	MI, MBA	Për fëmijëri të lumtur, TEMIS, MBA, Mirë se erdhe, HOPS	Vladimir Danailov Asisten më i vjetër juridik vdanailov@iomsk opje.org.mk Marie-Astrid Huemer Bashkëpunëtor juridik mhuemer@iomsko pje.org.mk
Kthimi dhe reintergrimi i viktimave të tregtisë me njerëz	Kthimi dhe riintergrimi i viktimave në vendet e tyre amë duke u siguruar: Profilim dhe punë të rastit Sigurim të dokumenteve udhëtim Kthim të sigurt në vendin amë	Në rrjedhë	Holanda, Suedia, Norvegjia			
Stërvitja e ndërtimit të kapaciteteve institucionale dhe reformat juridike	Ekspertizat juridike dhe stërvitjet përmajne: Analiza të ligjdhënies aktuale nacionale në kuptim të Protokollit të Palermos: Rekomandimet për përparimin e Kodit penal të Maqedonisë: Seminare për Zbatimin e Ligjit për policë dhe gjyqtar. Seminare për sigurinë publike për policinë dhe gjyqkaqtësit që janë të përfshirë në tregtinë me njerëz.	Në rrjedhë	Belgjika, Franca, Norvegjia, Mbretëria e Bashkuar, Italia, Suedia, SHBA	Departamenti juridik i MI, Sektori për bashkëpunim ndërkombëtar dhe Intergrim në BE të MJ-së; Shoqata e prokurorëve publik dhe gjykatësve; Komisioni Nacional	MJ Sektori për bashkëpunim ndërkombëtar, Shoqata e prokurorëve pubikë dhe e gjykatsëve, Shërbimi Juridik i MI-së, Komisioni nacional, prokurorët pubikë, gjykatësit hetues, MBA, policia, TEMIS	
Stërvitja e policisë vendore	Ko-implementimi i stërvitjes së policisë në Akademinë policore për luftën kundër tregtisë me njerëz.	Planifikohet në fillim të vitit 2004	OSBE (Njësia për zhvillimin e policisë)			

KOMISARIATI I LARTË PËR REFUGJATË NË KOMBET E BASHKUARA (UNHCR)

Ndihma me reforma legale për refugjatë dhe ligji për azil	Ndihma me ekspertizë materiale dhe teknike në Departmentin për të huajt dhe emigrantët jolegal në MI;	Në rrjedhë	MI, IOM, MJ, OSBE, SIDA	Karolina Lindholm lindholm@unhcr.cr Tel: +389 23 118 641 Fax: +389 23 131 040
	Stërvitja për ngritjen e vetëdijes së refugjatëve dhe viktimave potenciale të tregtisë me njerëz			

FONDI I FËMIJËVE TË KOMBEVE TË BASHKUARA (UNICEF)

Linja SOS për informata dhe preventivë të tregtisë me njerëz me gra	Përkrahja e linjes lokale SOS për informim dhe ndihmë të vajzave, si dhe të grave për mbrojtjen nga tregtia me njerëz përmes sigurimit të informatave për punësim në shtetet e jashtme, informatave për rrezikun e punës në shtetet e jashtme dhe informata për gratë që janë tregtuar se ku të kërkojnë ndihmë duke luajtur rolin si ndërmjetësues në sigurimin e kontakteve me insitucionet relevante.	2002-2003		OJQ-ja vendore, Porta e hapur/ La Strada në bashkëpunim me OSBE/ Mama cash	Debora Komini Shef i Zyrës dcomini@unicef.org Barbara Roulandson Zyrtar për mbrojtjen e fëmijëve broelandson@unicef.org.mk
Ndërtimi i kapaciteteve e për implementimin e e masave specifike për mbrojtjen e fëmijëve viktima të tregtisë me njerëz	Përforcimi i kapaciteteve të autoriteteve shtetërore dhe OJQ-ve për pranimin dhe implementimin e masave speciale për mbrojtjen e fëmijëve viktima të tregtisë.	2003-2004	Varshmëria nga mundësia e fondëve	MI, MLSP, MJ	
Përmirësimi i shërbimeve për fëmijë kundër keqpërdorimit të fëmijëve Preventiva e	Rritja e kapaciteteve të pedagogëve dhe psikologëve dhe Qendrave për punë sociale për sigurimin e ndihmës psiko sociale dhe vetëdijes së keqpërdorimit, e cila do të sjellë deri te përmirësimi i mekanizmave për riorientimin ndërmjet shkollave, qendrave për punë sociale dhe OJQ-ve vendore.	2002-2003		MLSP, ME	OJQ vendore Fëmijëri e sigurt
	Ngritja e vetëdijes dhe mobilizimi social për rrezikun dhe preventivën nga HIV/SIDA/STI;	2002-2004			OJQ-ja vendore, OJQ

Tregtia me njerëz në Evropën Juglindore

HIV/SIDA, sidomos ndërmjet të rinjve të ndjeshëm puna me të rinjtë që janë të ndjeshëm dhe të ekspozuar nga rreziku i infektimit; Implementimi i këshillave dhe shërbimeve falas për testim të HIV/ SIDA; linjë për çështje shëndetësore reproduktuese me riorientim në institucionet sociale dhe shëndetësore të cilat punojnë me të rinjtë, si dhe edukimi me moshatarët jashtë shkollave.

HERA, HOPS, MIA, Teatri për të rinj i Maqedonisë, MH dhe Agjencia për të rinj dhe sport

AGJENCIA E SHBA-ve PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR (USAID) -

ZYRA E AVOKATËVE AMERIKANË, NISMA JURIDIKE E EVROPËS QENDRORE DHE LINDORE (ABA/CEELI)

Preventiva dhe reformat juridike	Programet gjinore - krijimi i ligdhënies për dhunën familjare; Stërvitja për barazinë gjinore.	Mbaroi më 30 prill 2003	USAID	MJ, MLSP	OJQ ESE (Emancipimi, solidarizimi dhe barazia për gratë)	Keti Ilievska Avokat rezident iketi@ceeli.org.mk
Ndihmë për viktimat	Ndihmë juridike për viktimat e dhunës familjare, përfshirë dhe të drejtën elementare për viktimat gjinore të dhunës familjare dhe informata për riorientimin e viktimave të tregtuara.	Financimi i ABA-CEELI mbaroi në prill 2003	USAID	Porta e hapur/ La Strada, OSBE	ESE	ABA/CEELI ceelimk@ceeli.org.mk

NISMA PËR BASHKËPUNIM NË EVROPËN JUGLINDORE (SECI) -

QENDRA RAJONALE PËR LUFTË KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR NË BUKURESHT

Bashkëpunimi rajonal dhe siguria publike	Pjesëmarrja në SPTF (Projekti MIRAZH); Stërvitje e specializuar për policinë; Marrëveshje rajonale për mbrojtjen e dëshmitarëve;	Vazhdon që nga viti 2001	Kontributi vjetor i shteteve anëtare	MI, MJ, OSBE, ODIHR	MI, Shoqata e prokurorëve publikë	Zhan Jovanovski Nëpunës për ndërlidhje zjovanovski@secicenter.org
	Këmbim i vazhdueshëm i informatave; Formimi i grupit punues rajonale operativ; Organizimi i operacioneve rajonale; Stërvitja e specializuar; Projektet e përgjithshme me IO.		Përkrahje nga shtetet mbikëqyrëse	MI, MFA- Shërbimi doganor, Prokurori publik, OSBE/ODIHR, IOM, NVO	MI, MFA Shërbimi doganor	tel. +389 23 178 188 fax: +389 2 3 176 625 Mirjana Stanoeva Nëpunës për ndërlidhje mstanoeva@secicenter.org Tel. +40 21 303 60 71 Fax. 40 21 30 360 75

DEPARTAMENTI I SHBA-ve për DREJTËSISË - ZYRA PËR ZHVILLIMIN DHE STËRVITJEN E PROKURORËVE (OPDAT)

Stërvitja dhe ndërtimi i kapaciteteve	Aktivitetet aktuale stërvitëse kundër tregtisë me njerëz dhe ndërtimi i kapaciteteve të shoqatës së prokurorëve, policisë dhe gjykatësve hetues.	Në rrjedhë	Departamenti i SHBA-ve për drejtësi	ICITAP, MJ, MI, Zyra e prokurorëve, OSBE	Shoqata e prokurorëve	Barbara Karlin Carlinbm@state.gov Kristina Karanokova
--	--	------------	-------------------------------------	--	-----------------------	--

PROGRAMI NDËRKOMBËTAR I DEPARTAMENTIT SHTETËROR TË SHBA-ve PËR HETUESINË PENALE (ICITAP)

Tregtia me njerëz në Evropën Juglindore

STËRVIT JE	Stërvitje, punëtori dhe zhvillim për policinë, prokurorët dhe gjykatësit, duke përfshirë edhe çështje të luftës kundër tregtisë me njerëz.	Në rrjedhë	Departamenti i SHBA-ve për drejtësi	OPDAT, MI, policia dhe policia kufitare, OSBE	MI	Geri Benet Program menaxher Bennetga@state.gov Tel. +389 2 32 5462
-----------------------	--	------------	-------------------------------------	---	----	---

INSTITUTI PËR SHOQËRI TË VAZHDUESHME (ISC)

Ndërtimi i kapaciteteve	Puna me OJQ-të vendore të cilat punojnë në luftën kundër tregtisë me njerëz dhe shëndetin publik.	Në rrjedhë	USAID	OSBE, MH, MLSP	Fëmijëri të lumtur, Porta e hapur, Instituti Evropo-Balkanik, Qendra Babilon, TEMIS	Pol Parks paulp@isc.org.mk Tel. +389 2 114 855 Fax: +389 2 214 132
--------------------------------	---	------------	-------	----------------	---	---

KVINNA TILL KVINNA (KtK)

Ndërtimi i kapaciteteve	Punon me OJQ-të vendore që punojnë për barazinë gjinore dhe tregtinë me njerëz; Fushatë mediale për ngritjen e vetëdijes publike	Në rrjedhë	SIDA		Porta e Hapur/ La Strada	Lotta Zakrison KerstenHedelin Ktkm@mol.com.mk Tel. +389 2 117 032
--------------------------------	--	------------	------	--	--------------------------	---

ORGANIZATAT JOQEVERITARE

Projekti/ Aktivitetet	Fokusimi i aktiviteteve	Afatet kohore	Donator	Partner për bashkëpunim	Partner për implementim	Kontakte
----------------------------------	--------------------------------	----------------------	----------------	--------------------------------	--------------------------------	-----------------

LA STRADA/ PORTA E HAPUR (OJQ vendore)

Preventiva dhe ngritja e vetëdijes	Fshatë preventive dhe ngritje e vetëdijes, duke përfshirë edhe përdorimin e posterave dhe kartelave postale për viktimat potenciale të tregtisë me njerëz;	Vazhdon	Qeverit e Holandës, Suedisë, SIDA, UNICEF, OSBE, Donator Qeveritar	OBSE, HOPS, ESE, MI, MJ, IOM, KtK	La Strada/ Porta e Hapur	Jasmina Dimishkovska- Rajkovska lastrada@on.net.mk Tel. +389 2 700 107 Fax. +389 2 700 367
SOS linja	Linja e hapur për të ndihmuar riorientimin e viktimave të tregtisë me njerëz dhe të dhënat për viktimat potenciale (për tregti, punë jashtë dhe rreziqet);					Numri i linjës SOS + 389 2 27 77 070

Ndihmë për viktimat	Mbledhja e mjeteve për strehimoren e propozuar për viktimat e tregtisë me njerëz, për gratë të cilat janë tregtuar brenda kufirit dhe për viktimat e tregtisë me njerëz të cilat kthehen në Maqedoni.
Trajnimi	Sigurimi i stërvitjeve kundër tregtisë me njerëz të grupeve të ndryshme qëllimore, autoritetet shtetërore, OJQ-të vendore etj.

Parandalimi dhe ngritja e	Fushatë preventive kundër tregtisë me njerëz, sidomos me gra dhe fëmijë të rajoneve rurale dhe shkollave të mesme, duke përfshirë edhe nismën	Shtator 2003- ISC për 7 muaj	ISC
----------------------------------	---	------------------------------------	-----

Tregtia me njerëz në Evropën Juglindore

vetëdijes për video-spotin për tregtinë e grave; Kampanjë preventive e mediave (postera, ngjitëse, broshura, pamfleta), radio spote dhe video konferenca.

Është planifikuar të vazhdojë 11 muaj

UNICEF, KtK

PROJEKTI I OJQ-së PËR MUNDËSI SHËNDETËSORE (HOPS)

HIV/SIDA dhe STI preventivat, ndihma shëndetsore dhe sociale, ngritja e vetëdijes Huluntim i Preventiva nga sëmundja HIV/ SIDA për grupet e rrezikuara, duke përfshirë punëtorët seksual dhe viktimat potenciale të tregtisë me njerëz; Zhvillimi i materialeve edukative për preventivën e HIV/ SIDA, STI dhe shëndetin riprodhues të viktimave të tregtisë me njerëz që janë të vendosura në qendrat tranzitore (në bashkëpunim me OJQ-në “Për fëmijëri të lumtur”); Huluntimi kuantitativ dhe kualitativ në sjellje rezikuese ndërmjet prostitucionit dhe viktimave të tregtisë me njerëz; Huluntimeve udhëheqëse ndërmjet nxënësve të shkollave të mesme në Shkup për vetëdijen e tyre dhe qëndrimet e tyre vullnetare dhe të detyrueshme në prostitucion, format specifike të prostitucionit të gratë e reja nën 18 vjet dhe rreziqet e tregtisë me njerëz.

Vazhdon

ISO
Maqedoni, PSI
Romani
ISC/USAID,
IOM

MH, MLSP,
MES, Agjencia
për të rinj dhe
sport, MI,
Institucionet e
shëndetit publik,
institucionet
edukative,
qendrat sociale,
organizatat
qeveritare dhe
joqeveritare,
agjencitë e
Kombeve të
Bashuara, Porta e
Hapur Për
Fëmijëri të
Lumtur

Branko Dokuzovski
Marija Tosheva

brankodoc@yahoo.com

Preventiva e angazhimit të grave të reja (14-18) nga punësimi në industrinë e seksit dhe në tregtinë me njerëz Stërvitja dhe inkuadrimi i edukatorëve moshatarë për preventivë për gratë e reja në Shkup për të hyrë në botën komerciale të seksit; Zhvillimi i Planit për aksion – drejtime themelore për krijimin dhe implementimin e aktiviteteve për gratë e reja, si viktimat të lëndueshme që ashtu t’i shmangen prostitucionit dhe tregtisë me njerëz.

ORGANIZATA JOQEVERITARE “PËR FËMIJËRI TË LUMTUR”

Puna me viktimat gra të tregtuara dhe të Ndihmë elementare psikologjike; Aktivitete edukative; stërvitje në fusha të ndryshme më qëllim të kthimit të vetëbesimit, vetrespektit, ndërtimin e aftësive etj; Aktivitete grupore terapeutike;

Në rrjedhë IOM MI, IOM, UNICEF

Verica Stamenkova Trajkova
verica@freemail.org.mk

vendosura në qendrat tranzitore Shërbime këshilluese; Rehabilitim dhe përgatitje për riintergrim në shoqëri, stërvitje për aftësitë shoqërore.

SHOQATA E PROKURORËVE PUBLIKË TË MAQEDONISË (PPA)

Reformat ligjdhënëse dhe stërvitja e prokurorëve	Implementimi i stërvitjeve me tema të ndryshme, përfshirë edhe tregtinë me njerëz dhe Ligjin për prokurorë; Botimi i buletinit i cili do të sigurojë forum për dialog dhe këmbim të mendimeve ndërmjet prokurorëve.	Në rrjedhë	OPDAT, OSBE, USAID, ABA/CEELI	MJ, MI, IOM, TEMIS, SECI, ICITAP	Sterjo Zikov Javem Obvinitel Makedonsko zdru`enie na obviniteli sterjoz@yahoo.com
---	---	------------	--	--	--

SHOQATA E GJYKATËSVE TË MAQEDONISË / QENDRA PËR ARSIMIM TË VAZHDUESHËM

Reformat ligjdhënëse dhe stërvitja e gjykatësve	Implementimi i stërvitjeve për luftë kundër tregtisë me njerëz dhe për çështje që kanë të bëjnë me fuqinë dhe pavarësinë e gjykatave; Botim i revistës gjyqësore specifike tremujore e cila fokusohet në tregtinë me njerëz; Pjesëmarrja në SPTF; Implementimi i modusit për stërvitje të gjykatësve dhe prokurorëve në bashkëpunim me SPTF-në dhe ICMPD-në, me përkrahje të OSBE-së, SMMS-së dhe OPDAT/Ambasadës së SHBA-ve	Në rrjedhë	SOROS, USAID, ABA/CEELI, OSBE, Donator Qeveritar	MJ, MI, OPDAT, SECI, Porta e Hapur	Tanja Temelkovska Milenkoviq cce@mja.org.mk Ndërtesa e Gjyqit- Shkup Tel. +389 2 109 943 Fax: +389 2 120 913
--	--	------------	---	---	--

SHOQATA E GRAVE JURISTE- TEMIS

Reformat ligjdhënëse për tregtinë me njerëz dhe vetëdijen publike	Stërvitje për ngritjen e vetëdijes kundër tregtisë me njerëz për profesionistët juridikë; Fushatë publike informative për të drejtat e njerëzve të tregtuar Komentet e eksperteve për propozimet ligjdhënëse dhe ligjet tjera që i prekin viktimat e tregtisë me njerëz dhe të dhunës;	Në rrjedhë	OSBE, SIDA	MI, MJ, Porta e Hapur/ Strada, ESE, Komisioni Nacional për luftë kundër tregtisë me njerëz	Natasha Tërpenovska Trenevskakryetare tami@mt.net.mk info@temis.com.mk Tel/Fax: + 389 23 129 180 Mobile +389 70 221 792
--	--	------------	------------	--	--

Ndihmë juridike për viktimat e tregtisë me fëmijë më të rinj se 18 vjeç invalidë ose	Hulumtim, analizë, stërvitje, punëtori, ndihmë juridike dhe përfaqësim juridik për viktimat e tregtisë me njerëz, për fëmijët e moshës nën 18 vjes, për invalidët dhe për të sëmurët mendorë;	Në rrjedhë	IOM		
---	---	------------	-----	--	--

Tregtia me njerëz në Evropën Juglindore

**të sëmurë
mendorë**

Nisma e reformave ligjdhënëse për zbrapsjen e tregtisë me njerëz	Harmonizimi i neneve ekzistuese të Kodit penal për tregtinë me njerëz me standartet me UE-në dhe dokumentet ndërkombëtare (sidomos Protokollin e Palermos)	01.09.2003 31.08.2004	ISC/USAID
---	---	--------------------------	-----------

REZULTATET NGA OPERACIONI MIRAZH shtator, 2002

